

25A-983-32

N. 84

5

THOMA NOTI

HORIZONTE TË KALTËRTA

- Tregime -

25A3

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

2523

BOTIM I SHTËPISË QËNDRORE
TË USHTRISË POPULLORE

Tiranë, 1972

ASNJE PELLËMBË PRAPAI

Në drekë herë krismat e armëve u tralluan, gjersa rrëshqen fare. Të dy pa ët qëndronin në pozicionet e mëparshëme dhe rrallë herë dëgjoheshin krisma armësh, pastaj ndjehej përsëri një heshtje e rëndë, e mbarsur me erën mytëse të barutit dhe një pështjellim e tendo je të thellë. Po të ndodheshe aty në çastet e një qetësie të tillë, do të dukej krejt e pabesueshme që disa minuta më parë i tërë vendi dridhej nga krismat dhe kodra mori në gjoksin e saj të gjelbër mijëra gërvishje plumbash, predhash e bombash. Vetëm po të shikoje kufomat e fashistëve të vrarë, që nxinin përgjatë të pjerësisë, do të bindeshe se aty kishte kaluar e pamëshirshme kosa e vdekjes.

Shpendi, komandanti i batalionit, kish dalë në një sopshtë po vrojtonte me dylbi ushën e luftimit. Ai nxori nga xhepi një copë letër, mbi të cilën qenë shkruar tre fjala të vetme: «Asnjë pëlëmbë prapa» dhe u përpooq të sillte ndërmënd ato cë kishin ngjarë.

Atë mëngjerez, pa zbardhur mirë, gjermanët kishin ardhur sëri aty me maqina e auoblinda dhe, si ndashin në priten partizane, u vërsulën me tërbim e kokëfortësi mbi kodrën vezake që ish mbështetur rrëzë malit dhe qëndronte e patundur e mospërfillësë ndaj gjithshkaje. Shpendi sikur i shihte edhe tanë tek i vërsueshин kodrës dallgë-dallgë, me reshta të dendur e të ngjeshur, që

ogjanin nga larg si zinxhirë tē murmē, tē lëvizshém. Nō fullim i qe dukur se këta zinxhirë do ta pérpinin me lehtesi lartësinë. Po kodra kish qëndruar e papérkuluz. Edhe pse urdhëri qe përsëritur disa herë dhe komanda eprore kish ngulur këmbë oë tē çuhej me çdo kusht trugë për t'i shkuar sa më shpejt në ndihmë garnizonit tē zrethuar, mbrojtësit nuk kishin lë huar asnjë pellëmbë. Kodra i kish têrhequr dallgët në gjoksin e saj, i kishte thërmuar pa mëshirë njëra pas tj t'ës d'e ato, tē dëshpëruara, tē copëtuara, qenë kthyer mbrapsb si për tē matrë vrull e për t'u lëshuar edhe më me egërsi mbi kodër. Po përsëri qenë copëtuar, qenë têrhequr, duke lënë mbi tokë ato njolla tē zeza, tē palëvizëshme. Dukej sikur ushtarët gjermanë qenë nisur me vërtik, ku ta dish nga ç'pikë e vendit tē tyre tē largët, dhe e kishin lënë aty vrapin, tē lodjur e tē dërmuar, për tē mos u n'ritur më kurrë. Tej, mbi xhade, m-qinat dhe autoblindat vazhdonin pa pushim tē nxirrin tym tē zi.

— Titi, nga vajte? — u dëgjua një zë i ulët, i druajtur, që dukej sikur kish frikë ta thyente atë heshtje tē rëndë.

— Këtu jam! — u përgjegj dikush nga ana tjetër e shkëmbit. — Pse flet avash, apo ke frikë mos trembësh sorrat?

— Jo ore, po ja, se si më duket — ja ktheu shoku përsëri me gjysëm zëri.

— Fol fort, o t'u mbylltë, se nuk dëgjojnë tē vdekutit — dhe partizani që e kishte emrin Titi, me mitraloz në dorë, rrëshqiti ngadalë e ju afrua shokut.

— Ama, herën e fundit e patëm pisk. Lele si më fish-këllinin plumbat majtas e djathtas. Thash se aq e patë. Po nuk isha hiç nishman. Të më hecosh, vrava pa besap nga ata qenët. Lere si ua punoi komandant Shpendi! — dhe duke folur, Titi rrëshqiste lehtë pellëmbën e

dorës mbi qytën e mitralozit, si të lëmonte e përkëdhelte një njeri të dashur. – Ja lumsha këtij! Të qëlluar ka bërë, jo llafe – dhe prap e vështroi shokun.

Tjetri se ç'vështron te poshtë, në lugine, e dukej sikur nuk e kishte mendjen tek ato që thoshte shoku.

– Ore, Vaso, nga më zhduke ashtu ti, xhanëm? Sa kërcet lufta, hëbesh erë. Po krahun pse e ke lidhur ashtu? Mos je plagosur?

Vasua bëri sikur nuk e kishte mendjen aty dhe u përpoq t'ja ndërronte fillin bisedës.

– Si ta meri mendja, ty, Titi: do të su'mojnë prap?

– Djalli e di. Po ti pse më hidhesh degë më degë? Më thuaj: të ka mbërthyer keq?

– Jo, or jo. Nuk kam gjë.

– Dale të ta shikoj – nguli këmbë Petriti dhe ju afroa e u përpoq të zgjidhët bezen, me të cilën Vasua qe përpjekur të lidhët plagë. Po gjaku qe mpiksur, tashot qenë ngjitur si zamkë, dhe Titi me shumë vështirësi arriti të zgjidhët plagë.

– Ç'na bëre kështu, o për kokën tënde? Na hape avaze. Po sikur të sulmojnë tanë fashistët, çdo të bëjmë? Apo t'u themi të na presin sa të pregetemi.

Petriti kafshonte buzën. Qe i bindur se shoku kishte dhëmbje të forta. Kjo dukej nga fytyra e tij, nga djersë sët e ftohta që ja mbuluan ballin. Dhe prap s'nxirte zë. I fortë qe.

– Sa keq të ka goditur, qënil! Të vajtka akoma gjak. Dhe ti thoshje se s'ke gjë.

E pastroi me kujdes plagë, hodhi mbi të një shuk duhan, e lidhi dhe e porositi shokun që, kur të ktheheshin, të shkonte medoemos në spital për t'u mjekuar. medoemos në spital për t'u mjekuar. Ai tundi kokën, po mendjen e ndau që të mos shkonte asgjékund. E hodhi

vështrimin mbi kufomat e fashistëve të vrarë, që qenë shpërndarë gjatë gjith faqes së kodrës, gjer poshtë në lugine.

— Si thua, Titi, do të sulmojnë prap?

— Edhe pyet? Nuk tërhiqet kollaj gjermani. E ka kokën kështu ai — dhe Petriti goditi sipërfaqen e s'këmbit me dorën e mbledhur grusht. — Po ç'e do, na u mbaruan fishekët.

Vasua tundi kokën.

— Lere mos e nga. Unë dhe dy — tri ballë kam. Si lamë të na arfrohesin dhe ca, që t'ua merrnim me nga fishekët, po i palosëm atje poshtë.

Si këmbyen edhe disa fjalë, secili zuri po icionin e tij dhe vendi ra prap në heshtje. Petriti u sh'ri barkas dhe mori pozicionin për qirje. Qënd uan kështu një copë herë të mirë. Mbajtën vesh. Kohë më kohë dëgjoheshin gjëmimë të thella andej nga duhej të luftonte garnizoni i rrëthuar.

— Si shumë po vonohen, të mallkuarit. Nuk më pëlqen fare kjo punë mua.

— As mua. Mbase prasin forca të re'a. Dhe ne fishekët po na mbarohen. C'u bë kv Malua?

— Ku di dhe unë. Malo!... O Malo!

Po nuk morën përgjigje.

— Maloo!

Dhe prap heshtën. Mbajtën vesh. Gjëmimet e predhave herë dëgjoheshin larg, herë më afër. Vendit dridhej e lëngonte në ethe.

— Ama luftë, ë?

— Lere si e pagoi gjermani në këto gryka. As në ëndërr s'e kish parë. Po mirë t'i bëhet. Pse s'rri urtë në vënd të tij?

Vasua qeshi me gjith zemër.

— Si the, ore, tē rrrijë nē vend tē tij? Bukur, pēr besël... Po tē rrinte atje, ai nuk do tē qe fashist, as...

Po nuk e mbaroi mendimin. Petriti tērhoqi befas shulin e mitralozit dhe e mori fishekun nē gojë.

— Ç'pate, o tu mylltë.

— Nuk e di. Më duket se dikush lëviz atje poshtë.

Vasua zgjati kokën pēr tē shikuar më mirë, po nuk dalloj gjë. «I bëjnë sytë, tē gjorit» mendoi. «Kështu qëllon nganiéherë në fushë tē luf ës. Të duket sikur tē vrarët lëvizin, afrohen. Ehu, sa herë më kanë bërë systë mua. Po dale, dale. Vërtet sikur lëviska d'çka...» Dhe, si vrojtoi më me kujdes, vuri re se dikush u zvarit pranë lisit, ju afrua një kufome, aëndroi ca dhe përsëri rrëshqiti më tutje. U ndal tek një tjetër. Qëndroi pak, pastaj shkoi më tej. Shumë nga partizanët e kishin vënë re dhe qëndronin me gishtin në këmbëz.

— Ore, mos është Malua ai?

— Sa mirë e giête. Malua, dora vetë.

— Ç'po bën atje?

— Më duket se mbledh fishekët e tē vrarëve. Kështu bëri edhe një herë tjetër.

— Mirë e ke ti. Ai është. Sa mirë ja preu kapl'oqia. Po tē na kish thënë, lumëmadhi. Unë desh ja kripa lëkurën.

— Fdhe unë.

Në këto e sipër, Malo intendant i mbushur me fishekë e bomba dore dhe po i ngjitej këmba-doras kodrës. I kënaqur, ai zvaritei dhe fishkellinte një këngë lufte. Kur arriti tek shokët, kullaonte në djersë. Hoqi njërin pas tjetrit tē katër automatikët që kish marrë dhe trastën me municion. Disa veta ju afruan. Nisën ta ngacmonin:

— Malo, pa na thuaj tanë ç'porosi tē dhanë gjermanët? Ç'kompromis bëre më ta?

— Ç'të duhen katër automatikë, o lumëzi? Nuk të arrin një?

— Vafsh shëndoshë ti Malo, edhe me të gjallët mirë, edhe me të vdekurit grurë. E sigurove zahirenë përdimër.

— Shpëtove more, se desh ta kripi lëkurën Titi.

Malua fshinte djersët me shami dhe vështronët herë njërin e herë tjetërin. Pastaj nisi të numëronte fishekët, bombat.

— Kini hak ju, pse të mos prallisni — tha më në fund.

— Po dale pa shihemi. Do të më luteni për një ballë fishekë, po kini për ta parë. Kaq ta bëni dhëmbin, unë nuk do t'u jap asnje për be.

— Mos, Malo.

— Mirë, kini për të parë — dhe e futi prap municationin në trastë. — Mos më thënçin Malo, në ju dhënça.

Sakaq erdhë komandant Shpendi. Ai u foli partizanëve që kishin lënë vendet e qenë grumbulluar pas shkëmbit. Malos i dha një surup të mirë, që ta mbante mend për tërë jetën. Ai e dëgjoi në heshtje. Pastaj nuk ju durua. Foli plot seriozitet:

— Me që është kështu, unë po shkoj t'ua ndaj prap fishekët e bombat.

Shpendi kafshoi buzën për të mos qeshur.

— Kujt t'ja ndash?

— Gjermanëve. Të vrarëve.

— Ç'u duhen atyre?

— T'i pyes, pastaj u them.

Partizanët qeshën dhe e vështruani me dashuri intendentin e kompanisë. Ai kruante kokën i hutuar dhe, me që s'dinte ç'të bënte, zbrazi bombat e fishekët dhe nisi t'i numëronte përsëri.

— Sado që t'i numërosh, o Malo, nuk shtohen. Po e di ç'ke ti: ndajua shokëve, se i kanë vezmet bosh.

Ai e vështroi ngultas komandantin. Desh t'i thosha diçka, po shikimi i tij i menduar e detyroi të heshtte. «Nuk është koha për qyfyre» mendoi. «Atij i zien koka, kurse unë...» — dhe nisi t'u jepte me radhë partizanëve, «racionin» që u takonte.

— Ama luftë!

— Lere mos e nga. Po pse nuk sulmojnë, xhanëm?

— Ku ta dish përse e vrashin mendjen. Është e keqë kjo qetësi. Dëgjoni mua ju.

Zërat u fashiten njëri pas tjetrit. Mbi kodër u hoq zvarë heshtja. Një heshtje e rëndë, që të shyppte gjoksin e të ndillte lloj-lloj mendimesh. Ajo heshtje tinzare, e pabesë, që tregonte se retë qenë të mbarsura e ngaçasti në çast mund të shpërthente e çmendur furtuna. Dhe nuk kaloi shumë e mbi kodër u përplasën si breshër predhat e topave, të mort javë. Vendit u mbulua. me tym. Dukej sikur diçka çuhej, rënkonte; kurse poshtë, në mes dushaeve e shqoneve, filluan të rrëshqisnin hije të zeza. Nisi të zvarrittej gjarpëri.

Heshtja u thye. Nëpër pozicione tilluan të vrapijnë fjalët:

— Po vijnë!

— Qëndroni gati!

— Asnië krismë pa urdhër...!

Petriti i vuri një krëhër të ri mitralozit, e mbështetës qaqen mbi qytë dhe e shtrëngoi atë fort në krahërat. Vasua hoqi sigurecën automatikut që porsa kish marrë nga Malua, kurse ai vendosi bombat rreth pozicionit e u shtri i kënaqur. «Kush i pret sa të afrohen!» mendoi. «Më mirë t'u binim. Ka edhe për atje, edhe përkëtu. Nuk janë më larg se një e shtënë pushke. Ja, unë do t'ia terezit atij qvrrykut të shënloshë.» Malua mori shenjë, duke ndjekur hap pas hapi me lëvizjen e automatikut atë që kish vendosur të qëllonte me të parën.

Trupi i fashistit u fut brenda rrëthit të shënjestrës.
Mjaftonte të hqite këmbëzën dhe... «Hajde prit tani, të kam rixha». Dhe nuk ja largonte sytë trashalunit. Ai sa vinte e afrohei. Në fillim nga rrathi i thepit doli koka, pastaj gjoksi dhe ai e shquahti më mirë. «More, po ai nuk duket si gjerman. Çështë kështu? Fshatar? Nuk çështë e mundur...» Dhe u ngrit mbi bërry'a për të shikuar më mirë. Në çast një plumb i fshiku majën e veshit, si ta pickonte një grenzë. «Shpëtova paq» tha dhe u ul pas gurit. Po nuk iu durua. U ngrit pak e vështroi me kujdes. Një predhë topi fishkëlleu dhe u përplas diku pas shpinës së tij. Past j nië tjetër, dhe një e tretë. Po ai ishte hutuar dhe nuk e kishte mendjen tek ato. As tek plumbat që kafshonin shkëmbin.

- Shikon gjë ti, shoku komendant, apo...
- Cfarë?!
- Po ja, gjermanët kanë mb'edhur pleq e fëmijë, i kanë vënë nënara, dhe...

As komandanti vetë nuk qe në gëndje të thoshte se ç'ngiau me të në atë çast. Ju duk sikur shkëmbi mbi të cilin qe mbështetur, e përcolli nëpërmjet damatëve gier në zemrën e tij të surtë shqetësimin cë ndju. Sikur gjithshka e ndali lëvizjen për të parë më mirë.

Ai s'diti c'të mendonte. Ç'të thoshte. Vetëm pyeti:
— Malo, c'po bën?

Kjo qe një pvetje e kotë. Pa kuprim. Megjithatë ai s'mundi të thoshte tjetër. Shjtoi për ëri fushën e tejeës. Tani nuk dukeshin më as niollat e zera të ralë-vizëshme, as nierëzit e vashur me uniformën e murme që vraponin si të cmendur mbi kufomat e të vrarëve. Në vend të tvre vështrimi i tij kani vetëm nierëzit e hutuar cë endeshin si të dehur herë në një krah. Herë në tjetrin. Dikush u rrëzua, po u ngrit shpejt. Një nënë, me fëmijën në duar, mezi i ngjitej së përpjetës. Vogë-

lushi qante. Nga cepi i fustanit nënën e tërhiqte një fëmijë tjetër, më i rritur. Edhe ai qante në kupë të qiellit. Po për të s'bëhej merak askush. Njeëzit tërhigeshin zvarë, thërrisnin, canin. Pë piqashin të ecnin shpejt, për t'u ndeshur sa më parrë me të papriturën. Pas tyre vinin gjermanët, me armët në duar, gati për zjarr. Ata ishin shumë; dhjetra e qindra vetë, ku të përzier me fshatarë, ku veçan. Ecnin shtynin me tytat e armëve dhe thërrisnin me një gjuhë të frikshme, të pakuptueshme. Befas njëri nga fshatarët, cë nuk da lohej në ishte plak apo i ri, burrë apo grua, u pengua dhe u rrëzua. Dikush i vajti në ndihmë, e ngriti. Ai eci disa hapa dhe prap u rrëzua. U dëgjua një breshëci automatiku. Ushtarët shkelën mbi trupin e tij dhe kaluan më tei. Turma u ndal një çast, u luhat dhe u shty përrpara me mundim.

— Malo, Petrit, Vasil...! Çdo bëjmë?

Shpendit, komandantit të batalionit, s'i kujtohej ta kishte parë veten më ngushtë. Natyrishët ai kishte kaluar shumë caste të vështira të cilat nuk do t'i harronte për téré jetën. Kur merrej me veprimtari ileg-lë në qytet, pa dalë akoma partizan, dhe ra në duart e kurstorit, ai i kish duruar me një këmbëngulje të pashqë të gjitha torturat çnjerëzore që kish bërtë falisët mbi trupin e tij. Po kjo nuk i qe dukur aq e tmerrshme. Një herë tietët, kur kish mbetur i rrethuar me një grusht shokësh dhe dara e armikut shtrëngohenj gjithnië, aq sa e kishim ndier rrëzikun e vdekjes t'u rrëshqiste farrë pranë e t'i prekte me shqisat e saj mizore, ai kish ditur ta përbante vten e t'i çante për mrekulli rrëthimin. Po as k'o nuk i qe dukur kaq e tmerrshme. Edhe kur, pas betejës, i iqt dashur të ndahëj përgjithnjë nga shoku më i ngushtë e ta mbulonte atë në dhe, duke ndier t'ja digjinin sytë lotët e përvëluar

e t'i mblidhej nē fyt një komb mbytës, ai kish ditur tē qëndronte i fortë e ta kthente dhembjen nē plumb përmikun.

Kurse tani... ç'të bënte tani?

Në tru i godisnin si çekan fjalët që i kish shkruar komandantit tē brigadës një natë më parë: «Asnjë pëllëmbë mbrapa!»

Ato nuk qenë më tri fjalë tē zakonshme, po një urdhër i cili duhej zbatuar me çdo kusht, ndaj Shpendi tani e kish harruar çdo gjë tjetër dhe mendonte vetëm ato fjalë, për urdhërin. Shpendi vështronte rreshtat e gjermanëve që sulmonin dhe, mbi kryet e tyre, mbi krismat e armëve, mbi gjëmimet e luftës ngrihen kryenece ato tri fjalë: «Asnjë pëllëmbë prapa!» Vështronte fytyrat e shokëve, pozicionet e tyre, kodrën, lugina, malet dhe kudo shikonte ato tri fjalë. Bile edhe kur i hodhi sytë mbi ata njerëz tē trembur, tē hutuar, që kishin vënë fashistat përpara, ju duk se gjokset e tyre gjëmuan: «Asnjë pëllëmbë prapa!» Para këtyre fialeve, tē shkruara me një shkrim tē shqetësuar mbi një qoshe gazete, çdo gjë e kich humbur rëndësinë. Ato fialë kishin zënë vend nē trurin e tij, duke larguar gjithshka tjetër, si tē donin tē thoshin: nuk do tē shkulemi pa i mundur gjermanët. Shpendi e ndiante se për tē shpënë nē vend atë urdhër, ai do tē gjente gjithshka, do tē hapte ziarr mbi këdo edhe mbi vete e tij. Dhe nuk do tē lëshonte asnjë pëllëmbë. Po prapai e kuqtonte se mbi veten mund tē qellonte pa ju dridhur dora, mund tē qellonte mbi këdo tjetër, kurse mbi ata njerëz tē pafajshëm jo. Kurrsesi jo.

E pra ç'të bënte? Ç'duhej tē bënte? Si t'i thyente fashistët? Si ta mbronte kodrën?

— Shoku komandant, po afrohen...!

Ktheu me trëmbim kokën. Kush fliste ashtu? Malua, Petriti, Vasili, të gjithë e shikonin. Të gjithë prisnin me gishtin në këmbëz. Ai afroi faqen tek qyra. E mbështeti mbi të. Mori shenjë. Po ku? mbi kë të qëllonte? U përpoq të përqëndrohej. Në mes të gjermanëve që ecnin me nxitim, ai dalloj një me trup të hedhur, që shtrinte krahët anash, si të donte t'i shtynte ushtarët me forcë përpara, duke përfituar nga ato çaste hutimi në radhët e kundërshtarëve të tij. «Ai do të jetë komandananti!» mendoi dhe mori shenjë. Tërhoqi ngadalë këmbëzën e automatikut. Sakaq gjermani i humbi nga sytë. Thepi me shqegëzën u trafshuan mbi një fëmijë. Atij ju errësua gjithshka. «Desh e vrava, malukat!» Dhe në çast i doli parasysh diali i tij motak që hapte duart anash dhe guiste pa pushim. U drodh nga koka tek këmbët. «Desh e vrava...» Dhe përsëri çdo gjë u errësua e i humbi nga sytë. U mundua ta dallonte në turmë trupin e bëshëm të oficerit fashist, po nuk mundi.

Atë çast u përpoq të kuptonte se ç'po ngjiste me të dhe për të parën herë mendoi se e kish humbur davanë. Ai nuk ishte i zoti për asgjë: as të komandonte, as të hapte zjarr, as të tërhiqejet. Si ta kishin kurtuar këtë, gjermanët e zgjatën hapin. Dukej sikur nuk ecnin, po fluturonin, sikur i shikonin edhe ata ato tri fjalë: «asnjë pëllëmbë prapa» dhe të donin t'i shuanin, t'i grisnin me majën e bajonetës, t'i coptonin me plumbë dhe, duke ecur mbi to, të shkelnin mbi kodër.

Komandant Shpendi ishte në ethe. Ju duk vetja i pazoti për të menduar. Më i pazoti se kurdoherë tjetër. Pa ditur ç'të bënte, u hodhi një sy akrepave të sahatit. Ishte hera e parë që e shikonte orën atë ditë. Dhe prap auk që në gjendje të përqëndrohej. Shikoi sekondë-matësin që rëshqiste me shpejtësi brënda trethit. I dukej

se asnijëherë tjetër alëtri nuk kishte lëvizur me aq nxitim. Asnjëherë s'e kishte ndier aq fort trokitjen e sekondave. Dhe prap akrepi humbi nga sytë e u shndërrua në hapat e fashistëve që trokisnin, gjëmonin, nxitonin drejt tij.

— Po afrohen!

Kur mendoi kështu, ai u përpoq ta harronte çdo gjë, të kthjellonte mendimet, të gjente rrugëdalje.

Nga të gjitha anët flisnin:

— Shokë, çdo bëjmë...?

— Ç'presim?

— T'u dalim përpara!

— Qitësit më të mirë të qëllojnë!

I hodhi sytë nga Petriti, Malua, Vësili. Ata i kishte pranë, fare pranë. Se ç'i përshpërisnin. Se ç'i thoshnin:

— Po sikur...!

Në fillim nuk qe i zoti ta merrte me mend në se ato fjalë ja pëshpëritën ata, apo i mendoi ai vetë. Sidoqoftë, kjo nuk kishte ndonjë rëndësi. E gjithë përsëri is te që të mos humbiste asnje minutë, asnje sekondë. Të zgjidhët partizanët më të mirë guximshëm, ata që q'llonin më mirë dhe të vepronët sa më shpejt.

— Petriti me Vasilin dhe Luton të v'në më mua — foli me rrëmbim. — Malua me Brahon dhe Ilon të pësin nga e majta. T'u dalim fashistëve nga krahët... Të hapim zjarr! T'i ndajmë nga populli! Të tjerët të bëjnë qitje nga vendi. Por me ku'des! Pasi të zëmë ne vend e të qëllojmë. Asnjë diskutim!... Shpejt...!

Ai f'iste me nxitim. Shokët ja rrëmbenin nga buzët çdo falë. Ata sikur kishin qenë në një mendje me të. Shpendi dalloi Petritin, Malon dhe të tjerët të shkëputeshin nga shokët. Në në çart ai vrapi me mendje shqopeve, u fut në mes të armiqve dhe hapi zjarr. E

kuptoi se do ta kishte tē vështirë, por trugë tjetër s'kishte.

— Pas meje...!

Ai rrëshqiti faqes së kodrës, përgat shtratat tē një rrëkeje. Gjermanët nuk ishin veçse njëqind, njëqindepe-sdhjetë metra larg. «Mos u vonuam?» Ktheu kokën pët tē shikuar në se e ndiqnin shokët. Dy-tri hapa prapa rrëshqiste puq me tokën Petriti, pas tij Vasua, Lutua dhe një i pestë, tē cilin nuk mundi ta dallonte. Po Ma-lua me shokët ç'po bënin? Po ecin vallë paralel me ta...? Atë çast dikush e kapi nga supi. Ai nuk u kthye, por e kuptoi se ishte Petriti.

— Më ler mua përpara!

Shpendi u përpoq tē shkëputej dhe tē vazhdonte, por partizani foli përséri:

— Mos ma prish këtë herë. Unë gjithnjë tē jam bindur.

Ai e kuptoi se sa shumë do ta dogëndiste shokun po tē mos ja plotësonte këtë dëshirë. Krejt pa dashur mendoi një çast se mund tē mos kishte rast tjetër t'i plotësonte një dëshirë tē tillë. Ku ta dish? Në luftë shkonin. Dhe u bind. U ngjesh buzë kanalit. Petriti rrëshqiti mbi tē. Shpendi e ndoqi me sy dhe u habit me ç' shkathësi lëvizte ai. Duke e parë, përforcoi edhe më shumë bindjen se me shokë tē tillë mund tē plotësonte çdo detyrë. «Po Ma'ua ç'bën? Të jetë afruar? «Dhe u përpoq ta pëfyturonte tek rrëshqiste ledheve, kaçubeve. Po në vend tē tij, i vajti mendja tek fitili i ndezur që shpinte zjarrin tek mina. Sekondat trokisin... Zjarri afrohej. Ata ecn... gjermanët ecnin... Gjer kur, vallë?

Pesë partizanët qëndruan buzë nië sopi. Shpendi u fut në mes një kaçubeje. Shikoi. Nierëzit i kishte fare afërt. Disa hapa përpara. Sytë i ndalën mbi nënën me një fë-

mijë në dorë dhe tjetrin që e ndukte nga fustani. Ata i nxori ryma në anë. Nuk i kishte më shumë se dhjetë-pesëmbëdhjetë hapa larg. Nëna mezi mbahej. Mezi qëndronte. Ju duk se nga njëri çast në tjetrin do t'i mbroheshin forcat dhe do të binte. Vetëm dashuria përmijët e mbante në këmbë dhe e shtynte përpara. Vinte e hequr në ftyrë, e zbardhur si një fletë cigarette. Vetëm mollzat i skuqnin. Sytë sikur i lëshonin xixa. Nuk ngej me frymë. Shtrëngonte në gjoks vocërrakun, përpigjët ta mbulonte me pëllëmbët e duarve, si të dlonë të ndalonte me këtë rrezikun. Njëtytë pushke e shtynte prapa. Atij ju duk sikur nuk kishte parasysh një të panojohur, por gruan e tij, fëmijën e tij. Tani i kishte fare afër. I kaluan përpara syve. Ishte tamam çasti që kish pritur. Dhe s'e bëri të gjatë. Thirri me sa forcë që kishte:

— Bjeruni, qenërvvel Zjarr!

Ai zë gjëmoi më fort se krismat e armëve. Pushkët dhe mitralozat buçitën. Në fillim hapi zjarr krahu i majtë, pastaj i djathti. I gjithë ziarri i armëve u derdh në atë hapësirë të ngushtë që ndante popullin nga gjermanët. Pikërisht atje, nga të dy anët, në një çast të vetëm, fishkëllyen qindra plumba. Kurse prapa, në tre-shtat e fundit të armiqve, shpërthyen bombat. Toka u drodh dhe shungulloi si të kish rënë tërmët. Fshatarët e kishin humbur. Disa ranë si gur barkas. Të tierët qëndronin si të ngurosur e nuk po kuptonin ç'ngjiste, nga qëllonin, si qëndronin akoma më këmbë, si nuk rrëzoheshin.

— Vellezër, ecni, shpejt, më shpejt...!

Nga vinte ky zë? Kush thërriste?

— Shpejtoni, vellezër! Largoħuni nga fashistët!

Ata sikur u zgjuan nga gjumi. Vrapuan përpara, duke tēnë pas krahëve shungëllimën e bombave, të krismave.

Gjermanët u kthyen nga e majta, pastaj nga e djaththa. Mitralozët krëkëllinin dhe kositnin pa mëshirë. Atyre çdo gjë u erdhi krejt pa pritur, tamam atëhere kur ishin të sigurtë se e kishin futur në kurth kundërshtarin. Dhe befasia në luftë është më e tmerrshme se çdo gjë tjetër. Ata u përpinqën ta mblidhnin veten. Të kundërvëpronin. Por atë çast, më shumë se nga krismat, vendi u tund nga zëri i Shpendit;

– Përpara, partizanë!

– Përpara..!

Dhe partizanët ranë me bajonetë mbi bajoneta.

MOTRA

Si zakonisht, edhe atë mëngjez çeta vullnetare u grumbullua sa zbardhi dita në pikën e hapjes. Ushtarë të vjetër dhe bij e bija ushtarësh. Kooperativistët e prisnin gjithnjë me interesim ditën e stërvitjes: Qëllonte ndonjëherë që në punët e fushës edhe të mos dilnin, por vendin në çetë nuk e linte asnjeri bosh, sidomos vajzat. Ato ngriheshin shpejt në mëngjez dhe nuk u durohej sa të merrnin rrugën. Kjo njiste jo vetëm sepse u pëlgente stërvitja ushtarake, sidomos qitja, ku e kishin lënë me turp edhe skuadrën e burrave, por sidomos sepse atje i priste Mara Çupi komisarja e kompanisë në pikën e hapjes. Qe vajzë e çuditshme kjo Mara. Ditën e parë, kur e kishin parë të veshur oficerë e të komandonte një kompani të tërë me ushtarë, vajzat kishin lënë mendjen. Madje, kur njëri nga ushtarët qe përpjekur ta kthente në shaka një urdhër të saj dhe komisarja kish ditur ta vinte në zap, ato ishin gjëzuar si rrallë herë të tjera. U vinte mirë që shoqja e tyre, një vajzë e re si dhe ato, dinte të komandonte e ta përdorte aq



mirë armën. Në minutat e pushimit, Mara u dha leje ushtarëve të shpërndareshin dhe vetë shkoi tek ato. Vajzat u têrroqën mënjanë, të druajtura, dhe e vështronin plot këershëri. Çdo gjë që kishte të bënte me të: veshja, mënyra si qeshte, si fliste e ecte, atyre u dukej e jashtzakonshme. Por Mara kish ditur të futej aq thjesht në mes tyre, sa ato mbetën të habitura. Dhe që ditën e parë u tregoi aq gjëra interesante e të çuditishme, sa atyre u dukej se nuk kishin dëgjuar për tërë jetën. Mbi të gjitha, ato çuditeshin me shkathtësinë dhe lehtësinë me të cilën e përdorte ajo pistoletën, pushkën, mitralozin. Në këtë punë Mara s'e kish për gjë të ha hei me ushtarë më të mirë. Ndaj secila nga vajzat e kishte për mburrje kur fliste apo shëtiste me të dhe, kur arrinte në fshat, nuk pushonte së treguari për bisedën që kish bërë me komisaren. Që kur qenë njohur me Marën, s'u pritej sa ta shihnin. U pëlqente sidomos kur delte para rreshtit dhe me një fjalë të vëtme vinte në lëvizje një kollonë të tërë ushtarësh, të armatosur e me helmeta në kokë. Qysh atëhere nuk kish ngjarë të mungonte në stërvitje qoftë edhe njëra nga vajzat. Ndaj atë mëngjëz ra shpejt në sy mungesa e Dilës.

— Mos është sëmurë? — pyeti Mara Çupi.

Vajzat nuk u përgjegjën menjëherë. Ajo e përsëriti pyetjen.

— Jo, nuk është sëmurë, — foli me gjysëm zëri komandanjtja e skuadrës, pa e vështruar në sy. Mara e parandjeu se diçka kishte ngjarë.

— Ju më fshihni diçka, motra. Pse nuk ma thoni hapur si qëndron puna, — nguli këmbë.

— Ne s'i kemi ndonjë faj — tha më në fund njëra nga vajzat. — Dila është vajzë e fortë, por këtë radhë u thye. I trembet **babës**.

- E si tē mos i trembet? Ta dini ju ç'baba ka ajo
- Jo, jo. Nuk ka faj Dila. Ajo u pērpoq me atē tē
vetēn, por...

Mara Çupi dëgjonte e habitur. Vajzat flisnin me zë
tē ulët dhe nuk guxonin t'i ngrinin sytë, sikur t'i përgjonte njeri.

- Unë nuk kuptoj asgjë, motra. Përse e kërcënou
babai?

- Se don ta martojë me zor.

- Ashtu? Paska qenë e fejuar Di'a, dhe unë s'e dijal

- Jo, Mara, nuk ka qenë e fejuar, por...

Epo, flisni pra, si qëndron puna?

Dhe ato u ulën e ja treguan me hollësi ç'kishte ngjarë.

2.

Dila ishte vajza e dytë e Martin Cukës, që shkonte
në derën e Shkurtajve. Motra e madhe i kishte vde-
kur dhe tani i shoqi kërkonte dorën e saj, edhe pse
ajo s'i kishte arritur akoma tē gjashtëmbëdhjetat, ndërsa
ai i kish kaluar tē pesëdhjetat. Kur e kishin marrë vesh
këtë, tē rinitë e fshatit qenë ngritur tē gjithë më kë-
mbë e kishin shkuar në shtëpinë e Dilës. I jati i saj
as që kish lojtur nga qoshja e oxhakut ku qëndonte
po, duke thithur me nervozizëm çibukun, i kishte parë
që prapa rrathëve me tym duhani që nxirrte nga goja.

- Fshatit tonë nuk i kanë mbarue burrat, që ta ma-
rrin nëpër këmbë kalamaîtë! — ua kish prerë shkurt,
duke u kthyer shpinçn. Po tē rinitë nuk qenë tërhequr.

- E di ti, bab Martini, c'ka thënë shoku Enver për-
ata që shkelin me këmbë tē dreitat e grave dhe tē vaj-
zave? — e kishin pyetur. Xha Martinit i qe tharë pë-
shtyma në gojë.

— E di. Ai ka folur pēr ata qē nuk i pērfillin vajzat, kurse unē s'kam bërë asgjë me kokēn time. lme bijë...

— Nuk ēshtë e mundur, Dila...

— Kēshtu si them unē. Po tē doni, pyeteni, — dhe doli e u kthyē sakaq, duke tērhequr vajzēn nga dora. Shoqet shtangēn nga habia. Sa qe prerë Dila brenda dy-tri ditëve! Nuk njihej fare, Po ato e dinin se Dila qe e fortë e nuk do tē jepcj, edhe pse i kish humbur syri e dridhej e tēra duke u pērpjekur tē fshihej pas tē jatit.

— Fol: tē shtrēngon njeri tē martohesh, apo ke vendosur vte? — e pyeti Martin Cuka me një dashamiresi tē shtirur dhe i hodhi sytë e pērskuqur qē lëshoninxixa, duke ja shtrēnguar dorën si me darë.

— Fol, Dilë! — i dhanë zemër shoqet. — Ne e dimë që t'i s'e do. Fol, mos ki frikë.

Ajo ngriti sytë, i hodhi me frikë nga shoqet, pastaj nga babai dhe i uli nē çast. I veshur me xhyben e zeze dhe pak i kërrusur, ai i shëmbellente me një jatagan tē ngritur qē nga çasti nē çast mund t'i binte nē krye dhe ta ndante më dysh.

— E pra, fol! — bubulliti zéri i tij. Ajo u drodh dhe gati u irézua nga dhembja, aq fort ja shtrëngoi dorën.

— Si tē dojë baba! — u dëgjua një zë i mekur, i pafuqishëm.

— Ashtu?! — folën nē një gojë tre-katër veta.

— Mirë, baba, po ti vëtë ç'thua?

— Ne e dimë mirë. Ti nuk e do atë, Dilë.

Ajo ngriti përsëri kokën. Tehu i jataganit sikur lë shonte xixa.

— E... dua...! — foli dhe iu shkëput nga dora tē jatit e vrapi nē dhomë e ngashëryer.

— Uaa! — u habitën vajzat dhe shikuan njëra-tjetrëna.

I jati i Dilës i vështronte triumfonjës, me ata sy plot fiejza të kuqe.

— Tani ç'prisni? Këputeni qafën! Kur do vajza, s'ki-ni ç'bëni. Hidhuni përpjetë, po deshët.

3.

Mara Cupi dëgionte në heshtje. Fytyra e zbehtë e Dilës, me atë vështrim të ëmbël e të hutuar, nuk i largohej nga sytë. I vinte keq që ajo nuk kish patur gu-xim të qëndronte gjer në fund e t'ja thoshte në sy të jatit atë që mendonte. «Më fal, Mara, — sikur i thoshte vë-shtrimi i saj — por nuk munda. Ta dish ti ç'kam hequr. Më në fund ...» Ajo e parandjeu se ndeshja do të ishte e ashpër. E kuptonte madje se këtu nuk ishte puna vetëm për Dilën, as për dy-tri fejesa të shkëputura; por për një zakon të egër e mizor që u kish nxirë jetën qindra e qindra vajzave të mira si Dila. Atij zakoni tani i kishte ardhur fundi.

Vajzat qëndronin të heshtura e të menduara para saj. Ato ja treguan me një frymë të gjitha ç'kishin për të thënë dhe tani prisin fjalën e saj. Ajo i vështronë dhe mundohej të merrte me mend se c'duhej të bënte. Duke i shikuar, nuk e kish të vështirë të kuptonte se ç'energji do të shpërthenin, po të dinte të vinte në lëvizje të gjitha ato forca që pasqyroheshin në sytë e tyre të zjarrtë.

— Ta dish sa është dobësuar Di'a, shoqja komisare! S'i ka mbetuar pikë gjaku në fytyrë! — foli njëra nga ato.

— Mirë t'i bëhet. Kush ja ka fajin? — shtoi një tjetër.

— Mos fol ashtu, motër. E ka vështirë, e shkreta.

- I jati s'e le tē kapércejē pragun e s'pranon njeri nē shtëpi. As kryetarin e kooperativës s'e aftron.
 - Është bërë si i çmendur. E kalbi nē dru tē shkretëtën.
 - Unë mora vesh se ka ardhur Pjetri me leje.
 - Cili Pjetër?
 - Vëllai i saj. Është ushtar.
 - E ç'e do, edhe ai anën e tē jatit do mbajë.
 - S'më besohet. Ka gati dy vjet nē ushtri ai.
- Dhe dalëngadalë biseda nisi tē merrte një drejtim tjeter. Vajzat filluan tē flisnin për Pjetrin që kish ardhur me leje nga ushtria. Mara Çipi vendosi tē takohej që atë mbrëmje me tē.

4.

Pjetrin e takuan para shtëpisë, bashkë me tē jatin. Xha Martini i binte oborrit nga njëra qoshe nē tjetrën, duke goditur tokën me nervozizëm me shkopin e tij tē thantë. Shihej qartë që po haheshin me fjalë. Të rinjtë bënë sikur nuk e vunë re këtë.

— Mirëmbërëma, xha Martin.

I zoti i shtëpisë i vështroi ashpërt, po nuk foli. Atij nuk i ndollti asgjë tē mirë biseda që kish nisur tē bënte me tē birin.

- Sa ditë do rrish? — e pyeti tē birin vetullngrysur.
- Një javë.
- Nuk paski punë ju andej nga ushtria, më duket. Pjetri bëri sikur s'dëgjoi. U kthyte nga shokët dhe u përhëndet me radhë me ta.
- Shih, sa bukur i trika uniforma! — ndërrroi bisedë njëri nga ata.
- Çudil Kjo ushtria tē jep një çehre tjeter, more vëlla. Të tregon më tē rritur, më...

— Shkojmë nga vatra e kulturës, Pjetër?

— Shkojmë.

I jati goditi përsëri tokën me shkop e nisi ecejakët nëpër oborr.

— Këputni qafën! — shfryu duke mbyllur portën. Dhe u mbështet pas kanatit të saj. Oborri nisi t'i vërtitej e t'i vërtitej. Ai u çapit ngadalë. Sa shumë qe lodhur këto ditët e fundit! Të rinitë e kishin futur në të thella. Në fillim as që e mori me mend se do të bëhej tërkuzë kjo punë. Kujtoi se nuk do t'i trazohej njeri në hallet e veta e do të bënte si ta shihte të udhës. Kurse tani i gjithë fshati i kish kthyer sytë nga ai. Të madhe punë është i kish hapur ajo Mara Cupi. Prapa çdo fjeje që kish ndodhur e po ndodhët në fshat, Martin Cuka kishte parë gjithnjë dorën e saj. Edhe të rinitë në shtëpi me siguri ajo i kishte dërguar. Në mos do, na tani edhe ky diall Pjetri. Po atë, ajo ta kish mësuar?

— Në diall! — shfryu dhe nisi të godiste përsëri tokën me shkopin e tij të thantë.

§.

Pjetri u kthye vonë. Derën e gjeti mbyllur, por ai shqyri lehtë dritaren, siç bënte kur ish i vogël, dhe hyri pa vështirësi brenda. Nëna dhe motra e trethuan në çast.

— Nesër pasnesër mblidhet fshati — tha ai dhe nisi të hante me nxitim. Pastaj u kthve nga Dil'a: — Do të vish dhe ti. Thuaje hapur atë që mendon. Duhet t'i nxjerrësh gështeniat me duart e tua.

Nënë dhe hijë vëhtruan n'ëra-tjetrën dhe nuk nxorën asnjë fjalë. Kishin frikë se mos i trembnin gjumin. Martin, që flinte në të ndarën tjetër, ngjitur me kuzh-

në. Ata u shtrinë në dyshekë, njëri pranë tjetrit. Nëna i pushtoi në krahë, si klloçka zogjtë, kur sheh të sil' et trottull ndonjë shpend grabitqar. Dhe, duke biseduar kokë më kokë, nuk mbyllën sy gjithë natën. Ato përpinqeshin të merrnin me mend se si do t'i vinte filli mbledhjes, kurse Pjetrit s'i shqitej nga sytë Mara Çupi. Biseda me të i kish lënë mbresa të thella.

Çvajzë e mënçur dhe trime që ishte ajo!

6.

Kuvend i tillë s'ish parë në ato anë. Edhe malet u shkundën e pemët e larta u ulën gjer në tokë — aq i fortë qe tufani. Për të shkruan edhe gazetat e foli radioja. Kurrë ndonjëherë ato fshatra s'e kishin ndjerë më fort pulsin e jetës së vendit, fjalën e partisë. Asnjëherë tjeter zakoni i vjetër, i mykur, nuk kishte marrë plagë të tillë.

Erdhën pleqtë me mustaqet dhe flokët e zbardhura atje në malin e xhveshur dhe u ulën si ca shkëmbinj të moçëm. Nisën të flisin ata urtë e butë. Kur ja, që lart zunë të zbrisnin vajzat, gratë. Në mes kishin futur Mara Çupin. Dukej sikur e prishi heshtjen shkullore e nisi rrugën mali verë. Burrat u panë sy më sy: «Ç'gjemon kështu? A po dëgjoni?» «Eh, punë grash, mor vëlla. Ha-ha-ha... Shkojnë për dru ato!» Po vajzat, gratë, erdhën e u ulën në mes të kuvendit. U duk atë çast sikur kërcitën e u tundën nga vendi shkëmbinjtë. «Po juve kush ju thirri? C'doni këtu?» «Erdhëm vetë. Mjaft kemi oritur ndër shtëpija. Duam ta themi dhe ne fjalën tonë!» Pleqtë u kthyen shpinën, u hakërruan. Maleve tonë nuk u kanë mbaruar burrat, që t'u vijë radha grave. Shkonë në shtëpi! «Do ta themi fjalën, fjalën bash këtu, e ju do na dëgjoni, ashtu si e ka

dëgjuar e po e dëgjon fjalën e gruas e tërë Shqipëria. Pastaj shkojmë edhe në shtëpi. Por më parë, ama, do të flasim!» E kishin grumbulluar ato si plaga qelbin urrejtjen për zakonet skllavëruese që i kishin poshtëuar në shekuj, të gatshme për të shfryrë me tërsëllimë gjithë zemërimin për kanunin. P'eqtë qeshnë me shpoti. Dhe, deshën s'deshën, heshtën duke e shtypur përbrënda të gjithë zemërimin.

— Ore, po pse s'thatë të kishim marrë në mbledhje dhe qentë e macet? — foli dikush nga fundi.

— Dëgjova se do të bëhet fjalë për krushqinë e Martin Cukës — hyri në bisedë në tjetër. — Dhe mbledhjen e paska yshtur i biri, Pjetri, me Mara Cupin. Ata hedhkan gurin e fshehkan dorën.

— Në qoftë kështu, lere ç'do të vejë!

— Mos e pyet!

— Po Martini do të vijë, vallë?

— Ja, po vjen. Nëne, si i nxika fytyral Furtunë duket.

— Lere ç'do të vejë.

Ata u mblodhën dhe i bënë vend plakut të kërrusur, me shkopin në dorë e çibukun në gojë.

— Mirëmbrëma, Martin.

— Si the?

— Mirëmbrëma.

Ai u rrrotullua, e vështroi atë që foli dhe e përshëndeti pa zë, duke ngritur dorën mbi ballë. Pak më tutje qëndronte i biri, Pjetri. Sa e pa të jatin, ai uli kokën dhe zuri të gërryente dheun me një kleçkë të thatë.

— Epo, fillojmë, shokë, — tha sekretari i partisë, një djalë i ri, i veshur me një xhaketë kaki nga ato që marrin me vete ushtarët e çmobilizuar. — Ju e dinë se fjalë e shokut Enver e 6 shkurtit ka ndezur kudo

ajë zjarr tē madh revolucionar. Tē gjithë, tē rinj e pleq, janë ngritur më këmbë e po shkulin nga rrënjet zakone prapanike e besime fetare. Vetem ne kemi mbetur si ajo bolla nën gur e mezi po na del gjumi i dimrit...

Ai foli pér inisiativat e kooperativistëve pér pakësimin e oborreve personale, pér emancipimin e gruas, higjenën dhe ndjekjen e shkollave tē natës. Nga mënyri se si fliste, dukej që nuk e kishte thënë akoma kryesoren.

— O po, bjeri shkurt shoku sekretar. Na thuaj hapur ku rreh çekani, se unë jam ca i trashë dhe nuk para kuuptoj — e ndërpreu ai që rrinte në krah tē Martinit.

Djali me xhaketën ushtarake u kollit dy-tri herë, si pér tē fituar kohë.

— E mirë, po i bie shkurt. — Ai e vështroi ngultaz Mara Cupin, u kollit përséri dhe vazhdoi: — Puna është se ka shokë që ndryshe flasin në mbledhë e ndryshe bëjnë në shtëpi. E kam fjalën pér disa fejesa që janë lidhur kohët e fundit.

— Fol më hapur. Ç'thua kështu kodra pas bregut?

— Po, po. Do tē flas — dhe hodhi vështrimin përreth. — Ja, ta zemë nga xha Martini. Ai është burrë me një barrë mend, por këtë radhë..

— Heu! C'punë ka fshati me shtëpinë time? — pyti një zë, që i nqjau më shumë vërvhellimës së suferinës.

— Unë s'i kam futur hundët në punët e tē tjerve dhe s'lejoi asnjieri tē marrë nëpër këmbë fëmijët e mi.

— Giersa do vaïza, kot e kini — i erdhi në udhëmë al që kishte në krah.

— Ti mos i dil avukat. Le ta thotë Dila me gojën e saj e do, apo nuk do. Ja tek po vjen.

Dila mezi qëndronte më këmbë. Ajo u ndal pranë Mara Cupit. Oëndronte kokë ulur, nën sy i ishin formuar rrathë mavi. Ngjyrën e lehtë bojë rozë, që ia

zbukuronte fytirën, sikur ja kishte fshirë njeri me dorë dhe e kish lyer me diçka të errët, të zbehtë si balta. E ndjeu se të gjithë vështrimet qenë ngulur mbi të.

— Dila, mos ki frikë. Fol hapur! — i përshpëritën shumë zëra.

— Ki mëndje, e zezë! — kanoseshin disa të tjerë.

Ajo i dëgjonte këto fjalë nga të katër anët, i lexon te në fytarat, në sytë e shoqeve të saj. Në një çast ato vështrime u topitën dhe përpara saj dolën sytë e të jatit, si dy thika të mprehta, të ngulura në zgavrat. Ajo u step, por sakaq i buçiti në vesh zëri i Marës, i Pjetrit, i shoqeve: «Mos u tut, Dile, ja ku na ke ne» dhe u përpoq të kapërcente një lëmsh të hidhur që s'e linte të merrte frymë. Ajo e ndjinte se, po ta lëshonte veten, goftë edhe pak, nuk do të ishte e zonja as të mbante ekuilibrin e të qëndronte në këmbë. Dhe po të binte, s'do të ngrihej dot për téré jetën. Por ajo do të mbahej. Nuk do të binte. Jo. Nuk do të binte. Ajo e kuptoi se ato që do të thoshte nuk kishin të bënin vetëm me veten e saj, por edhe më shoqet, të cilat e vështronin ngultas dhe seç i pëshpërisnin. Dhe mori zemër:

— Më fal, baba, por... unë nuk... mund... nuk mundem, — foli me një zë të ulët, të dridhur, po të vendosur. Dhe ju duk sikur me këto fjalë shkuli diçka të rëndë që ja shtypte krahërorin.

Ishte e para herë në jetë që i kundërshtonte babait.

Martin Cuka hovi përpjetë, si ta kishte kafshuar gjarpëri..

— Më bëjnë veshët mua, apo me të vërtetë dëgjova zërin e vajzës sime?

— Jo, xha Martin, nuk të bëjnë veshët.

— I mjeri plak!

— Upupu, tē zezat ne ç'po na shohin sytël!
— Dila ka tē drejtë! — shtuan zjarr pér zjarr disa
tē tinj.

— Po, po. Ka tē drejtë.
— Ashtu më duket dhe mua.
— Ti, Selfo, e ke gojën tē zénë me bajgë. More
vesh? Me bajgë. Vështro vajzën tēnde o lumëmadh,
që e ke fejuar pa lindur akoma, me një mender...

Xha Selfos i cërriti në zemër. Ç'ju desh atij ajo
punë? pse tē ngacmonte folenë e arezave? Harroi që e
kish mizën nën kësulë. Njerëzit aq deshën. Ai dëgjonte
dhe mendja i fluturoi larg. Familja e tij kish qenë
në hasmëri, që kur nuk mbahej mend, me atë tē Mek-
shajve, në fshatin fqinjë. Që prej asaj kohe asnë nga
burrat e tē dy shtëpive, siç thoshin, nuk i kishte mbu-
shur tē tridhjetat. Dhe me siguri që as Selfos nuk do
t'i kishin dalë thinjat, në qoftë se nuk do tē qe çli-
ruar vendi dhe nuk do tē i shpejtë flakur jashtë vatrave
tona ky zakon i përzakur. Në vitin e dytë pas çlirim-
it, tē dy familjet qenë pajtuar me një a-tietrën dhe
kishin bërë dasmë e shkuar dasmës. Oël'oi që ruset
e tē dy shtëpive atëhere tē ishin shtatzëna. Në gëzim
e sipër, baball-rët e ardhshëm kishin shtrëngua duart.
Në qoftë se do t'i lindte njërit diale e tjetrit vajzë,
do t'i martonin me niéri-tietrin. Dhe ashtu noj'u vërtet.
Vitet kalonin. Fëmijët rritheshin. Po ndërsa vajza
e xha Selfos po shpërhente si një gonxhë, i fejuari i
saj kishte qëlluar një njeri gjysmak e i shëmtuar si një
dordolec. Që ditën që e pa, xha Selfua e humbi përgjithnjë gëzimin. «Më mirë tē kisha vajtur dhe unë me
tē tierët, se sa tē helmoia vaizën me duart e mia» —
thoshte. Po ç'mund tē bënte? Ai e kishte dhënë Falën
në kuvend dhe, donte s'donte do t'i bindej fatit. Me
kalimin e kohës, plaga e hapur sikur zuri kore. Por

u desh vetëm një fjalë që ajo tē shpërthente përsëri.
«Ti e ke zënë gojën me baigë. Vështro va zën t'nde
që e ke fejuar në djep me një mender...» – kish thënë
Martini.

Selfua e kish ndjerë gjer në palcë dhembjen e plaqës së vjetër dhe kish mbyllur gojën. Po nuk heshtën tē tjerët. Të rintjtë u ngritën më këmbë duke thirrur:

– Të prishen fejesat e djepit! Të prishen!

– Ngreu xha Selfo. Thuaje ti fjalën i pari.

Ai vështroi vajzën e tij, Sutën, që kish ulur kokën; kish mbërthyer me tē dy duart filizin e një lisi dhe qante me ngashërim, duke bërë që tē dridhej bashkë me tē dhe pema, sikur ta ndjeinte edhe ajo dhembjen gjer në rrënje. Selfos ju errën sytë. Ai hodhi vështrimin përreth, po nuk mundi tē dallonte asgjë. Të gjitha qenë ngatërruar në një lëmsh tē çuditshëm. Dëgjonte vetëm zëra. Prishe...! Prishe...! S'di pse atë çast i vajti mendja në disa vjet tē shkuar, në ata vjetë tē pasçlirimt, kur kish grumbulluar qere-tënë pér tē ndërtuar shtëpinë e vet. Ai qe i pari në fshat që do tē ngrinte një shtëpi me tulla, në vend tē kasolles. Njerëzit qenë grumbulluar në oborr tē tij, para kasolles që nxinte si nata dhe thërrisin: «Vuria kazmën Selfo! Kkreja binanë!» «Prishe...!» Ai ngriti kazmën. Dikush e nduku nga mënga: «Mos!» Por Selfua nuk donte ta shihte as me sy atë guvë, ku kish ngrysur vjetët më tē mirë tē rinisë së tij. «Prishe...!» Ai e goditi me tē gjithë forcën. Çdo gjë u shemb në pluhur. I erdhi ndot.

Ai u përpoq tē shkëputej nga këto kujtime. Ishte mbetur në djersë.

– Kështu ka qenë fati i saj! – tha me gjysmë zërit.

– Fatin e ndërtojnë njerëzit, xha Selfo. Hajde, bëje si burrat Thuaje fjalën këtu, faqe kooperativës.

— Prishe...! Prishe...» — thërrisinin tē rinjtē.

Ngado që kthehej, kudo që hidhte sytë, i dukej se përsërisnin atë fjalë që gjëmonte si bombë dhe më shumë se bomba: Prishe...! Por në vend që tē trembej, tē trishtohej, nisi tē ndiente një ndjenjë tē çuditshme. U përpoq tē kundërshtonte, po shpejt u bind se nuk do tē mund ta bënte këtë, nuk kishte forca ta bënte. Jo, jo, nuk mund ta bënte. E përse tē kundërshtonte, gjersa thellë në zemrën e tij e ndjente se ishte kundër asaj fejese. Tërë jetën kishte qenë kundër. E kish pasur ténk në zemër.

— Fol, xha Selfo! Thuaje ti i pari.

— Thuaje... thuaje...!

Ju duk se kështu thërrisinin jo vetëm njerëzit, po dhe pemët, rrugët, shtëpitë. Hodhi sytë nga Suta. Ajo edhe gante, edhe qeshte. Vështronte me frikë e shpresë nga i jati!

— Epo, ashtu qoftë, djema! Të prishet...!

— Urtaaa!...

Të gjithë qenë kthyer nga ai. Disa thërrisinin, qeshin, tē tjerë nxinin si nata dhe më keq se nata.

— Të lumtë, xha Selfo!

— E bëre fora!

— Të prishen tē gjitha fejesat e djepit!

— Të gjitha...!

Kurse tē tjerët:

— C'është ky turp?

— Kiameti... Do bëhet kiameti!

— Ai nuk është në vete. Ka lajthitur. Mos ja vini veshin.

Vajzat u lëshuan nga Suta e s'dinin si t'i gjëzoheshin!

— Dëgjove, moj? Babai e dha fjalën.

— Oh, Suta...! Si lum ti!

Martin Cuka akoma nuk po kuptonte ç'ngjiste. Kish

nxjerrë çibukun dhe po e mbushte me duhan. «Më duket se e harruan punën time. E harruan» – thoshte me vete. Ndérkäq njerézit thërrisin si në ethe. Vendi dridhej. Edhe shkëmbinjtë sikur u tuadën nga vendi e nisën të lëviznin me rrrokopujë.

— Me leje? Kam një propozim.

Zérat u fashiten njëri pas tjetrit.

— Foll!

— T'i shkruajmë një letër shokut Enver e t'i themi se shkulëm nga rrënjet edhe një ferrë tjetër.

— Dakort. T'i shkuajmë!

I gjithë fshati qe ngritur më këmbë dhe thërriste me një gojë: T'i shkruajmë! T'i shkruajmë!

— Po dale një herë. A e dhanë fjalën të gjithë?

— E dhanë. E dhanë.

— Po Martin Cuka?

Të dëgjojmë xha Martinin.

Me t'ja përmendur emrin, atij i ra çibuku nga dora. E ndjeu se të gjithë qenë kthyer nga ai dhe prisnin.

— Ju bëni ç'doni! — tha. — Unë s'e kam fejuar në djep...

— Ti po e mbyt me dorën tënde, si motrën e saj.

— Jepe, fjalën! Mos u nda nga të tjerët.

Nga të gjitha anët thërrisin. Ai zuri veshët me duar. I vështroi ashpër, desh të thoshte diçka, po ktheu mendje. U ngrit mbi shkopin e tij tëré nyje dhe hodhi vështrimin nga kulla. Në atë kullë kishte ngrysur më shumë se gjysmën e jetës, duke e vështruar botën si me anën e prapme të dylbisë nga frëngjitetë e ngushta, ku kishte vend vetëm për syrin e tij dhe për grykën e pushkës. Në jetë Martini kishte patur kurdoherë një nuhatje të fortë dhe e ndjente rrezikun që larg, si gjarpëri ernë e squfurit. Po ndërsa gjarpëri, kur nuhat erën

e squfurit, del nga foleja, ai mbyllej në kullën e gurtë dhe e ngulte syrin e grykën e pushkës tek frengjia. Thoshin se këto ja kish lënë amanet i jati, i cili ndaj edhe i kishte vënë emrin e pushkës së vjetër që mbante.

— Ju bëni si të doni — tha, duke u çapitur ngadalë.
— Unë po shkoj në kullë.

— Dale, xha Martin. Mos u nxito.

Tre — katër veta i dolën përpara. I thanë të mendohet. Atëhere nga shoqet u shkëput Mara Çupi dhe e vështroi ashpër. Të gjithë heshtën. Ai mbajti hapin.

— Ç'kini me xha Martinin? — pyeti komisarja. Me hir e me pahir, ai e ka marrë gruan e tij. Tani bëhet fjalë për Dilën. Dhe Dila ka vetë gojë. Askush s'ka të drejtë të flasë në emër të saj dhe ju afroa Dilës. E kapi atë nga supet.

— Fol Dila, Ç'mendon?
— Unë e thashë fjalën time. Jam e lirë.
— Ashtu, Dila! të lumtë...!
Martin Cuka u mat të thoshte diçka. Por të gjithë i kishin kthyer krahët dhe kishin futur në mes Dilën. Qeshnin e gjzonin bashkë me të. Ai e kuptoi se fjalë e tij nuk kish më asnje vlerë.
Dhe, i mundur, nisi të çapitej drejt kullës.

USTA PIRRUA

Ai ishte i ri në moshë. Akoma nuk i kishte mbushur tē tridhjetat, po tregonte pēr mē shumë. Kishte një vështrim tē rreptë dhe në mes vetullave i formoheshin dy trudha, si dy brazda tē porsahapura. Në lagje ishte b nori mē i ri, megjithatë, e njihnin gati tē gjithë, sidomos fëmijët, tē cilët mblidheshin me kohë e pa kohë para dy qanit tē tij dhe luanin e grindeshin me njeri-tjetrin. Ndonjeri nga ata nxirrte syrin në cep tē drıtares së vogël prej xhami tē barrakës dhe vështronte i lumtur atë mori këpucësh tē vjetra, gozhdësh, thikash e çekiçësh që qëndronin mbi tavolinën e vogël dhe nga tē dy anët e saj. Pastaj ja ngulte sytë krahëve plot muskuj e dama-rë tē këpuçarit që godisnin pa pushim tabanin e këpuçeve, gjersa dilte prej tyre një pluhur i imtë, që shpërndahej në tërë barrakën. N'erëzit kalonin me nxitim nëpër rrugicë dhe rrallë harrë kujtoheshin pēr barrakën e vogël në qoshe tē rrugës, megjithatë usta Pirrua ishte gjithënjë i zënë me punë e nuk ngrinte kokë nga mëngjezi në darkë. Vetëm atë ditë u ul me rërt së në stolin prej dërrasash, nga që nuk kishte asnjë dëshirë pēr punë. Qëndroi një kohë ashtu, pastaj u ngrit, hodhi përparsen dhe, duke fishkëllyer, u çapit ngadalë rrugës.

• • •

Ai ecte i përhumbur në mendime. Mëngjezi qe i freskët. Rrugicën e shtruar me kalldrëm e lëpinte një erë e ftohtë, kurse lart në qiell vraponin rctë ngjyrë gushë-

pëllumbi. Ai ngriti jakën e xhaketës, futi duart në xhepa dhe zgjati hapin. Sa doli në qendër të qytetit, ja preu rrugën një plak i kërrusur me bishtin e cigares gjithnjë në gojë, që kollitej vazhdimisht e thërriste kur e kur me zërin e tij të ngjirur:

«Bashkimi i Kombit» me laime të reja... «Bashkimi i Kombit». Rusët hanë grushte të rënda në frontin e lindjes... Kryeministri Libohova deklaron se brenda dy muajve...

Usta Pirrua shtrëngoi grushtat në xhapa dhe e vështroi me mëri shitésin e gazetave. «Po. Ata e nxorën gazeten... Kurse ne... ne...», dhe, ndërsa ecte, ju duk sikur kishte përsëri në krah shokun Çelik e dëgjonte shkoqur zërin e tij:

«Besoj se të thanë. Fashistët ranë në gjurmë të teknikës së partisë dhe na i shkatërruan».

«Po, më zuri veshi dicta...».

«U bë një javë që s'po nxjerim asnjë komunikatë».

«Ashtu?! Dhe ne vrissnim mëndjen pse nuk u shkrua për aksionin e parmbërëmshëm».

Shoku Çelik përëri e vështroi. Pirrua e kuptoi mirë se ç'donte të thoshte me atë vështrim dhë u përhoq të mendonte se ç'mund të bënte me shokët e tij.

«Ti e kuhton se kjo punë nuk mund të vazhdojë gjatë. Ne duhet të ngrëhim bazën e re të shtypit. Kjo është shumë e rëndësishme. Më kupton? Shumë e rëndësishme. Nuk duhet të humbasim asnjë ditë, asnjë orë. Nesër...»

Ai përmendi pastaj n'ë magjinë shtypi, ose shaptilograf siç i thoshin ndryshe, ndërsa Pirrua e dëgjonte në heshtje. Çelikut i dukej sikur ai nuk e kishte mendjen aty dhe shpesh i përsëriste mendimet. Kurse Pirros, në të vërtetë, nuk i shpëtonte asnjë fjalë. Dhe vriste mendjen ta kuptonte sa më qartë atë që kishte ngjarë. Pa shih si

qënka puna! U dashka në shaptilograf. E mirë. Po së ishte ky shaptilograf? Ku gjëndej? Në bashkinë e qytetit dhe në zyrat e depos së karburantit? Shumë mirë. Në depo mund të futeshin më lehtë. Po si ta gjenin shaptilografin? Si ta dallonin? Dhe, kryesorja, si ta shtinin në dorë?...

Ata shkëmbyen edhe disa fjalë, pastaj u përshëndetën e u ndanë. «Këto ditë na duhet – i përsërith shoku Çelik tek po largohej. – Shumë-shumë për dy-tri ditë Më tepër asnjë. Bile...» dhe shtoi diçka tjetër akoma, po Pirrua nuk arriti ta dëgjonte. Si mbeti vetëm, ai u vërtit një copë herë me shprejtë se do të takonte ndonjë nga shokët e njësitet, po nuk i zuri syri asnjërin. Ngado që vinte, si për inat, i di te përparrë shitësi plak i gazetave. Zëri i tij i ngjitur, që ndërpritei kohë me kohë nga një kollë e thatë, i dukej sifikur i futej në paletë. Kur ju afrua me gazetat nën saetull e i thirri tek veshi, Pirrua desh ja shfryu atij tërë millefin, po mendoi se shitësi i gjorë nuk i kishte ndoni faj dhe u çapit me mëdyshje më tej. «Po sikur të shkoja nga karburanti përtu niohur me vendin? Mbështetë atë xha Rr. pon... Dhe nata syve të mendies i rrëshqitësilueta e atij njeriu të moshuar, gjithmonë me ballin e rrudhur, i kërrusur, nga hallet që i rendonin mbi shpinë. I ra ndër mend se si disa javë më parë, në prag të vitit të ri, xha Rapua i lëshoi mbi tavolinën e punës tri-katër paë këpucë të vjetra fëmijësh. Pirrua i sol i gjatë nëpër duar, pa ditur ç'të bënte me to. Qenë aq të grisura, sa s'kish nga t'i kapje. «Kanë marrë fund këto, o xha Rrapo!» i tha klientit, duke e parë me keqardhje. Ai u ngrys dhe më shumë. Në fytyrën e tij u pësqyrua një dëshpërim aq i thellë, sa Pirrua u pendua për ato që i tha dhe i mori prap këpucët në duar. «E shoh, more djalë, por... përpiku një herë me atë tëndën. Dobarem për vit të ri të

mos u bjerë këmba në cingërimë.» dhe priti me frikë se mos ja kthente prapë. «Pa ta provoj një herë» u përgjigji ai dhe ju vu punës. Tri-katër orë të tëra u muat me to. E derdhi të gjithë mjeshterinë për t'i sjelë në din, gjërsa mbi tavolinë mbetën vetëm një palë këpucë të vogla, tabanet e të cilave ishin holluar aq sa s'mbanin as pe, as gozhdë. «Këto merri, — i tha — s'kam ç'u bëj. S'u jap dot firomë me zor». Xha Rapua u pre përsëri si në fillim. «Tu kishe bërë dhe këtyre një hall — ju lut. — Sa të luste këmbén kérthiu, pa pastaj le të griseshin.» Usta Pirrua i zgjati paqtën e cigareve.» Pa ndize një herë — i tha — dhe tek mijë qindi. Me paratë që do më jepje mua, blei një palë të reja. Bebzat e syve të xha Rrapos u drodhën nga gëzimi.» Çthua kështu, mor bir. Ti harxhove goxha material. Lere mënjanë mundimin.» «S'ka ç'derdhet nga thesi i grisur, xha Rrapo. Hajde, gëzuar festën!

* * *

Edhe tani i dukej sikur e kishte përparrë xha Rrapon. Ai s'dinte ç'të thoshte e ku të vinte. Seç murmuriti në për buzët që i dridheshin d'he u largua. «Sa shpëjt bëhet i lumtur njeriu!» mendoi Pirrua, duke zgjatur hapin. Atë çast, fare pranë tij frenoi një maqinë. Ai nuk e kishte mendjen dhe kérceu anash i trembur, duke shfrytë zëmërimin kundër shoferit. Po nga kabina dikush geshte dhe i binte vazhdimi ht borijes. «Të mori e mira. Ti paske qenë? Ta dish sa më ke trembur!» dhe ai hapi derën e zuri vend në krah të shoferit. Ndërsa maqina trëshqiste ngadalë drejt daljes së qytetit, Pirrua i tregoi shokut me hollësi për bisedën që kish bërë me shokun Çelik. Nekiu — kështu e quanin shoferin — e dëgjoi me vëmëndje. Befas u gjallërua dhe e lëshoi maqinën me të-së shpejtësinë, sa desh u përplas me një veturë që doli

nga rruga përballë. «Ç'bën kështu? Lojte!» ju hakërrua Pirrua. Po shoferi nuk e largoi këmbën nga gazi. Maqina kërcente mbi rrugën me gropat dhe dridhej e tëra si në ethe. «Pa dale ta marrim vesh një herë. Për ku shpejton kështu?» «Si për ku? Në do po n e karburantit do të shkojmë. Të marrin atë, si i thonë? shaptilografin.» «Jo more, derr në thes do na shpiesh? Pa dale ta mendojmë punën njëherë.» Nekiu nisi të q shte pa të k q. Ehu, po të mendohesha aq gjatë unë, nuk dridhja timonin nga mëngjezi në darkë! Shtyju tutje dhe mos e vra mendjen, se plakesh para kohe, budalla...» Dhe ja shkeli prap gazin, po vështrimi i treptë i Pirros e detyroi të pakësonte shpejtësinë, gjersa më në fund maqina qëndroi në të djathëtë të rrugës.

— Unë po zbres. Po lajmëroj Bajon dhe Mihon. Ti përpiku të giesh të tjerët. Hajt, nisu.

Nekiu e vështroi për një kohë tek lagohej me hap të nxituar, gjersa i humbi nga sytë pas kthesës së parë. Por, edhe kur nuk e shihte më, ai e shoqëroi me mend tek ecet nga njëra rrugicë tek tjëtra, për të dalë tek shtëpia e Bajos. Dhe, duke bredhur bashkë me të rrujave, ai mendoi për një çast se c'gjë e tmerrshme do të ishte për të, po të humbiste një shok si Pirrua. Ata ishin njohur disa muaj më parë, por detyrat që kishin kryer bashkërisht në njesitin gueril, — ato detyra që i kishin shpurë jo vetëm njëherë aq pranë rr zikut, — i k'shish afruat aq shunië, sa u dukej sikur kishin qenë tërë jetën pranë njeri — tjetrit. Nekiu nuk dinte në donte njeri tjetër më shumë se Pirron. Kjo vinte ndoشتë nga që ai, jo vetëm njëherë kishte përbuzur vdekjen dhe i kish shpëtar jetën. Sidoqoftë, Nekiu e donte atë gjer në adhurim dho e ndjente se me të do të mund të kryente çdo detyrë. E çmonte sidomos për guximin e tij të papërmabjatur, atë guxim që e kishte nxjerrë faqe bardhë

nga situatat pa shpresë. Q'është e vërteta, në fillim shokët e kishin kritikuar rëndë që ndonjëherë rrëmb h'j nga detyra që do të kryente dhe nuk i llogariste gjer në një të gjitha gjérat, ndaj kohët e fundit ai rra'lë herë h'dhët hapa të pamenduar. Madje kishte raste që Pirrua i vente aq shumë në kandar veprimet që do të kryente njësiti i tij, sa Nekiù mendonte se ai po ndryshonte dalëngadalë karakterin dhe i dukej se k'o vinte nga që kish filluar t'i trembej vdekjes. Këto ndryshime i kishte venë re edhe shoku Çelik, po si i kish shpjeguar krejt ndryshe, duke shikuar në këtë ndryshim shenja të pjekurisë dhe ngjitet në klasa më të larta të shkollës së luftës.

Fdhe atë ditë njësiti u mblohdh në vendin e zakonshëm dhe e shoshti mirë punën nga të gjitha anët. Pirrua u tha se partia kërkonte nga ata një shaptilograf dhe caktoi pa vonesë detyrat e secilit. Ai me Nekiun do të futeshin brenda në depo, ndërsa të tjerët do të shpërndaheshin në çifte rrëth saj e do të qëndronin të gatshëm për të hapur z'iar — po të ish'e e nevojshme — me qëllim që ta hutonin armikun e t'ua lehtësonin atyre t'rheqjen.

• • •

Disa orë më vonë, maqina e tyre u fut ndërmjet trikatër, të tjerave që prisin radhën të furnizoheshin me karburant. Pirrua përf'toi nga rasti dhe i hodhi edhe një herë sytë nga muri që rrëthonë depon. «Mirë e ruajnë — mendoi duke numëuar bunkerët e ndëruar në çdo qoshe. — Një... dy... katër... pesë... Megjithatë...» dhe desh të vazhdonte, po nuk arriti. Duke filluar nga rasti që nuk po i nd'zej motori maqinës që ishte përparrë, maqina e tyre rrëshqiti me shpejtësi në krah të saj, dhe çau përmes sheshit të gjërë, ndërmjet barrakave që shërbnin si zyra. Që lart bunkerët i vështronin me zgavrat e

tyre tē zeza, ku lëviznin sytē e akulltē tē pushkëve dhe mitralozëve. Pirrua bëri sikur nuk shikonte andej, por e ndjente se çdo hap i tij ishte nën mbikqyrje tē rreptë. Ai e dinte se në raste tē tillë, m'aftonte një hap i pamatur, që tē dështonte puna e tē vihej çdo gjë në pikpyetje, ndai duke shtuar kujdesin u përpoq tē shtirej sa më i shkujdesur e mospërfillës. Edhe kur ju afrua me hap tē shpejtë portjeri e nisi tē hakërrrohej, duke ngritur mbi krye në shkop tërë shkrepë, ai qeshi pa tē keq dhe i hodhi krahun mbi supe për ta zbutur. «Xha Rrapo, mos ja verë re se Nekiu kështu është, i rrëmbyer. Nuk e drejton ai maqinën, po maqina atë.»

Portjeri vazhdonte tē thërriste e tē tundte shkopin në ajër.

— Është si është ai, mua aq më bën. Tani shporruni, dilni përtjashta. Dhe prisni radhën. Mërret vesh?

— Dale xha Rrapo, merre më shtruar. Ne erdhëm këtu...

— S'dua tē di unë. Jështë rregul'ave nuk u lë sikur kaq ta bëni dhëmbin.

Shoferi e kuptoi se po trashej muhabeti dhe duhej vepruar me energji:

— Si tē duash — ndërhyri ai. — Po tē mos na lejosh, neve aq na bën. Punë kemi gjer në fyt. Nesër, kur tē vijnë zyrtarët dhe tē mos kenë me se tē merren, përgjigju vetë tek drejtori — dhe bëri s'kur do tē nisej e u kthye nga Pirrua:

— Hajde, usta.

Portjeri u përtyp dhe krojti zërin për tē fituar kohë:

— Dale, more zullap. Da'e tē shpjegohemi.

— Ehu, paske kohë ti, xha Rrapo. Neve nuk ëna pret puna.

— O po, ç'është kështu me juve. Xha Rrapo njëri, xha Rrapo tjetri. Nga më njihni, apo më kini prerë kërthizën? — dhe e shikoi për disa çaste atë që fliste. «Nuk më

njohu» mendoi Pirrua, i kënaqur që kish ditur të mas-kohej.

— Na fal, more shok, ke shumë të drejtë ti, po ja, nuk na pret koha — u përpoq ta merrte me të mirë Pirrua. Ai e dinte se tani ë gjithë puna ishte ta zbuste portjerin dhe ta shtronte në bisedë për të mos ngallur dyshimin e rojeve.

— Jo more! S'të pritka puna zotërisë sate? Ndaj më futesh ashtu zdruk — zdruk, si në mallin e tyt eti.

Pirrua u përpoq të hiqte një kartë tjeter:

— Neve na dërgoi këtu zoti drejtor për të ndrequr maqinat e shkrimit, pa ti si të duash...

— Ashtu ë? Po ndonjë pusullë për mua u dha drejtori?

— Jo.

— Atëherë kot e kini — dhe portjeri doli përpara e mbështeti shpinën tek dera. — S'kam nge të los me zjarrin unë. Jam me një tufë kalamaj.

Pirrua u kthyte me rrëmbim nga Nekiu:

— E sheh ç'na bërë tani? T'u ftoh pilafi ty dhe nuk tē pritej ta merrnim me shkrim. Hajde merru vesh tani.

Nekiu uli kapelen mbi sy, duke u shtirur mospërfillës:

— Në daç merru vesh ti, në daç mos u merr, mua aq më bën. Po tē pres dhe pesë minuta. Pastaj puthu me Zeqon.

Minutat kalonin njëra pas tjetrës e ata vazhdonin tē qëndronin në mes tē fushës.

Pirrua mendoi se nuk duhej tē humbisnin më asnjë minutë. Duhej tē futshin menjëherë brenda dhe t'u humbisnin nga sytë fashistëve.

— Xha Rrapo!

— Bjeri drejt, ku e ke hallin e mos më hidh degë më degë. S'kam kohë tē merrem me ju unë.

— Të futemi njëherë brenda, pa flasim pastaj. Mos

na pengo – dhe Pirrua nxori një tufë çelësa e i provoi me radhë. Xha Rrapua e vështron te duke ngritur supet. Ai desh t'ja flakte tej çelësat, por nuk e kuptoi as vetë përse u përmbyt. As vetë s'që në gjendje të thoshtë se ç'gjë të veçantë kishte ky njeri, që e detyroi të bërdej dhe të heshtte tamam atëhere kur duhej të kundërshtonte me tërë vendosmérinë. Ndërkq dera u hap, duke lëshuar ca tinguj të çjerrë që të futeshin në palcë. Portjeri eci disa hapa mbrapsh dhe qëndroi në mes të zyrës. Pas tij hyri Pirrua, ndërsa shoferi mbeti jashtë për çdo të papritur.

— Fol, nga më njeh ti mua.

Ai hoqi kasketën, syzat, dhe e vështroi duke qeshur e duke e lënë tjetrin gojëhapur.

— Pirro mballomaxhiu? Jo, jo, nuk është e mundur. Për perëndi që më bëjnë sytë. Nuk është e mundur.

Pirrua vazhdonte të qeshte gjithnjë, si i zënë në faj.

— Xha Rrapo. Ti je nga ata që ua ke mbushur fëmijëve lugën më shumë me lot, se me gjellë. Unë e di këtë. Dhe jam i sigurtë se do të kujtoheni shpejt.

— Mos më merr në qafë. Ç'ke ndërmend të bësh? Ti e di, kam një tufë fëmijë që presin nga duart e mia.

— Dëgj, omë me kujdes, xha Rrapo, dhe mos më ndërpres. Ne jemi djem të popullit, kemi...

— Ç'thuas kështu, more djalë?

— Po, xha Rrapo. Ne jemi komunistë.

— Komunistë? – ai desh të shtonte dhe diçka, po nuk arriti. Pirrua vazhdoi të fliste me nxitim:

— Ne duhet të marrim medoemos një nga këto – dhe tregoi me kokë maqinat që qëndronin mbi tavolina. Plaku rrudhi ballin e djersit.

— Nuk është e mundur. Kjo nuk është e mundur. Si ta bëj unë këtë? Ti e di se... kur ta marrë vesh drejtori...

— Xha Rrapo. Ne na dërgoi këtu Partia Komuniste. Ajo ka besim tek ty.

Roja bëri një hap prapa. Bebzat e syve sikur ju zma-dhuan. Buzët ju drodhën lehtë. Mërmëriti vetëm një fjalë:

— Partia...!

— Po, xha Rrapo, Partia Komuniste. Ajo na tha: «Xha Rrapua është patriot i mirë. Është trim. Shkoni dhe i thoni hapur se popul'i ka nevojë për një shaptilograf, dhe ai do t'ju kuptojë menjëherë e nuk do t'ju nxjerrë asnje pengesë. I thoni gjithashu që të mos bëhet merak për asgjë, sidomos për fëmijët. Çdo gjë që të ngjasë, për të do të kujdeset partial!»

Pirrua fliste me nxitim dhe nuk ja largonte sytë. Ai sakao kishte vënë përsëri kasketën, syzat. Xha Rrapua e vështronte gjithnjë me ngulm. Në të vërtetë ai kish dreituar mbi të sytë, por shikonte diku tjetër. Në veshët e tij kumbonin hapa të nxitaura, dëgiohej fishkëllima e bilbilit, krisma pushkësh, bombash, tamam si atë ditë kur u vra një nga krerët më në zë të fashizmit, kuestor Mazolini. Njérëzit thanë atëhere shkurt: «E vrau partial!» dhe nuk ditën si ta shprehnin gjëzin. Të nesëermen xha Rrapua lexoi një trakt të ngjitur në shtyllë, të firmosur nga Partia Komuniste, që paralajmëonte se ashtu do ta pësonin të gjithë sahanlëpirësit e fashizmit. Ai shikonte i gjuar se si dridheshin nga ai trakt spionë e tradhëtarë e nuk guxonë njeri të ngrinte dorën e ta griste. Para syve u derdhën pas'aj si lumë demonstruesit rrugëve të qytetit, kurse drejt lagjes së jahtme të qytetit, ku luftonin tre luanë, vërvshan me rrokopujë autoblinda, tanke, aeroplani. Njerëzve u lëvrinte zemra në krahoror dhe i pëshpërisnin shoku-shokut: «Ata nuk do të vdesin. Ata janë komunistë!» Dhe solli sakao

në mend, si bëhej në fytyrë dreitor, ai njeri shpirtkazmë, kur dëgjonte krisma në rrugë. S'iljej si hije nëpër zyrë dhe pëshpëriste duke u dridhur: «komunistë!» Pastaj, që atje ku ishte ju duk se pa gjuhët e fakës që shpërtheu në gazermat e ushtarëve italianë e u ngritën gjer në qelli. Edhe atëhere populli tha shkurt: «Këtë e bënë komunistët». Dhe përsëri ndjeu hapa të rënda mbi kall-drëm, zinxhirë tankesh, krisma, zëra. Fytyra e kuestorit, e drejtorit, fytyrat e ushtarëve që qëndronin mbi mure me gishtin në këmbëzën e armës, u përzien me njëra-tjetrën dhe në një çast mbi të gjitha ato u ngrit fytyra e mballoomaxhiut të lagjes, e Pirros, që i thoshte: «Mua më ka dërguar partia. Ajo ka besim tek ty!» Ju duk se grykat e atyre armëve, të armëve të roeve nga bunkerët, qenë drejtuar mbi gjoksin e tij e të shokut që qëndronte jashtë dhe nuk e kuptoi pse u droh i terti. Pirrua e vështronë i hutuar dhe nuk kuptonte ç'po ngjiste me të. Ndoshta nuk kish ditur të fliste ashtu siç duhei? Ndoshta nuk kish gjetur fjalët që duheshin. U përhoq të mendonte diçka tjeter, të vështronë edhe ai tej mureve të zyrës, atje ku rendte tanë mendja e xha Rrapos. Por nuk mundi të shihet asgjë tjeter, veç shitësit p'ak të gazetave që thërriste gjithnjë me atë zë të çierrë, të mbytur, që ndërpritei nga kolla. Mos shikonte atë edhe xha Rrapua? Ai qëndronte gjithnjë si i ngurosur në mes të zyrës, ndërsa buza i dridhej lehtë, kurse sytë, ata sv që gjer pak më parë shprehnin mëri e hutim, tanë shkrepëtinin nga një ndriçim i çuditshëm.

— Xha Rrapo!

— Biti im! Ç'më sheh ashtu? Shpejto. Merr ç'të duhet. Gjersa kam me vete partinë, ç'të dojë le të ngjasë! — Dhe përsëri sytë e tij u ngulën diku përparrë. Turmat e demostruesve shpërthyen muret e zyrës, morën përparrë me rrrokopujë rojet e armatosura, fashistët,

kuestorët. Për herë të parë në jetën e tij ai e ndjeu se kujt i përkiste, e ndjeu se nuk ishte i vetëm.

— Të faleminderit, xha Rrapo. Unë e dija se kështu do të thoshje — dhe Pirrua ja shtrëngoi dorën fort. Ai e njihte prej kohësh portjerin, por kurrë ndonjëherë sytë e tij nuk i qenë dukur aq të guximshëm, aq ëndërrimtarë. Pastaj u kujtua se detyra që i qe ngarkuar ende nuk ishte plotësuar. E brodhi vështrimin nëpër dhomë. «Cila është?» — pyeti veten dhe shikoi me ngulm maqinat, shukun e letrave, shishet me bojë, takëmet e shkrimit mbi tavolina. «Të jetë vallë ky?! — dhe zgjati dorën e preku diçka të fortë, metalike. Ajo ju duk çuditërisht e ftohtë. U rrënqeth. Jo. Nuk duhet të jetë kjo. Po, ku ta dish? Mbase dhe është. Ju afrua një tjetër, që kish brenda një fije letër të shkruar gjer në mes. U përpoq të lexonte, po nuk kuptoi asgjë, se fjalët ishin në një gjuhë tjeter. E vështri nga të gjitha anët maqinën, e preku me drojtje si të kish frikë mos e prishte. Nuk donte t'i linte përshtypjen portjerit se s'kish parë ndonjëherë shapilograf.

«Ec e merre vesh tanë cila është... Mbase kjo». Dhe ju afrua një maqine tjetër, e cila ndryshonte nga të tjerat. Para syve i dolën gërmë e numura të rrumbullakta, të renditura në radhë të drejta. Ai zgjati gishatin dhe goditi njérën nga ato: shkraf! Ju duk kjo si një shkrepje pushke. «Unë jam!» sikur i tha maqina me gjuhën e saj metalike. Ai goditi pastaj një gërmë tjetër: «Jo, nuk jam unë!»

Cila të jetë?

— Nuk e njeh, o i gjorë? — pyeti me qesëndi një zë nga pragu i derës. Ai u kthyte i trembur dhe i pakënaqur që ja zbuluan mendimet. Nekiu qeshte pa të keq.

— Jo. Mos është çekan a thikë dhe u gabova... Pëti ke parë ndonjëherë shaptilograf?

— Si jo. Por këta qënkan cazë ndryshe.

Ata qëndruan disa çaste në heshtje. Në mur lëvizte ritmikisht penduli i një sahati të vjetër. Tik-taku i sekondave sikur u pëshpërtiste pandërprerje: shpejtoni, shpejtoni, shpejtoni!

— E di ç'bëjmë? I ngarkojmë me radhë ç'ka e ç'nuk ka?

Pirrua u mendua.

— Mirë thua. Sa të humbasim kohën, i ngarkojmë. Dhe ju përveshën punës. Brenda disa minutave zyra ishte boshatisur. Ata u kthyen përsëri të shihnin mos kish mbetur gjë. Vetëm xha Rrapua qëndronte pranë dritäres dhe i vështron te i hutuar. Pirros seç ju kujtua. Shkroi me shpejtësi disa fjalë mbi një letër dhe e la mbi tavolinë. Pastaj ju afrua portjerit. E vështroi me mirënjojhe «Të më falësh, xha Rapo, por duhet të të lidh për t'u prishur mendjen fashistëve. Kështu do ta heqin çdo dyshim nga ti.»

Portjeri u bind pa nxjerë zë. Me një shpejtësi që tē habiste, ata i lidhën këmbë e duar dhe shkrojnë mbi një letër tjetër me gërmë tē mëdha: «Vdekje fashizmit — Liri Popullit!» — Njësiti gueril i qytetit.»

Dhe dolën.

* * *

Maqina frenoi pranë barrakës së një cigareshitësi. Para dhe pas saj u ndalën sakaq disa njërz me biçikleta. Pirrua bëri sikur nuk i pa. Zbriti ngadalë dhe, si hodhi një vështrim përreth, zgjati kokën tek dera gjysmë e hapur.

— I prumë, shoku Çelik.

Tjetri e vështroi ngultas: U ngrit më këmbë.

— Çfarë prutë?

- Po ja, atë, si e thonë, shaptilografin...
- Kaq shpeit?! — dhe zemra i rrëkëtiu në kraharon.
- Mos ju ndjek njeri?
- Nuk e besoj.

Çeliku e vështroi me dashuri usta Pirron, të cilin shokët kishin filluar t'i flisnin kështu, jo aq për moshën, as për vjetërsinë në profesion, por sidomos për mënçurinë, guximin dhe shpejtësinë me të cilën i çonte në vend detyrat që i ngarkoheshin. «Djalë i çuditshëm — mendoi. — Të tillë njerëz i nevojiten luftës sonë.» Por nuk tha asgjë nga këto.

- Hë për hë, shpjerini në shtëpinë e... Ijes.
- Maqina rrëshqiti drejt lagjes veriore të qytetit,

* * *

Tërë atë natë Pirrua nuk vuri gjumë në sy. A e kishte marrë vallë shaptilografin, apo e kishte mbushur maqinën me trangulla, të cilat shokëve nuk do t'u hynin farë në punë? Në qoftë se nuk e kishin marrë, si mund të futej të nesërmen në zyrat e bashkisë së qytetit? Cili nea shokët e njësitet kish pasur të bënte me shapti'ografë?

U ngrit me kokën që ziente nga dyshimet, kur nga plasat u derdh në barrakë një fashë e -b htë dritë. Në trugicë dëgjoi hapa të nxituar. Ato ndalën diku më sigurë. Dhe prapë ndalën. Këtë radhë fare afër, tek dera priti me zemër të ngritë të trokisnin. Por në vend të kësai, diçka rrëshqiti lehtas: fshشت! Dhe prap hapat gjëmuani në rrugicë. Ai u drodh si në ethe. «Ç'është kjo, — dhe zgjati dorën. Mori nië letër. E shpalosi. «Vdekje fashizmit — Liri popul'it... Komunikatë!» Tha se i pushoi zemra. Rrethat me gërmë nisën të lodronin e të vraponin para syve të tij dhe ai nuk arrinte t'i bashkonte

e t'i lidhte në fjalë, në fjali. Sado që u përpoq, nuk qe i zoti ta bënte këtë. E futi letrën në gji dhe hapë përgjysmë derën e barrakës. Ajri i freskët i shpupuri si flokët e pakrehur. Vështroi i çuditur. Në të gjitha shtyllat ishin ngjitur fletëza të bardha. Atij ju morën mendë nga gëzimi. Dhe nuk diti ç'të bënte. U hodh përpjetë. Preku me kokë tavanin. Pastaj goditi me grusht dërrasat e barrakës. Ato kërcitën. U tronditën tej e tej. Kish goditur fort. Por nuk ndjeu dhimbje. Asnjë dhibje.

Dhe u ul e nisi të lexonte me një frysme komunikatën.

RRUGËS PËR NË REPART

Autobuzi e la prapa rrugën malore, plot kthesa e të përpjeta, dhe u lëshua i lehtë e i vrullshëm nëpër rrugën e drejtë e të asfaltuar fushore, të trethuar nga të dy anët me plepa të lartë. Njerëzit, të lehtësuar e të rehatuar, u mbështetën nëpër ndenjëset dhe kush e afroi trupin te dritarja, kush lakmoi të merret një sy gjumë, kurse disa të rinj ja filluan një këngë labe e autobuzi u mbush me zërat e tyre gazmorë. Vetëm Nako Broka, ai fshatari me veshj n prej shajaku, një pale hejbe tek këmbët e cigaren në gojë, i cili hipi thuajse me pahir te stanet e trapunit në kohën që dera u mbyll e gjysma e trupit i mbeti jashtë, rrinte gjithnjë pranë derës. Kur hipi ai, shoferi thirri sa thirri e u mundua ta zbriste, por Nakua zuri derën dhe nuk tundej.

— Ore bërtit sa të duash ti, nuk zbres unë — tha këmbëngulës dhe u ul te shkallët e maqinës.
— Si mo nuk zbret! Malli i tyt eti është ky? — pyeti shoferi.

— I tim eti. E di ç'ke ti? Hiqja frerin dhe lëshoje më të poshtë, se ikën vetë kjo, si kali varvat. Disa veta qeshën dhe ju lutën shoferit që të mos e linte në mes të rrugës.

— Kot e kini — ua ktheu ai. — Nuk e marr sikur të piqet qelli me tokën. Nako Broka nxori kutinë dhe nisi të mplekste një cigare tjetër.

— Si tē duash — i tha. — Në mos ke ndonjë axhele ti, e kalojmë vapën këtu — dhe u përpoq tē ndizte eshkën me uror. Pastaj i zgjati kutinë: — Po deshe ndize një cigare nga kjo që tē mos mërzitesh.

Shoferi ngriti supet dhe ju afrua.

— Ti qenke tuaf njeri — i tha. — Si ore futesh kështu dhe nuk e bën që fin qeder? E di se po bëhesh pengesë që tē mbeten tridhjetë veta në rrugë? — Duke folur kështu, ai qëndroi përbalë fshatarit dhc e kundroi me kujdes. Ai nuk i kështë kaluar tē pe ëdhjetat. Kështë një trup tē shëndetshëm dhe një fytyrë prej baxhani, me ca vetulla tē trasha që i bashkoheshin mbi hundën me samar dhe një buzëqëshje tē përmabjatur.

— Ja, kështu jam unë, s'ke ç'i bën! — tha fshatar i duke rrudhur supet. — Po ta dish ama, se ashtu e kam hallin: dua tē vetë brenda ditës në Durrës, tē takoj djalin ushtar dhe tē kthehem shpejt, se jemi në vakt tē punës tanë.

Ky shpjegim pak i zgjatur u duk i tepërt për natyrën e tij. Gjer në atë çast ai kish ngu'muar tē mos zbriste e ishte dukur krejt i natyrshëm në këmbënguljen e tij. Po prap në sjelljen e tij, sidomos në atë buzzëqeshjen e sinqertë e tē përmabjatur, kishte diçka tē veçantë që nuk tē linte tē nxeheshe, madje tē bënte për vete. Kjo që arësyja që udhëtarët jo vetëm nuk u mërziten me qëndrimin e tij, por ju lutën shoferit ta merrte. Dhe ai, pasi piu cigaren, u ngrit duke i rënë lehtë supeve.

— Duhan i mirë, — i tha — Si duket, do bëhem i miq bashkë. Hajde, ulu në vendin e faturinës.

Ai ngriti vetullat e dëndura dhe vë htroi vrënitur.

— Jam për bukuri këtu unë. Hiç mos më luaj. Më duket si në sofatin e shtëpisë sime.

Po kur maqina u nis dhe filloj tē troshitej e tē futej pluhuri nga tē çarat e derës, ai u ngrit, mori hejbet dhe,

duke u mbajtur që tē mos rrëzohej, u ul nē krah tē shcferit. Sa zuri vend mirë dhe e treti vështrimin te, prapa krahëve dëgjoi një zë:

— Si the or shok, do vesh te djali ushtar?

Ai ktheu kokën për tē parë atë që foli. Ishte një meso burrë, me mustaqe tē gjata e tē zeza, i veshur si ai me rrobe shajaku.

— E, atje do vete.

Tjetri i lojti syrin shokut që kishte nē krah:

— Demek yt bir nuk qenka nga ata ushtarët e dalluar që i dërgon komanda me leje nē shtëpi, po...

Nako Broka kafshoi buzën.

— Ku e di ti se nuk është i dalluar? — ja preu fjalën bashkëfolësit.

— E marr me mend — u përgjegj burri me mustaqe Kur kisha unë djemt ushtarë, nieri vinte me leje, tjetri nisej. Dy-tre herë nē vit m'i dërgonte komanda. Dhe unë, që the ti, gjithnjë davet bëja. Sa herë vinin, fap ja këpusja kokën ndonjë gjeli dhe e shtronim pës pesë palë qejfe.

— Po ti, me qiqra e hodhe që djali im nuk është i dalluar? — e thumboi Nakua.

— Jo ore, jo me qiqra, po ma pret kaplloqja se po tē që i dalluar ai dhe ta dërgonte komanda me leje, nuk do kishje nevojë tē ngriheshe ti e tē shkojë atje.

Nakua i përtypi disa fjalë nëpër dhëmbë. «Djalli vete genka ky musteqelli. Ma gjeti brengën» mendoi. Po nuk e dha veten.

— Me që u bëre merak e pyete. ja ku tē them se im bir — gënjeu ai — ka ardhur kushdë sa hënë me lëse Po prindi është prind dhe e merr malli — shtoi me zë tē ulët.

— Aha, s'është gjë ajo punë — e ngau fjalën tjetri. —

Sa më shumë t'u vesh prapa atyre qeratejve, aq më tepër u rriten veshët e u bëhen si të...

— Të kujt? — pyeti një djalë.

— Me ndër, si të gomerëve.

Në maqinë shpértheu e qeshura. Kur ra heshtja, udhëtarët pritën me kërshëri të rifillonin romuzet në mes të dy fshatarëve. Nako Broka vriste ndërkaq mendjen si të merrte hakun, po burri me mustaqet gjer te veshët prap u tregua më i shkathët.

— E dini ç'ngjau një herë në fshatin tonë? — pyeti?

— Kemi një plakaruq në fshat, që thatë ju, tamam sidozot ky shoku këtu. Edhe ai e kishte djalin ushtar. Lere ç'harakat djalë. Zor t'ja gjëje shokun. Të gjithë shokët e tij vinin me leje, kush pesë ditë, kush d'jetë ditë, kurse ai as i gjallë, as i vdekur. Shkoi viti i parë, u gjysmua dhe i dyti, kurse të dy pleqtë vështronin derën me zemër të ngritë. Prit e s'ka. As d'ali, as letra. Dhanë sa dhanë të shkretët e s'duruan më. I nisën një telegram urgjent: «Babai po e dr d'i bishtin Hajde sa më parë.» Kur të shoç ti, të nesërmen sap u mbiu i biri në shtëpi. Qe bërë qu'l në djersë nga të nxituarit. Sa futi këmbën në shtëpi, pa tanë duke numëruar tespitet te oxhaku. «Ja moj grua tek të erdhi djalë, se më hëngre veshët, gëç bëlanë.» Ushtari e humbi toruan. «Si je me shëndet, baba. Unë...» «S'ke faj or b'r, që shkeq, po u bëra qiqër sa të pashë ty.» Dhe qeshi me djallëzi. Djalit sikur i ra pika. Vërtet kish qenë ca i prapë ai, po ushtria e kish prurë në din. «Ama kës'tu ma punuat — u tha. — Dale pa jau dëftoj unë.» Dhe shkroi një fletë-rrufe sa një çarçaf, ja u ngjiti prindërvë në mes të fshatit e iku që atë natë, pa u çm'allur mirë.

Nako Broka dëgjonte dhe herë ngrysej, herë vinte buzën në gaz. Pa shih, ç'paska ngjarë në fshatin e tyre. Njëherë edhe atë desh e gënjeu mendja të dërgonte ndo-

një telegram në repart. Po prap qe burrë me mend ai dhe nuk shkeli në dërrasë të kalbur. E ndërsa mendonte kështu, maqina e la rrugën malore dhe zbriti në xhadënë e asfaltuar. Njerëzit u afroan nëpërt dritare ose dremitën duke u kolovitur leht[–]-lehtë nëpër nd njëset.

Nukua ndezi një cigare tjetër – ai is'te i v tmi pasagjer që fitoi të drejtën ta bënte një gjë të tilë në udhëtim e sipër – dhe, duke e tymosur, e përpinë mendimet. Tani që autobuzi u lëshua me shpejtësi rrugës fushore, duke e mbështjellë me lehtësi nën vete shiritin e murmë të asfaltuar, dhe Elbasani, ku ai do të merrte trenin për të vazhduar udhëtimin nuk ishte larg, filluan ta ngacmonin mendime nga më të ndryshmet. Për një kohë u grind me plakën e tij e cila, me atë qetësinë dhe durimin e saj që ia ngrinte shpesh nervat, kish ngulur këmbë që i shoqi të nisej menjëherë për te djali e të shikonte si qëndronin punët.

– Çështë kështu me ty, more burrë? Nuk guxon njëriu të këmbejë një fjalë, se fap merr zjarr si kashta. Dale ta tëhollim një çikë punën. Përsë të mos shkosh.

Ai u mbështet në minder. «Ehu dhe ti plakë, gjithnjë në një vrimë i bie fyellit. Pa lena rehat tani, se nuk ta kemi ngenë». Po nënë Lena heshtë një copë herë sa të mos i kërcente giaku në kokë, dhe përsëri i tha me atë zë të butë e këmbëngulës:

– Unë them se duhet bërë një gjë, pa ti si të duash.

– Po rri rehat moj e uruar dhe flije mendjen, se kjo është shaka dhe hiç gjë tjetër.

– Pse kuvëndon kështu, more burrë!

– Po moj lumëmadhe, shokët e tij kanë bërë shaka. Dëgio mirë ti. Nuk e mban mend kur na shkroi djali se në ushtri ka gjetur shokë të mirë, shakaxhinj, që e duan shumë e lënë kokën për të.

Nënë Lena, si kudo, edhe në të menduar ishte e nga-

dalëshme. Ajo dëgjonte në heshtje, pastaj përpinqej t'i bluan te mirë me mullirin e saj ato që i kishin thënë dhe t'i peshonte mirë fja'ët para se t'i nxirrte nga goja. Kështu bëri edhe në atë rast. I mori fjalët një e nga një, i ktheu nga të gjitha anët në mëndjen e saj, pastaj u përgjegj prerë, duke tundur kokën:

— Këtu s'ke fare të drejtë. Dëgjomë dhe mua njëherë, pa le të të dalë keq.

Po i shoqi lëvizi dorën me mospërfillje në ajër, pastaj u ngrit dhe, duke ecur rëndë-rëndë mbi dërrasat e dyshemesë që tundeshin e nxirrin një gërvimë të zgjatur e të thellë, u ul te pezuli, në krye të shkallëve. Edhe e shoqja u ngrit sakaq dhe e ndoqi pas si n'ë manar i bindur. Atje zunë vënd karshi njëri-tjetrit, si tak më paë. Nakua mblođhi vetullat i pakën-qur, si të donte të thash-te: pse m'u bëre rrudhe, moj gjeç belanë? Po e shoqja u shiti sikur nuk e vuri re këtë dhe nxori me kujdes nga gjoksi një zarf të zhubravitur e i foli së mbesës që luante e shkujdesur me moshatarët në rrugicë:

— Trëndelinë, o Trëndelinë pa hajde një çkë te gjyshja, se do të gostis me një gicë.

Mbesa u nda me përtesë nga shoqet dhe vranoi në krye të shkallëve.

— Na, merri këto arra dhe lexoja njëherë me kujdes letren gjyshes.

— Uh, prap ta lexoj?! — shfryu ajo me padurim.

— Prap, xhan i gjyshes, prap.

Trëndelina nisi t'i lexonte me nxitim ato fjalë që, jo vetëm ajo, por dhe gjyshi me gjyshen i kishin mësuar përmëndësh dhe i përsërisnin në heshtje, duke vështruar njëri-tjetrin në sy. Në letër bëtej fja'ë për dialein e tyre, Luan Broken, i cili i shërbente atdheut me ndërgjegje të larë në n'ë repart të artilerisë bregdetare dhe arrinte rezultate shumë të mira në stërvitje, duke

u bërë shembull për shokët e tij. Kohët e fundit, siç shkruhej në letër, Luani qe nderuar me shenjën e ushtarit shembullor. Më në fund shokët e komandës falenderonin prindërit e tij që kishin rritur dhe edukuar një ushtar të mirë të popullit e atdheut.

Si mbaroi së lexuari, mbesa ia lëshoi letrën në prehëri gjyshes dhe u lëshua me vrap shkallëve, pa e vënë te gjëzimin e thellë, të përzier me një ndjenjë hutimi, që shprehnin ftyrat e pleqve. Dhe kjo vinte se në letër kishte aq shumë fjalë të mira, sa nuk u vinte t'u zinin besë. Gjatë tërë jetës së tyre ata nuk kishin dëgjuar ndonjëherë lëvdita të til'a. Ndaj u dukej se kjo ishte një shaka e shokëve të Luanit dhe asgjë më tepër. Ata ndofta e kishin lexuar letrën që i kishte dërguar jo shumë kohë përpara i jati i tij dhe kishin stisur një marifet të tillë për t'i gjëzuar prindërit e dëshpëruar. Në atë letër Nako Broka shprehte të gjithë pakënaqësinë që i biti, pas pesëmbëdhjetë muaj shërbimi, nuk e kish bërë hak të merrte pesë a gjashtë ditë leje dhe të gjëzonte prindërit që trinin kokëulur para fshatarëve. Gjer atëhere të gjithë djemtë që kishin shkuar ushtarë, kishin marrë kush një e kush dy herë leje shpërblimi dhe i kishin gjëzuar sa më s'ka prindërit e tyre. Kurse atij, Luanit, nuk i bënte lëkura as pesë groshë. Dhe Nakua nuk mbante mend ç'shonte tjetër. Atë ditë ishte gjith hundë e buzë dhe s'kish lënë fjalë pa i thënë. Më pas e kuptoi dhe vetë që e kish shkelur, po letra kish marrë rrugë e ai s'kish si ta kthente. E shoqja nuk dinte asgjë nga këto, ndaj ai nuk çudtej aspak me këmbënguljen e saj.

— Po rri moj lumëmadhe, se janë të ngatërruara këto punë i thoshte.

— Ç'thuas kështu, more burrë — habitej ajo. — Përse

na e ndjell kështu të keqen, në vend që të gëzohesh për letrën që na erdhi.

Dhe zinin e kujtonin fjalët që qenë shkruar në letër. Nakua e niste, nënë Lena e priste. E pse ta vrisnin aq shumë mendjen, thoshnin. Luani nuk qe nga ata djemë që s'dinë ku lenë brashnjat e tyre. Përkundrazi, që në vogëli nuk i lente dy gurë bashkë. Në të gjitha punët e mbrapshta që bëheshin, me siguri do të kishte gjith edhe ai. Në qoftë se thyehej ndonjë xham me llastika, në se zhdukeshin vezet në furikun e ndonjërit apo kthe heshin bagëtitë nga kullota me gjitë e shkundur, në këto marifete do kishte medoemos dorë edhe Luani. Njerëzve ua kishte prurë në majë të hundës. «Ç'ja hap ashtu syrin, a derëzi, sikur do të bëjë kokovenë e kuqe — i thoshin shpesh moshatarët Nakos. — Shtroje ore në dru sa t'i duket prifti gomar dhe ke për të parë se ç'djalë do të bëhet.» Nakos edhe i vinte inat, edhe i bëhej qejfi. «Epo helbete djalë është — thoshte — ç'i do dhe ata gjymtyrimët që s'dinë të nxjerrin as qimen nga qulli. «Dhe i qeshte buza vesh më vesh kur shihte si hidhte shtat i biri e si kacafytej me moshatarët e tij, të cilët ja kishin frikën. «Më ngjan mua shejtani! — thoshte në këto raste. Ndërsa kur bënte ndonjë të prapë e i merrej emëri nëpër gojë fshatit, ngryste vetullat e vërtitej nëpër divan, duke ju kanosur së shoqes: «Ç'është kështu me të, xhanëm? S'të ka lënë gjë. Sikur ta kesh nxjerrë nga hundët!» Nënë Lena qeshte nën buzë. «E po doemos që do na ngjasë, se yni është». «Jo, jo. Mua as në thua të këmbës nuk më vjen. Hedh nga ty ai.»

Nakua e kishte pritur me shpresë kohën kur do të shkonte ushtar i biri. «Është shkollë ushtria, — i thoshte së shoqes. — Dëgjomë mua ti. Ke për të parë po nuk u bë çelo në ushtri. Kur të kthehet andej, nuk do ti

thotë më këmbës dorë.» Ndaj e kishte bërë festë ditën që e nisi djalën ushtar. Ja kish thënë pastaj disa falë që t'i mbante vath në vesh. Dhe numéronte muajt me gisht. Numéronte e priste ta shihte në derë të rritur e të forcuar, po dhe të p'ekur e të argasur. Po muajt shkoniin dhe atij se ç'i mblidhej një lëmsh në gjoks kur kujtonte të birin. Nakua përpiquej ta hidhte jashtë dhe të mos e bënte veten, po nuk e linte të qetë e shoqja. Ç'është kjo punë, mor burrë, i thoshte. Pa çalltis dhe ti si të gjithë të tjerët e shko shikoje si i ka punët.

Ai pa ç'pa e u nis. Dhe as që e morri vesh si i kaloj rruga, duke kuvenduar në heshtje herë me të shogen, herë me veten e me shokët. Kur po i afrohej repartit dhe pa një ushtar roje te hyria, cer ja bëri zemra. Po sikur të qe Luan? Eci me hap të shpejtë, pa ja larguar sytë. Një zë i fortë e mbërtheu në vend. Jo. Nuk qe ai. Nako Broka uli hejbetë dhe priti. S'kaloi shumë dhe ju afrua një ushtar tjetër me një shenjë të kuqe krah.

— Jam babai i Luan Brokës — i tha. — Erdha të takoj djalin, — dhe ja nguli sytë ushtarit, përtë parë se si do t'i priste fjalët e tij. «Po ta kenë bërë këta letrën, do më japë ndonjë shenjë» mendoi. Ju duk sikur roja seç përtypi nëpër dhëmbë.

— I ati i Luanit? — pyeti ushtari dhe sikur u hutua për një çast. Të paktën kështu ju duk Nako Brokës. «E sheh? Ky zullap do ta ketë shkruar letrën...» Sakaq ushtari qe bërë erë. Atij ju dukën të gjata tarkuzë ato minuta. I bënte sytë katër se mos dallonte të birin në mes të ushtarëve që lëvronin poshtë e përpjetë nëpër repart. Po ata i dukeshin të gjithë njësoj. Më në fund ju afrua ai ushtari me shenjën e kuqe në krah. Ishte vet i dytë, me një oficer të ri që nuk kish shkuan mirë brisk në faqe. Ai nuk arriti as ta mblidhte veten, kur

oficeri i zgjati dorën dhe ju hodh në qafë, si të ishtedjali i tij:

— Mirse na erdhe, babai i Luanit! Si jeni me shëndet? Si shkojnë punët andej, nga kooperativa?

— Mirë, ore bir. Shumë mirë. Të fa'eminderit — dhe vështroi nga ushtarët që po fërmbul'cheshin në postbllok. As kjo nuk ju duk shenë e mirë.

— E di se keni telashet tuaja dhe s'na i kini nçenë neve, po ja, nuk m'u durua dhe erdha. Të shoh njëherë me sytë e mi si i ka punët, t'ashë.

— Domethënë e kini marrë vesh?

Nako Brokës s'i mbeti më pikë dyshimi. «E sheh? Këta zullanër e kanë bërë.»

— E mora, mor bir, e mora. Shokët...

— Po, baba shokët. Një shkarje e vogël që desh na kushtoj shtrenjt.

«Pse s'thua: na kushtoi, po «desh na kushtoi.» Ne kemi dy-tre ditë cë s'vemë g'umë në sy».

— E po diem janë, o shoku komandant, dhe ç'e kugabojnë nganjëherë.

— Të mos qe hedhur në kohë Luani, do t'i kish marrë lumi të gjithë. Po tani është mirë. Fare mirë.

Nako Broka kapsalliti sytë.

— Kush kështu?

— Luani.

Ai shikonte herë komandantin, herë ushtarët që qenë afruar dhe nisen të flisnin pa i lënë radhë njëri-tjetrit.

— Babai i Luanit? Sa mirë. Ke një djalë të mrekullueshmë! Shokun tonë më të mirë.

— Ne të nisëm dhe letër, besoj e ke marrë.

— Po, e mora. Po... n'ë gjë s'kuptova Kush e shkuante: ju, apo komanda.

— Ne, shokët. Komanda. Të gjithë bashkë.

— Për të shkroi dhe gazeta. Nuk e kini lexuar? Ja,

ë faqe të parë: «Një akt heroizmi për të shpëtuar shokët.» Shikoni dhe fotografinë.

Nako Broka mori gazetën dhe nuk po u besonte syve. I dukeshin të gjitha si shaka, një shaka e bukur, e këndshme, që donte të mos kishte mbarim. Vështroi një hap fotografinë. «Hë, more b'r, më thuaj ti, shaka është apo...» Luani i buzëqeshte që nga gazeta: «Mos u bëj merak, baba. Çdo gjë kaloi mirë.»

— Po ç'ka ngjarë, xhanëm! Unë s'po marr vesh.

Komandanti e kuptoi se i ati i ushtarit nuk dinte si qëndronin punët. Dhe nisi t'ja shpjegonte me radhë:

— Asgjë për t'u shqetësuar, b ba. Ne ishim në stërvitje dhe po shtynim topat me krahë. Qe një vend shumë i thyer. Topi i dytë rrëshqiti dhe po shkonte me shpejtësi drejt greminës. Numërorët përpinqeshin ta mbanin, po nuk ja dolën dot. Nga çasti në çast mund të ngjiste fatkeqësia. Të gjithë shikonin me gjak të ngrirë. Vetëm Luani nuk e humbi. U hodh nën trota dhe ja ndryshoi rrugën topit. Shokët shpëtuan përmrekulli. Edhe ai gjithashtu. Në fillim qe rrezik të humbiste këmbën, por mjekët bënë të pamundurën. Tani është si molla. Këto ditë del nga spitali.

Nako Broka ishte si në ëndërr. Për një kohë nuk qe në gjendje të thoshte asnje fjalë. Pastaj i hodhi pas krahëve të gjitha dhe vetëm për një gjë mendonte: të takonte sa më parë Luanin.

NJË NATË DIMRI

Në dhomë ishin tre veta: xha Gori, e shoq'a — nënë Lola dhe Drita, nusja e djalit të vetëm që kishin ushtar. Po dukej sikur brenda s'kichte njeri. Secili qe ulur në vendin e tij: pleqtë dy qoshet e oxhakut, ndërsa e reja karshi zjarrit, mbi një fron të vogël, dhe rallë e tek shkëmbenin ndonjë fja'ë. Gratë thurrnin, çorape të trasha leshi dhe kur e kur i hidhn'n nga një vështrim kuptimpoë njëra-tjerrës, si të vazhdan në bes' tje një bisedë të fshehtë. Xha Gori, burri tretë të gashtëd' jetave, me flokë krejt të zbardhur dhe vetullat e trasha, nën të cilat shikonin dy sy të ëmbël e të qeshur, e pikasi kuvendimin e tyre të heshtur dhe desh të pyeste, po prap ndërroi mëndë e. «Punë grash» mendoi dhe u ngrit. Përshkoi me një çap të rëndë e të ngathët gjatësinë e dhomës së zjarrit dhe u ndal pranë dritarës. Fshiu me pëllëmbë të dorës avullin cë kish veshur xhamat dhe u afroa aq shumë sa hunda preku xhamin e ftohtë e ai u mundua të dallonte se ç'mbulonte nata me sharkun e saj të zi.

Jashtë shfryntë suferina dhe atij ju duk sikur, bashkë me kanatat e dritarëve, e gjithë shtëpia dridhët nga të ftohtit. Mori një dorë duhan dhe, po me atë hap të ngathët e të rënduar, ju afroa qoshes e nisi ta grinte, duke i mëshuar thikës me të gjithë peshën e krahut.

«Duhani i mirë», mendoi duke nuhatur erën e tij të fortë që e bëri të tështijë dhe prap e hodhi vështr min nga e shoqja dhe e reja.

— Po pse e qepët kështu gojën, o të uruara? — foli pa e hequr vështrimin nga duhani. Në vend që të përgjigjej, nënë Lola u ngrit, hoqi fillin e lëmshit nga qafa dhe e la mbi postiqe.

— Do vete ti flas Polies — tha duke vështruar në mënyrë kuptimplotë nga e reja. Xha Gori kapsall ti sytë.

— Vërtet thua?! — pyeti duke shikuar herë nga e shoqja e herë nga e reja.

Drita, si e zënë në faj, nuk guxonte t'i ngrinte sytë, kurse, nënë Lola nuk qe e zonja të fshehte gëzimin. Ishte një gëzim i thellë ky, i përzier me një ndjenjë padurimi e pritjeje, çë e bënte t'i tri-te z mra fort. Xha Gori kish veshur sakaq këpucët e rënda me proka dhe kish hedhur supeve pallton prej shajaku.

— Vërtet thua?! — pyeti përsëri, duke hapur përgjysmë derën. — Dale se i bëj zë unë Po'ies — dhe e përdiu sakaq errësirë e natës. Në filim ju duk se kishte përparrë një hon të errët e të thellë dhe i hodhi me drojtje hapat, po shpejt ju mësuau sytë me errësirën dhe eci i sigurtë. Nga rrugica ju ndërsyen tre-katër qen. Ai tërhoqi një hu nga gardhi për t'u mbrojtur dhe cau fërpjetë. Qentë e ndjenë rezikun dhe, si hamullitën duke nxjerrë ca ulurima të zgjatura, nuk e ndoqën më. Ai i ngjitej me nxitim së përpjetës. Gati s'a s'vrapont, me gjithatë i dukej sikur nuk ecte po qëndronte në vend. Kohët e fundit, kur ishte vetëm, ai kish kuvenduar shpesh me mëndje me nënë Polien, madje n'ë natë e k'shë parë edhe në ëndërr duke dalë nga dhoma me një djalë topolak në duar, po ai kurrë s'e kish marrë me mend se do t'i ngjitej kështu së përpjetës, sa t'i zihcj fryma e të mos ngopej me ajër. E ndjente se kjo i vinte më

shumē nga gëzimi se sa nga tē rendurit. Tani qē kishte arritur nē një moshë tē tillē, ai kish menduar shpesh se gëzimi më i madh pér tē do tē qe tē bëhej giysh. Nē tē vërtetë ai kishte menduar pér këtë jo vetëm tani qē ish shtyrë nē vjetë, por shumē më përpëra. Edhe kur njëzet e ca vjet tē shkuara i kishte lindur d'ale, pas gjashtë vaizave, dhe i ishte dridhur zemra nē kra-hëror nga gëzimi, edhe atëhere mënd'a e tij kish vra-puar nē vjetët qē do tē vinin dhe ish munduar tē përfytronte d'alin e d'alit, atë zull-p'in e vogël qē do t'i ngjante atij dhe do ta mbante tē hapur derën e shtëpisë së tij. Edhe kur nxitoi ta martonte tē bitin, edhe kur nē shtëni i erdhi nus'a si një thëlëzë mali e njërezit e uronin tē trashëgohei, ai prap kish menduar ditën kur do tē bëhej b'rba - giysh e shtëpia e tij do tē mbushej me mysafirë. Pas martesës së tē b'rta, ai mezi kish pritur sa tē mbetej e reja shtatzënë dhe shpesh kish menduar me frikë nē zemër se c'do tē ngjiste kur ajo t'ë mos lindte, apo tē lindte vetëm vajza. Në këto raste ai ndizte njerin cigare pas tietrit dhe, përmes tymit tē duhanit, i dukei sikur e shihte derën e shtënisë së tij tē mb llur përgjithnjë, me bar e ferra nëpër shkallë, ndërsa shtëni nē tē anuar e gati tē shembej. Kurse tani, ja t'k e shihte atë derë tek po hapej nga tē dy anët, dhe vraponë që tē zinte qoshën e gjyshit tē gëzuar e tē priste siç ja donte zemra u imet e ba'hkëf-hatarëve: «Të ruat, o xha Goti. U bëftë p'ak me mjekër tē bardhë»: «Faleminderit. Gaz paçi nē shtëp'të tuaia». Ai e shihte pastaj nipi tek zbriste shkallët gati pér t'u rrëzuar, duke vrapiuar pér t'ju hedhur nē prehër. «Oerata dia'ë ky nipi i xha Gorit. S'i ka lënë gjë tē gjyshit. Sikur ta ketë nxjerrë nga hundët.»

Ai shpuri buzën nē gaz. I qe afruar shtëpisë së nënë Polies. Para se tē kapërcente pragun, mbajti hapin. Ju

kujtuā se pak mē lart ishte ambulanca e fshatit dhe akoma mē lart dhoma ku banonte a'o vajzē e re qē kish ardhur nga qyteti, mamija si i thoshin. Po sikur tē merrte atē? I doli parasysh ftyra e saj e droitut, me vështrim tē ngulut. Dukej vajzē e hedhur dhe thoshin se nē shkollë kish dälë mirë, po ja që nē fshat nuk e vinte njeri nē hesap. Thoshin se nuk i afrohej as nē gisht tē këmbës nënë Polies, që kish pritur nē duart e saj e u kish lidhur kërthizën tē gjithë fëmijëve tē fshatit. Dhe asnijëherë s'i kish ndodhur ndonjë e pabërë. E ç'i duhej mamija atëherë? Polia ishte sa për dhjetë. Dhe ai u ngjit. Trokiti nē derë. I foli. «Pole, o nënë Pole!» «Kush është te dëra?» «Hape. Jam unë, Gori. Ai ndjeu hapa që u afruan. Dërrasat e dyshemesë kërcitën. Pastaj llozi i hekurt. Dera u hap. Në gjysmë errësirën e dhomës, xha Gori dalloi ftyrën e saj tërë rudha, si një beze e zhübavritur. I tha me dy fjale si qëndronte puna dhe ju lut tē mos humbiste kohë. Ajo hodhi kraheve një shall tē zi dhe e ndoqi pas nē heshtje. Zakanisht kështu ngjiste. Vinin dhe i flisnin natën ose ndaj tē gdhirë. Ajo e dintë se nē kësi rastesh njerëzit bëhen tē paduruar dhe mundohen tē mos humbasin asnijë minutë. Mezi arrinte t'i ndiqte pas, aq shpejt ecnini. Dhe gjithnjë burrat bëheshin llafzanë, thoshin disa fjale pa kuptim dhe mezi e kapërcenin pështymën. Polia qe mësuar me këtë dhe rrallë e tek përgjigjej. Edhe xha Gori kështu bëri gjersa arritën nē shtëpi. Atje heshti dhë mbaiti hapin i hutuar, si tē priste nga nënë Polia se ç'duhej tē bënte.

— Ti Gori shko lart nē dhomë dhe këputja gjumitë. Sa tē na lindë nipi, vi tē them unë — foli ajo me zë tē prerë e urdhëronjës. Ai u bind. Ngjiti me nxitim shkallët — kaq tē lehtë e ndjente trupin — dhe hyri brenda.

Sado që nē vatër digjej një kërcu i trashë me kë-

çepa, në dhomë ishte ftohtë. Ai mori mashën dhe e krojti trungun e i fryti. Në fillim u shkëputën qindra shkëndija, të cilat, si të qenë çliruar nga një ankth, u ngritën dhe vrapuan të lehta përpjetë. Pastaj shpërtheu flaka. Ai ngrohu duart, i fërkoi dhe u shtri në minder. Donte të merrte një sy gjumë, po e ndjeu se nuk do të mundej as të dremiste. Që poshtë vinin zëratë mbetur. Mbuloi kokën me një velenxë të trashë leshi, po zërat prap i ndjente. U pérpoq të dallonte ndonjë fjalë, por qe e pa mundur. Atëherë mbuloi pran kokën, po e ndjeu se nuk do të mund të qëndronte gjatë ashtu. U ngrit dhe zbriti poshtë. Ù suall nëpër oborr, pastaj shkoi nga kasollja, mbushi grazhdin e lopës me zahire dhe zuri të ecte poshtë e përpjetë nëpër oborr, duke goditur kalldrëmin me shkop.

Nata qe e zezë pus. Ai ngriti kokën. Ju duk se qelli kish zbritur aq poshtë sa, po të ngrinte dorën, mund ta prekte. E kuptoi se do të binte borë. Dhe ndjeu t'i lagej ftyra. Nga qelli nisen të zbrisnin mijëra flutura të vogla, që vraponin e vraponin drejt tokës, si të përpiqeshin të kapnin njëra-tjetren. «Në vazhdoftë kështu, gjer në mëngjes do t'i hedhë dy tre pëllëmbë» mendoi dhe, pa ditur ç'të bënte u ngiit prap në dhomë. Ishte i lëdhur. Duhej të shtrihej ca. Të përpiqej të flinte. Medoemos duhej të merrte një sy gjumë, se ku i dihej të nesërmes. Dhe u mbështet pas oxhakut. Z'arri po shuhej. Ai desh të ngrihet, t'i hidhte një krahë dru, po ndërrroi mendje. Kapakët e syve ju rënduan. Reth tij çdo gjë e humbi pak nga pak shkë'qimin dhe u mjegullua. Nisi të merrte frysë rëndë. Zhurmat nuk e linj, të qetë, po tani këto ishin më të largëta, më të thella, si të mos kishin të bënин me të, as me shtëpinë e tij, po me dikë tjetër. Në këto e sipër, ndjeu lëvizje që u pasuan nga zëra të gjëzuar dhe një lëkundje dy-

shemeje. Pastaj tē gjitha u tōpitēn dhe ai dëgjoi vetëm një zë tē hollë fëmije. U drodh i téri. «Pa shih ç'zë paska, malukati!» dhe ndjeu hapa nëpër shkallë. E kup-töi se qe nënë Polia. Ajo shtyti me bryl-derën dhe u fut brenda duke mbajtur me kujdes para duarve diçka tē bardhë, tē mbështjellë me pelena. Nga nxit mi nuk kish lidhur as shaminë në kokë. Flokët i kish tē bardha si bora. «E paçim me jetë, xha Gori. Pa shih ç'birko dialë na lindi» dhe ia tregoi. Nuk kish parë fëmijë aqë tē bukur, aqë tē shëndetshëm me duart rrathë-rrathë që i vërtiste në ajër si tē donte tē prekte diçka dhe guiste pa pushim. Xha Gori u zgjat ta kapte, ta përkëdhetë. Po për çudi nënë Polia u zhduk pa pritur. Ai brofi në këmbë dhe vrapi te dera.

— Nënë Pole, o Nënë Pole!

Dhe mbajti vesh. Fjalët e tij u trukullisën shkallëve. Priti më shpresë tē dëgjonte përséri zérin e hollë e depërtonjës tē fëmijës që pak më parë kish mbushur dhomën. Po qe e kotë. «Paskam qenë në ëndërl!» foli. Dhe çdo gjë u shemb me zhurmë e u rrëzua. Zbriti dy e nga tri shkallët. Kur attriti poshtë i prenë rrugën dy gra. Ai i vështroi pa e pasur mëndjen, andaj nuk i njohu. Sytë u përpinqën tē gjenin atë që kishin humbur pak më parë. Po ishte e kotë. Ai u mundua tē merrte me mend ç'po ngjiste. Po as këtë nuk qe i zoti ta bënte. Mbi tē gjitha e turbullci ajo ndjenjë trishtimi e pasigurie që shprehnin ftyrat e grave.

Cilat qenë ato? Përse kishin ardhur aty?! Ç'lidhje kishin me tē?

Si tē donte tē merrte përgjigjen e këtyre pyetjeve, zgjati hapin dhe ju afrua derës. Ato i prenë rrugën. «Mos, nuk është punë për burra këtu!» Por ai i shtvti me forcë dhe u dha te pragu. Brenda disa gra venin e vinin. Dukeshin tē shqetësuara. Seç thoshin, seç për-

piqeshin tē bënin. E shoqja, Lola, e kish humbur fare pusulleni. Gori e kupto se atje nuk ishte vend pēr tē. Dikush e tērhoqi nga krahua. Ai u bind. Dera u mbyll me forcē. Kërcitja e saj e solli nē vete.

— Mirë, xhanëm, po pērse s'ka lindur akoma? — pyeti.

Gratë e shikuau tē hutuara.

- E ka fëmijën mbrapsht! — shpiegoi njëra.
- Prapësil! — shtoi tjetra.
- Lere mos e nga. E mjera grua. Keq e ka. Duhet t'i bëjë hall kokës.

— Pse t'i bëjë hall? — pyeti i çuditur xha Gori.

— E po ja, ashtu e pati fatin, lumëzeza...

Ai u kollit. E pa me i-rat atë që foli dhe u çapit më tutje. Këmbët e shpunë nē tē ndarën tjetër. I ra dhomës nga kreu nē fund. Ju avit dritares. Xhamet ishin tē veshur me avuj. Ai nuhati dhe e fshiu vendin me pëllëmbë. Dëbora e kish shtruar. Një trumcak i trembur trokiste nē xham. Ai çeli dritaren dhe zogu duke hapur e mbyllur me frikë dy sytë e vegjël, si dy pikë uji, hyri brenda. Pa e pasur mëndjen, xha Gori zgjati dorën ta kapte, po nuk mundi, se zogu ndahu krahët me frikë dhe i humbi nga svtë.

Cudi e madhel! Ç'po ngjiste kështu?

* * *

Në rrugë kalonin njerëz. Atij ju duk se, kur i aftosheshin shtëpisë, mbanin hapat, seç i thoshnin njëri-tjetrit dhe largoheshin duke kthyer kokën pas. «Gjynah! U dogj i gjori pēr një fëmijë», ju duk se thoshnin. Ai i vështronët me inat dhe nisi tē ecte nëpër dhomë. Atë çast u hap dera dhe brenda hyri me frikë e shoqja, Lola, duke ecur nē maya tē këmbëve. Sa e pa, xha Gorit i ndolli zemra diçka tē keqe. Ajo ishte zverdhur, qe pre-

re nē fytyrë, kurse nēn sy i qenë formuar rrathë mavi. Qe gati, tē qante. Nuk e kishte parë kurrë aq tē trondit. Ajo ishte grua e vuajtur, e përbajtur dhe ai u habit si e kish lëshuar aq shumë veten.

- Kjo është kujë. Kujë e zezë. Pu-pu ç'na gjetil!
- Ç'ke mojl Pse mendon prapësira?
- Tē mjerët ne. E m'era grual!

Dhe nuk u përbait. U shkreh nē vaj. Dridhei e tēra, kurse nga sytë i rridhnin lotët u'ë. Xha Gori u tremb. E kapi nga supet, e tundi fort, po ajo nuk e mblidhte dot veten.

- Aman, burrë, bëni një derman. Do tē vdesi edhe ajo, dhe fëmija.

Ai e shkundi përsëri:

- Ç'thua?

- Kështu si tē them unë. Bëni derman sa nuk është vonë. Ti je burrë. Mos e ler tē vdesi.

Xha Gori s'e kish dëgjuar herë tjetër tē fliste ashtu. E kuptoi se punët kishin marrë rrugë tē keqe. Ndërsa rrinte i hutuar dhe vriste mëndjen se çfar mund tē bënnte, ju duk se pas krahëvë ndicu hapa dhe dikë që afrohej. Ju duk se, sa tē kthehej do ta shihte Dritën tek i afrohej e qeshur e gojëmjaltë, si gjithnjë, duke e pyetur buzagaz: «U mërzite baba? Mos do një kafe?» Sado i lodhur e i mërzitur tē qe nē këto raste, kur ja dëgjonte zërin, e harronte çdo gjë. «Jo bijë e babait, nuk o lodha» — ja kthente dhe e vështronte me dashuri e qëditej ç'dhemshurie ndiente për tē renë dhe sa e zbratzët i dukej shtëpia, kur nuk e kishte aty. Ai kishte pa-

sur vajza plot vatrën, kishte dhe djalin, po me Dritën s'vinte asnjë.

— Mos e le të...

— Po vete të thërras atë, maminë,

— Ajo erdhi që mbrëmë. U mundua sa s'ka më me atë të sajën. Po...

— Atëhere...

— Ti di. Bëj një derman.

Ai vrapi i përashta. Në rrugë kishte njerëz. Ata e vë shtruan drejt në sy, si të prisnin nga ai se ç'duhej të bënin e si t'i vinin në ndilmë. Xha Gori eci kuturë rrugëve. Pástaj shkoi te kryetari i kooperativës dhe sekretari i partisë. Qau hallin me ta. E rrahën punën nga të gjitha anët. Korjeri që ish nisur në qëndër të lokalitetit për të marë d ktorin, qe kthyer filli vëtëm. Mjeku kish shkuar në një fshat tjeter për një rast urgjent. Njerëzit u mblohdhën prap këkë më kokë dhe vranë mëndjen se ç'mund të bënin. Qyteti qe larg. Në një kohë të tillë, me vajtje e ardhje, donte më shumë se një ditë. Kurse puna s'pripte.

Xha Gori nisi prapë ecejakët. Teksa çapitei, e ndiente se krahas tij, bashkë me të, qe vënë në lëvizje i tërë fshati. Ai qe bëri kaq dhe nuk mbante mend që fshati. Të kish ndier një tronditje të tillë. Herë herë i dukej sikur atë nuk i shqetësonte halli i tij, po qenë vënë në tension për diçka tjeter që ai nuk arrinte ta kuptonte. Mirëpo nga kohë më kohë njerëzit trokisin në portë të tij, pyesnin për të renë dhe ai e kuptonte gjithnjë më qartë se brengë e tii qe bërë brengë e tërë fshatit. Gjer pak më parë, kur rrinte i vetëm brenda katër mu-reve të dhomës, ai kish nisur një monolog të gjatë me

djalin ushtar. Në fillim kish vrarë mëndjen si t'i dërgonte lajm që të vinte sa më parë e ta kishte krah për të mirë e për të keq, se njeriu ka nevojë ta ndajë me të tjerët edhe gëzimin edhe hidhërimin. Por shpejt ishte penduar. Përse t'ia ngrente mëndjen të birit? Ku priste koha sa të vinte ai? Kurse tani e shih te oart që nuk qe i vetëm, kish krah të gjithë fshatin. Dhe sado që hë për hë nuk gjente ndonjë rrugë dalje, ku shih te si lëvrinin njerëzit, i shtoheshin shpresat se diçka do të bëhej. Do të gjëndej një rrugë. Doemos do të gjëndej. Sakaq, sytë i zunë një kalorës që nisej revan nga tshati. Kush ishte ai? Ku shkonte vallë?

Mori të shkontakte përsëri posht, në dhomë. Të pyeste njëherë se ku i dihej. Por ndërrroi mëndje. Njerëzit hy-nin e delnin po aq të shqetësuar. Madje i dukej se po të shkontakte atje, do t'i priste rrugën e shoqia. Sa ta shih te, ajo do të fillonte nga avazet. Do ta pyeste ku qe, ç'bëri. Kurse ai., ,ç't'i thoshte ai?

Ndërsa fliste kështu me vehten, u kujtua se jo shumë larg nga fshati, ishte një repart ushtarak. Po sikur të shkontakte dhe ta qante hallin me komandant Harizin? U përpoq të sillte ndërmend fytyrën e komandantit, por për çudi tiparet e tij ju ngatërruan me tiparet e të birit, Luanit. Ju duk se do ta takonte edhe atë atë. Dhe s'e bëri të gjatë. Dëbora kish arritur gjer nën gju, por ai e çante me një lehtësi të habitëshme dhe nuk ndiente të lodhur.

Komandant Harizi e dalloi që larg. E priti tek post-blloku siç pret i biri të jatin:

— Mirse erdhe, xha Gori, Si u bë nusja?
Ai mbajti hapin i habitur.

— Ç'ka, o komandant. Po ju si e morët vesh?

— Pak më parë ishte këtu kryetari i kooperativës. Na i tha të gjitha fill e për pe. Ti mos u bën merak. Ne lajmëruam Tiranën.

Xha Gori nuk po e mbledhët veçen. Jo, jo. Nuk ishte në ndër. Të gjitha qenë të vërteta.

— Kë lajmëruat në Tiranë?

— Shokët e ministrisë. U thamë se një kooperativiste e dalluar duhet të shtrohet urgjent në spital, të operohet;

— Po pastai, more bir?

— Presim përgjigje, xha Gori — duke folë kështu, komandanti ju afrova telefonit. Vërtiti do të rezën.

— Shoku centralist, të lutem më nxir edhe një herë Tiranën. Urgjent.

Dhe u kthye të ulej në karrige, pranë stufës. Por nuk arriti. Zil'a e telefonit trokiti fort.

— Alo, ministria? Ju shqetëson përsëri komandanti i repartit të Gurit të Thanës, Hariz Laska. Po, po, Unë jam... Ashtu?... Domethënë u nis. Ju faleminderit shumë...:

Ai uli receptorin dhe qëndroi disa çaste në heshtje, me vështrimin e tretur tej dritareve:

— Mos dëgjohet zhurmë, apo më bëjnë veshët.

Në dhomë u bë heshtje.

— Ç'zhurmë, shoku Hariz?

— Tani duhet të vijë helikopteri. Janë nisur mijekët më të mirë të kryeqytetit.

Ata dolën me nxitim në oborr. I hodhën vështrimet nga qilli. Në mes vetullave e mbi ballë u formuan rudha.

— Kohë e keqe, komandant.

— Po, e keqe.

— Kot që i vutë në telashe. Nuk do të vinë dot.

— Për atë mos u shqetëso. Patjetër që do të vinë. Mua më duket se dëgjoj zhurmë.

Ata përgjuan me veshët bigë. Nuk kaloi shumë dhe që larg u dëgjua një vuvurimë e thelli, e zgjatur, gjersa u duk do të çuhej qiclli.

— Po vjen helikopteri!

Xha Gori vështronie herë komandantin, herë atë magjinë të madhe që doli nga retë e u lëshua me gjëmim drejt tyre. Të gjitha këto i dukeshin të çuditëshme; të paqëna që do të zhdukeshin pa pritur, ashtu siç ishja çfarë. Por helikopteri sa vinte bëhej më i qartë gjersa duke humbur gjithnjë më shumë lartësinë qëndoi disa caste pezull mbi fshat dhe preku mië në tund tokën.

— Këtë nuk ma priste mëndja, more bir! — foli dhe u capit me një frymë drejt fshatit.

LUGINA E PORTOKALLAVE

«Unë nuk ecja, po fluturoja. Më dukej se atje
s'do tē gjëja lapidarin, po tim bir tē gjallë...»
— Nga tregimi i një nène —

Dera e vatrës së kulturës u hap ngadalë, duke nxjerë
ca tinguj tē çjerë, si tē përvajshëm. Në katorin e saj, si
në një kornizë tē madhc, që kish për sfond luginën
e portokallave, qëndronte një grua e veshur në tē zeza,
si shumica e grave tē atyre anëve. Të gjithë ballin,
gjer mbi vetulla, ja mbulonte një shami e zezë, e cila
i nxirrte edhe më mirë në pah tiparet e saj: fytyrçna
e rrumbullaktë me rrudha tē thella e tē dendura, dhe
dy sy tē mëdhenj, me vështrim tē quartë e tē ngulur. Ata
sy ishin si dy lenta zmadhuese që tē rrëfenin për një
jetë plot halle e brenga. Dukej aq e lodhur, sa mezi
qëndronte më këmbë.

Kur u çel dera e hyri ajo, zërat u fashiten një nga
një. Për disa çaste në sallë sundoi një heshtje e plotë.
Kooperativistët e vështruan me vëmëndje fytyrën e saj
që aty u dukej si e njohur, aty sikur e shikonin për tē
parën herë.

— Nëno, urdhëro e ulu — bëri vend një djalë i ri,
me fytyrën tē rahut nga erërat e bregdetit dhe vetullat
kaleshe. Gruaja e vështroi e qetë, por nuk foli. Dukej
si ajo fotografia e vendosur në kornizë, që, sa tē lëvizte
vendit, do tē rrëzohej.

— Pse u mundove gjer këtu, nëno? — e pyeti përsëri djali.

— Unë jam nëna e Sofos — tha ajo me një zë të trashë e të ngjerrur, duke i lënë për disa çaste fjalët pezull mbi sallë. Edhe ata, që gjer atëhere e kishin ndjekur të shkujdesur e mospërfillës bisedën, u kthyen me rrëmbim nga dera.

— E Sofo Gjonit? — pyeti njëri nga ata të presidiuimit, duke u capitur drejt saj. — Po mirse erdhe, moj nënë. Ne të kemi pritur prej kohe. Të bëmë edhe telegram për ditën e inaugurimit, po na thanë se ishe e sëmurë dhe...

Sytë e saj të mëdhenj e të rrumbullakët, të vëmtit që nuk e kishin humbur freskinë e gjallërinë në atë fytyrë, vështronin diku thellë, tej mureve të sallës.

— E di unë që Sofua nuk ja vë re nënës pse erdhiaq vonë të çmallet. Kam qenë e sëmurë. Po tani që mora rrugë, nuk më mban vendi — foli me gjysmë zëri, si të mos kishte njeri në sallë. — Po të jetë e mundur më jepni një njeri që njeh vendin. Në pastë nga ata që qenë atëhere këtu, aq më mirë.

Ai që kish zbritur nga presidiumi i hodhi krahun dhe u capit me të gjer tek karriga që i afroan.

— Ti mos u bën merak, moj nëna jonë, se nuk janë një e dy ata që e njihnin. Në fshatin tonë Sofon e mbajtë mend dhe gurët e rrugëve. Po tani ulu e shplodhu pak, sa të gjejmë një kafshë, se rruga vjen ca e përpjetë e do gjunjë djali.

Ajo u ul si me mëdyshje. Qëndroi si mbi gjemba. Dhe prap u ngrit.

— Mos u mundo, more bir. S'ka ç'më duhet kafsha. Dua të ngjitem me këmbët e mia. Më mirë të nisemi — dhe e ndoqi me sy bashkëfshatarin gjersa u largua. Nuk kaloi shumë dhe ai u kthye, duke hequr prej ka-

pistre një mushkë. Mbi samar kishte vënë një batanie tē trashë leshi dhe një jastëk tē butë. Nëna e pa nga dera gjysmë e hapur dhe u ngrit e eci drejt tij, po mushkës nuk ju afrua. U hodhi një vështrim pyetës njërezve që u grumbulluan sakaq në oborr. Ishin shumë. Mbasc i tërë fshati. Disa veta i folën. E përshtendetën. Ajo e ndjeu se tē gjithë e vështronin. «U prisha punë. — mendoi — Ta dija kështu, do kisha pritur ca... Po ku më rrihej mua...?» — dhe u çapit ngadalë, duke marrë me vete vështrimet e njerezve.

— Këtej do tē shkojmë? — pyeti dhe i hodhi sytë nga kodra që ngrihej si mburojë në krah tē fshatit. Qe një kodër vezake, e veshur me gjetberim.

— Ja tek zbardh lapidari!

Nëna vështroi andej nga i bënë shenë me dorë dhe u nis. Ecte drejt rrugës, si tē kish kaluar edhe herë tē tjera në atë shtigje. Fshatarët e ndiqnin pas. Në fillim u fol se do tē shkonin me tē pesë-gjashtë vetë, po numuri i tyre u shtua me burra, gra e rrënës shkollë, gjersa më kolonën që dredhonte së përpjeti u bashkua më shumë se gjysma e kooperativës. Nënën e ndiqte hap pas hapi shoku që kish zbritur nga presidiumi, djali më vetullat kaleshe që tërhiqte mushkën nga kapistra, pas tij vinin fëmijët e shkollës dhe me radhë tē gjithë tē tjerët. Njëshkolona dredhonte monopateve. Kooperativistët çapiteshin në gjurmët e njëri-tjetrit dhe kur e kur ngrinin sytë e vështronin nga kreu i kolonës. Më tē rallë shkëmbnin ndonjë fjalë:

— Eh, ta dish ti se ç'trim djalë ke patur, moj nënël.

— Sofo me haile ka qënë.

Dhe vështronin nga e ëma që hiqte udhën në krye tē kolonës. Kur filloi e përpjeta, shumë veta thanë se ajo nuk do tē kishte fuqi t'i delte në krye.

— Do tē lodhet shpejt, e gjora.

— Kur tē lodhet, le t'ja hipē mushkës.

— E përse tē mos ja hipē që tani?

Dhe njeri nga ata zgjati hapin. Ju afrua djalit me vetullat kaleshe. Ja mori frerin nga dora dhe doli në krye tē kolonës. E ndali mushkën pranë një sopi.

— Hipja, nëno!

— Jo, mor bir, nuk jam lodhur...!

Dhe trëshqiti anash. Ai ngriti supct. I tha përsëri t'ja hipte kafshës. Po ajo nuk u përgjegj. Me çap n e saj tē pandryshuar, pak e kërrusur, me njëren dorë mbi bel, i ngjitej së përpjetës. Që poshtë dukej sikur që një kodër e vetme, por ata ngjiteshin e ngjiteshin dhe lapidari mbetej thuajse po aq larg sa në fillim.

Hera-herës nëna hidhte sytë nga maja. Dukej sikur kishte udhëtar ashtu gjithë jetën për tē arritur tek lapidari. Dhe tani që e kishte aq pranë, nuk i zinin këmbët dhe. Si tē mos ishte ajo pl kë, që disa minuta më parë mezi qëndronte në kornizën e derës, dhe thoshtje se nga çasti në çast do tē rrëzohej. «Bir i nënës! Më zhuriti malli!» — mërmëriste nëpërt buzë dhe, kur e kur, prekte gazetën që kish futur në gioks. Qe gazeta e ditëve tē fundit. Në faqet e brendshme tē saj botehej një fotografi dhe një lajm që bënte fjalë se kohët e fundit, në fshatin B, ish inauguruar busti i dëshmorit Sofo Gjoni, ngritur nga kooperativistët në shenjë mîrënjohje për vetmohimin e tij. Ja kish lexuar nipi disa herë me radhë. Ajo e kish dëgjuar në heshtje, me sytë e përlotur. Pastaj kish marrë në dorë gazetën, e kish vështruar gjatë. I dukej se në gazetë nuk botehej fotografia e bustit, por e d'jalit vetë. Po atë ditë, pa i treguar njeriu, kish prerë biletën e autobuzit dhe që nisur. Dhe ja, tani që ecte i dukej se atje lart, tek maja e kodrës, nuk do tē gjente bustin, por vetë atë, Sofon, tē dashur e gzmor, siç ishte gjithnjë me nënës.

Sa ta shikonte, ai do tē linte bazamentin prej mérmeri
dhe do t'i delte pérpara, me shaminē e kuqe supeve
e pushkën nē dorë, ashtu siç e kish parë pér herë tē
fundit kur qe nisur pér çetë. Do t'i hidhte krahun e do
t'i thoshte: »Mirse erdhe, nénole. Sa mirë që e bëre,
sa më kish marrë malli. Ta dish sa herë tē kam parë
nē endërr dhe kam qarë, si cilimil!« Ajo do t'i hidhej
nē qafç, do ta puthte nē ballë, pastaj do ta shtrëngonte
nē goks, do tē fuste kokën nē mes tē flokëve tē zeza
e tē dredhura dhe nuk do tē ngopej me erën e tij, erën
e saj. Ai do tē qëndronte ashtu, i urtë e i përmallur, e
do t'i thosh: «Po ti je lodhur, je plakur, moj nénole,
pse u mundove gjer këtu? Ajo nuk do tē ngopej së shi-
kuari. «E ku lodhet nénolia e shkretë... Po ti ke ftob-
të, more bir, pse ke dalë kështu?» — dhe do tē hiqtc
shallin e leshtë e do t'ja lidhte shpatullave tē tij tē gjë-
ra, si një trap.

— U lodhe, nëno? Pushojmë pak.

Ajo u trondit nga ky zë. Ju duk si zëri i tij. Mbajti
hapin. Po shpejt u përmend. Pér herë tē parë kthëu
sytë dhe vështroi njerëzit që vinin pas. Sa shumë qën-
keshin! Po ata vallë ç'mendonin? Pse e vështronin
ashtu?

— Si tē doni — tha, jo se ishte e lodhur, por se nuk
mundi t'u kundërshtonte tē gjithë atyre njerëzve.

— Ulu e pi një pikë ujë. Mbase ke dhe uri.

Ajo e vështroi pa e pasur mendjen atë që foli. «Uri?»
Ajo nuk mbante mend në kish vënë gjë në gojë që atë
mëngjes që kish parë gazetën. Dhe prap i dukej se qe
e ngopur. Kurse ujë donte. E ktheu pagurin dhe e piu
me gllënka tē mëdha. Po nuk u ul. E ndjente se po
të qëndronte, do ta kish vëشتirë tē merrte prap rrugë.

— Mjaft qëndruam. Më mirë ecim.

Nuk e kuptoi nē i tha kēto fjalë, apo vetēm i mendoi. Kooperativistët e ndcqën pas.

Ajo nisi tē çapitej. Dhe përsëri humbi nē mendime. Ku ta dish sa herë qe ngjitur ai, Sofua, këtyre monopateve! Ku ta dish sa e kish lodhur e përpjeta. Mbasse dhe i qe tharë buza për një pikë ujë. «I miri i nënës! Trimi i nënës!» dhe përsëri e preku me dörë g zetën. Ju duk se preku shpatullat e tij, flokët e dendura, tē dredhura. Pa nisi tē kuvendonte me tē. Herë i delte para sysht motak, herë duke lojtur me shokët lëndinave. E ç'far nuk i kujtohej nē ato çastë! Ja tek e kalon prakun me një trymë. I vrenjtur. Me sytë fakë. «Ç'ke more bir, kush tē ngacmoi!» «Ai, djali i kryeplakut. Më tha brashnjaxhi. Mortamadh». «Lëre se ç'je dhe ti. Do ta kesh ngacmuar.» «Jo. U mundëm belazi. Unë e rrëzo-va dhe ai u nxeh. Desh tē më godiste.» «E po ç'ka. Edhe po tē qëlloi, s'bëhet kiameti. Ashtu e ka goditur g yshi i tij gjyshin tënd. Babai i tij bëbanë tënd. Ti hesht, mos merr zjarr...» Po Sofua nuk e dëgjoi gjer nē fund. U lëshua me vrap përjashta. Nëna u dha pas punëve tē shtëpisë dhe nuk e vuri re kur hyri përsëri. Merrte frysme me zor. Nga balli i zbriste një vazhdë gaku, po ai nuk e kish për pesë. «Prap, more bir? Pa dale, ku je prerë ashtu!» «A, lere. Këtë herë ja shtypa mirë kokën. Nëpër rrugë u dëgjuam britma, thirrje, hakërrime. Po Sofua gjithnjë queshte dhe i thoshte: «Lere si ja punova. . .? Pas asaj dite ai nuk mundi tē qëndronte më nē fshat. U paitua nē qytet si yzmeqar. Rrallë vinte, njëherë nē dy-tre muaj. Sa herë vinte, dukej më i ligështuar, po dhe më i vrazhdët, më i rritur. Nënëns's'e harronte kurrë. Në trastë do kish doemos diçka për tē. Kështu dhe herën e fundit. Bashkë me copën përfustan, nga trasta nxori dhe diçka tē kuqe, tē mbështjellë. «Po këtë, more bir?» «Këtë?» Ai e shpalosi

dhe e hodhi tretħ qafēs. Pastaj nxori edhe njē festē ushtarake. me yll tē kuq. E vuri shtrembēr mbi flokēt e zeza kaċurela. dhe e nderoi me grusht. «Vdekje fa-shizmit, nēnole». Ajo e vēshtroi e hutuar. Zemra sikur do t'ia shpērthente kraharonin. Sa qe rititur, biri i nēnēs! Qe bérē burrē. Po ç'thoshte ashtu? Ç'e kishte atē ka-pele?» «Do tē shkoj tek shokēt, nēnole. Nuk durohet mē. Jetē qeni kjo e jona...» Ajo kish ngritur supet dhe e kish parē me frikē.» Dale, mor bir. Pse merr zjarr si kashta? C'janē kēto qē thua? Kēshtu ka qenē k o gjithnjē.» «Ka qenē, po nuk do tē jetē. Mjaft mē! Do ta pērbysin ngā rrēnjet!» «C'thuas kēsttu? E kuch do ta pērbysē?» Ja, ky.» Dhe i biri goditi me pēllēmbē tē dorēs pushkēn. Nēna e vēshtroi. Ju duk ai aq i tri-tur, aq i fortē, sa asnjēherē tjetēr. Dhe nuk dyshoi as-pak se mund t'i bēnte ato qē thoshte. Vetēm «e... «Po dale, more djalē. Tē c'malle mi njēherē. Unē mezi tē prita.» «Do vi pērséri, nēno. Do tē vi».

Dhe iku me shokēt. Me shaminē krahēve, yll'n nē ballē e pushkēn nē sup. E tani, tksa u ngjitej kodrave, nē-na e hidhie vēshtrimin ngā maiat, si tē priste tē zbriste andej. Ajo kēshtu kishte menduar gjithnjē. I du-kei se Sofua, ishte i gjallē, se do ta shihte njē ditē mes shokēve, duke qeshur e kuvendar me ta. A nuk i thoshnin ata pērherē se Sofua rronte, se ai nuk do tē vdiete kurrē? Por vitet shkuan, vitet fluturu-n e ajo...

Mē nē fund arritēn tek lapidari. Ajo mbajti hapat. Qēndroi. Nuk po e kuptonte se c'ngjiste me tē. Ishte si nē ēndēr. Gjithnjē vazhdonte tē fliste me dikē. Kur pa lapidarin dhe bustin, sepse u drodh e tēra, u duk se qē njē čast ai do tē shkēputej andej e do tē lēshohej dreit saj. Po shpejt e kuptoi se kjo nuk do tē ngjiste. Nuk mund tē ngjiste. Megiith-tē nuk e ndieu atē zbrażetirē qē kish menduar. Bazamenti me bustin e

mbushnin tē gjithë hapësirën e kaltër tej e tej. Ajo ho-
dhi një hap... dy. Ju afrua. Hapi krahët po nuk e push-
toi dot të térin.

— Qënke trtitur, biri i nënës! Të pastë nëna...

Dhe ndjeu se diçka trokëlliti nënë këmbë. Ajo u
përkul. Mori një gëzhojë, dy, tri. Ndofta ato gëzhoja i
kish prekur dora e tij, ndofta qenë tē mitralozit tē tij. Ajo
sikur dëgjoi, buçimën e krismave, gjëmimin e topave,
të mortajës... I shtrëngoi në gjoks, në atë gjoks ku qe
mbështetur sa herë trupi i tij, koka e tij, fytyra, flokët...
Ato flokë tē dendura, tē zeza, dredhadredha. Ajo ndjeu
erën e trupit tē tij, trupit tē saj. Dhe priti t'i njomeshin
faqet. Po, për çudi, nuk derdhi lot. Këtyre lotëve ajo
u qe trembur. Ndaj nuk kish ardhur kur mori telegra-
min. Kish menduar se, kur tē ndodhej atje, nuk do tē
mund tē përmbahej, do tē çlirohej e tëra në lotë. Në
ata lotë që i kish mbledhur për në kohë tē gatë, bash-
kë me mallin për të. Ç'do tē thoshte atëhere Sofua? Ç'do
të thoshnin shokët e tij? Ai i kishte aq inat lotët... Ai
i donte aq shumë këngët. Mbase për këtë, në vend tē
lotëve, zemra i ndolli këngët. Dhe dikush nisi tē
këndonte. Ishte një zë i dredhur, i përmallshëm që u
këndonte atyre kohrave, asaj beteje. Me të u bashkuar
shumë tē tjerë dhe kodra gjëmoi. Dukçj sikur zërat dil-
nin nga gjoksi i maleve; nga gjokset e nënave:

«Lule djemt e nënave...»

Pastaj dikush nisi tē lexonte: «Këtu, më 12 tetor 1943
luftoi si luan trimi Sofo Gjoni, i cili për tē mbrotur
këtë fshat, këto brigje, u përlesh fytafyt me armikun,
vrau dhjetra nga ata, po mbeti dhe vetë lapidar.» Pastaj
zëri tregoi për atë ditë. Për atë betejë. Për dushmanin
që ngjitej përpjetë kodrave si një bishë e goditur për
vdekje. Në fshat qenë vetëm gratë fëmijët, pleqtë. Di-
kush dha alarmin. Njerëzit u tronditën. U vunë në lë-

vizje. Por plumbat u lëshuan pas tyre. Plumbat fishkë-llinin. Fëmijët qanin. Gratë mallkonin. Kurse armiku afrohej, afrohej. Sofua me katër-pesë shokë e ngriti mitralozin tek maja. Zjarri qe i tmerrshëm. Fashistët ranë barkas. U ngriten. Ranë prap. Dhe prap u ngriten. Po tani njerëzit qenë larguar. Bashkë me ta dhe praparoja e çetës. Qëndroi vetëm ai për t'i mbrojtur. Dhe mbeti përgjithnjë atje, me shpatullat gjë tek retë.

«Biri i nënës! Trimi i nënës! Hallall qumështil»

Me dorën që i dridhej, ajo i lëmoi gjoksin, ballin e mermertë. Dhe e treti vështrimin poshtë, në luginen e portokallave. Ato qëndronin në rreshta të drejtë e të gjelbër, si ushtarë të papërkulur të këtyre brigjeve. Era loste me fletët e tyre dhe mërmëriste pambarim një le gjendë të bukur për djemtë e nënave. Për djalin e saj.

LINDITA

Buzëmbrëmja ra e butë dhe e vakët mbi qytet. Dita e humbi dalëngadalë shkëlqimin e saj dhe në shtyllat e larta u ndezën e u fikën disa herë dritat neon, gjersa më në fund shpërndanë përreth ndriçimin e tyre të zbetë e uniforme. Njerëzit, të çiruar disi nga zagushia e gushtit, u derdhën nëpër parqe e shetitore.

Lindita zbriti me nxitim shkallët dhe doli në rrugën e gjërtë. E ëma e shoqëroi gjer poshtë. Linda mbajti hapat dhe seç desh të thoshte, po ndërrroi mendje. Ju duk se sytë dhe gjithë tiparet e nënës shprehnin një ndjenjë gëzimi, hutimi e ankthi dhe sikur kërkonin vazhdimisht te ajo diçka që nuk e kishte.

— Po ti mama, ku vete kështu? Ktheu tani.

E ëma qëndroi dhe mërmëriti diçka nëpër buzë. Pastaj shtoi me gjysmë zëri, si të druhjej mos e dëgjonte kush:

— Shko bijë e nënës, me mend në kokë dhe...

Duke u çapitur mbi trotuar, Lindita vrau mendjen të gjente se ç'donte të thoshte e ëma me këto fjalë. Po shpejt ato e humbën rëndësinë e tyre dhe asaj ju duk sikur kishte përsëri përpara hartimet e nxënësve të vet e i lexonte me zë të ulët. Ju duk se treshtat e fletoreve zgjateshin drejt bregdetit, ku qëndronin hijerënda e koloviteshin mbi valë anijet e repartit të filotës luftarakë. Ndonëse kishin kaluar disa ditë që kur kishin vizituar njerën nga këto anije, ajo dhe nxënësit e klasës

ësë saj edhe tani mund ta përshkruanin gjer në hollësi nga kishin shkuar e çfar kishin parë. Shumë nga nxënësit vendin më të madh në hartim ja kishin kushtuar xhaxhi komandantit, i cili në një natë me furtunë ishte hedhur me guxim mbi dallgët dhe, bashkë me shokët, kish shpëtuar një anije nga rreziku. Gjer para se të lexonte hartimet, Linda kish kujtuar se vetëm asaj i kish mbetur në mendje tregimi i oficerit që i shoqëronte për komendant Sokolin, i cili e kish mposhtur me gjoks zemërimin e dallgëve dhe kish fituar mbi to. Teksa dëgjonë, i dukej se ky tregim bënte fjalë për një nga heronjtë e përrallave të fëmijërisë dhe jo për atë oficerin e ri e plot humor, me të cilin që njojur kohët e fundit.

U përhoq të sillte ndërmend si kishte ngjarë kjo.

2

Edhe atë ditë buzëmbrëmje ishtë. Ajo kish dalë nga mbledhja e këshillit pedagogjik dhe po shetiste me shoqet. Befas dikush e kishte thirrur: Ajo kish kthyer kokën.

— Nora, po ti?

— Erdha për pushime.

Ato ishin putur dhe e kishin mbuluar me pyetje njëra-tjetren. Kishin dashur t'i mësonin njëherësh të gjitha ndryshimet në jetën e tyre pas fakultetit. Ndërkëq dikush kishte krojtur zërin aty pranë.

— Ua, Sokol, më fal. Kemi kaq kohë pa u parë dhe... Një kushëriti im, Linda. — Ai kishte buzëqeshur dhe kishte zgjatur dorën...

Linda ish përpjekur të sillte ndërmend fjalët e tij: «Sokol Shpati, nga Mirdita, i datëlindjes 1941, më shërbim në Durrës — dhe pas pak kish shtuar: — një metër e tetëdhjetë i gjatë, i pamartuar.» Linda e kish mbajtur

me zor tē qeshurēn. Nē njē rast tjetër ajo do tē kishte marrē zjarr e do t'i kish kthyer shpinēn tē porsanjohurit. Por ato fjalē, pēr çudi, i ishin dukur tē çiltéra e tē sinqerta. Madje edhe vētē prezantimi i ishte dukur jo i zakonshēm. Ajo kish ngritur sytē dhe e kishte parē. Ishte vērtet interesant. Pasi i kish treguar emrin, ajo e kish hequr me nxitim dorēn, sa shoqja e saj nuk e kish mbajtur dot tē qeshurēn. Linda ishte skuqur, kish bērē disa hapa bashkē me ta, pastaj kish kērkuar leje e ishte ndarē. Dhe i ishte dukur sikur e kish dēgjuat edhe pēr njē kohē zērin e tij: «Sokol Shpati, nga Mirdita, me shērbim nē Durrēs. I pamartuar.» Po tjetër ç'tha? Ah, po:» Njē e tetēdhjetē i gjatē;» Hē, ç'mē qeshet. Po unē sa jam? Njē gjashtēdhjetē e tetē... Ha-h! Sa budallaqe qē jam! E ç'rēndēsi ka kjo? Asnjē rēndēsi, kot m'u kujtua.

Dhe kur kishte dēgjuar tregimin e shoqēruesit pēr natēn me furtunē, ajo ishte habitur pa masē. S'i vinte tē besonte qē kjo ngjarje kishte lidhje me atē oficerin e ri, tē pashēm e buzagaz, me tē cilin e kish njobur shoqja e saj nē njē mbrēmje maji.

Dhe tani, ndērsa çapitej ngadalē trotuarit, herē i dil-te parasysh deti plot tallaz; herē sikur pērqafonte me mall Norēn, ndērsa dikush kruante zērin prapa krahēve tē tyre. Pastaj dēgjonte zērin e Norēs «Ua, mē fal, Sokol...»

Ajo u pērpoq t'i harronte kēto dhe tē kujtonte diçka tjetër. Sakaq ndjeu se dikush i f'iste.

— Linda!

U kthyē me trēmbim, por kur e pa atē qē kishte folur, sikur u pre.

— Linda, ku je! Kam kohē qē tē kērkoj. Ne tē presim.

Ajo sikur u kujtua pēr diçka.

- Kush ne?
— Unë dhe mamaja.
— Po mamaja ku e di?
— I thashë unë.

Ajo u çapit me dyshje përkrah tij. Për një kohë hesh-tën që të dy. Pastaj ai nisi t'i fliste për një film që kishte parë në televizor. Linda përpinqej të tregohej e vemen-shme, por nuk qe e zonja ta bënte këtë. Ai e kuptoi menjëherë dhe u ngrys:

- Ku e ke mëndjen, Linda? Ti sikur...
— Po mendoja hartimet e nxënësve. Nuk di pse më kanë bërë aq përshtypje.
— Budallaqe. Unë thashë se ç'hall kishe.
— Mos thuaj aشتua për nxënësit e mi. Ata...
— Ç'temë u dhe? Me siguri për ndonjë hero, për i Majin, apo... E gjeta, Linda? Këto na janë bërë kaq bajate, sa njeriu shumë rrallë ndesh diçka të bukur, diçka që ta thyejnë monotoninë dhe...
— Jo! e ndërpren Lindita. — Kishin një temë për vizitën që bënë kohët e fundit në anije.
Ai mbajti hapin. E vështroi ngultas, duke kafshuar buzën.
— Ndofta për atë, si e thonë?
— Po, për Sokolin!
— Ti nuk je në vete, Linda. Ti flet ca marrëzira që të bëjnë të çmendesh. Nuk e kuptoj se ç'gjë interesant mund të gjeni iu tek nië, më falni, marinar që rrapatet tërë kohës nëpër det dhe...
— Për atë mos u shqetësoni aq shumë.
— Aشتua? E çuditshme! Unë s'të kuptoj ty, Linda. Sa shumë ke ndryshuar kohët e fundit. Ne merreshim vesh aq mirë me njeri tjetrin. Kishim gjithato plane, gjithato ëndërra të bukura...
— Vërtet, kam ndryshuar.

— Sidoqoftë, është interesante ta kesh shtëpinë mbi ujë, ose mbi samar të mushkës, si ciganët, apo jo? — dhe nisi të qeshte me të madhe. — Ku ma gjen! Sot në Durrës, nesër në Shëngjin, pasnesër në Sazan... Ç'lëndë jep ti, Linda, letërsinë apo gjeografinë? Bukur. Për përendit bukur. Kështu do të kesh rast të njohësh më mitë detrat, lumenjtë, kënetat.

— Të lutem, mos u tall. Unë s'jam tallur ndonjëherë me ty.

— Linda, t'i s'je në vetel Pa mendohu njëherë: ç'flet kështu?

— Kurse mua më duket se si nuk i peshon fare fjalët para se t'i thuash.

Ai e pa që biseda po trashej dhe u përpoq të mos e zgjaste.

— E di, Linda? Ne kot grindemi dhe humbim kohën poshtë e përpjetë. Fare kot, kur ka kaq gjëra të bukura. Shkojmë nga shtëpia?

— Të faleminderit. Nuk mundem.

— Po më mban mëri? Kot nérpiqesh. Do të vish medemos. Ti ma pate dhënë fjilën. Sonte në televizor ka një program italian shumë të bukur me këngë. Këndoijnë... dhe ai nisi të numëronte emrat e këngëtarëve më të dëgjuar që i binin në mend, duke u përpjekur ta oshte me famen e tyre. Tani nuk i kishte mbetur asnjë gjurmë nga zemërimi i mëparshëm. Dukej se ishte gati t'i binte dhe në gjunië, mjaftonte që t'i shkonte në shtëpi. Po ne fjalët e tij ajo vinte re njëlloj nervozizmi, një dhëmsuri të shtitur dhe, prepa tyre, një farë epërsie, të cilën sado që përniaj, nuk ce i zotit ta fshihte.

— Linda, mos u lodh më kot. Do të vish patjetër. Ke për të parë sa bukur do të jetë. Dhe mamaja të pret.

— Niëhërë tjetër ndëfta vi, sonte nuk mundem.

Ai e vështroi i habitur.

—Ç'thua kështu, Linda. Pa mendohu mirë. Është hera e parë që do të vish në shtëpi dhe... dhe unë...

— Mbase është mirë të mos vi fare. Kjo s'ka kuptim.

— Si nuk paska! Ti s'je në vete. Ç'thua kështu? Do të vish se s'bën.

— E mirë, pra. Me që po ngul kaq shumë këmbë...

Ai mori fryshtë i lehtësuar. Dridhej i terti nga inati. Megjithatë u përpoq të mos e trëgonte. Nisi të fishkëllente lehtë një melodi xhazi, duke u shtitur sa më i shkujdesur. Me cep të syrit vështronë Lindën dhe ai e adjente se, dalëngadalë, po i largohej ajo ndjenjë nervozizmi që e kish bërë të dridhej si në ethe pak më parë. Edhe pse bënte sikur nuk e vështronë, ai e ndjente thellësisht praninë e saj, tek ecte lozanjare, me trupin e derdhur me gjoksin e kërcyer, me ato flokë të verdha, fytyrën pak të zbehtë dhe buzët e fryra si të mbushura me lëng qershie. Kalimtarët e vështronin me kërsheri, disa kthenin edhe kokën për t'i shikuar nga prapa, dhe kjo e bënte ta ndjente veten të lumtur e krenare. Po ajo, vallë, e ndjente këtë? Pandit ju duk se shpesh ajo ulte sytë e drojtur, si të donte t'ju shmangej vështrimeve të njerëzve. Sa budallaqe që ishte! E përsë të druhëj? Në qoftë se të tjerët e vështronin, domethënë se kishte diçka të veçanta, që i joshtte, dhe ajo duhej të dinte ta shfrytëzonte këtë, që t'i joshtte edhe më shumë. Ai donte që kur shkonte rrugës, të mos kalonte pa u vënë re, por të tjerët ta vështronin me lakmi dhe t'u ngjiteshin sytë mbi të, mbi rrobat, këpucët e tij, mbi motorin e tij, mbi... gruan e tij... Linda, bukuria e saj, paraqitja e saj, ish ajo që i duhej atij. Për të tjerat s'pyeste.

— Arritëm Linda!

Ai i shqiptoi këto fjalë në një mënyrë aq të çuditshme, si të kish arritur kushedi se ku dhe Linda sepse — u

tremb nga kjo e ngadalësoi hapin. Po ai shpejtoi, hapi derën, dhe ajo s'pat kohë tē mendohej më gjatë.

3.

Dhoma ishte zhytur në gjysmë errësirë. Sa hyri benda asaj sikur ju zu fryma.

— Nënë, erdhi Lindita! — tha Pandi, duke ju afruar një kolltuku.

— Eh! — u përgjegj një zë i zgjatur gruaje. — Pa hape pak dritën ta shoh!

Sa u ul çelësi, nga gjysmë errësira dolën njerëzit që ishin aty dhe një dhomë e mobiluar mirë. Nga qoshja e murit përballë televizori përhapte një dritë tē zbehtë. Në krah tē tij, një pjanofortë me llustrë tē shndritshme e ngjyrë krejt tē errët. Pastaj një bufe e rëndë, e vjetër, me dru arre dhe ca kolltuqe po aq tē çmuar. Lindës nuk i bëri përshtypje asgjë nga këto. Vetëm se e ndjek që atje çdo gjë ishte me bollëk e sikur binte erë myk!

— Ua! Sa qënke rritur moj çupkë! Qenke bërë tamam nuse. Dhe çfarë nuse, sel! — fliste një zë i zgjatur gruaje, me një dashuri tē shtitur.

— Si qenka bërë, tamam mollë pér t'u kafshuar!

Ajo s'dinte kë tē vështronë. Ishte e hutuar.

— Më fal që nuk tē prezantova, Linda. Kjo është mamaja, kurse kjo gjyshja — ndërhyri Pandi.

Linda u përpoq tē buzëqeshte, kurse plakat s'i linin radhë njëra-tjetërës. Ato dukeshin më shumë si motra, se sa si nënë e bijë.

— Posi, posi. Ti mbasë nuk na njeh. Por nëna tën-de...

— Uh, Lenka! E si nuk na njeh Lenka? Me tē kemi hequr gjith ato halle. Mbësë tē ka rrëfyer.

— Posi, posi. Në kohë tē luftës, kur i doli burri par-

tizan, mbeti si mosmëkeq kallogreja dhe këtu dërgjej.
Ne e ushqenim.

— Uh, si do t'i harrojë ajo tërë ato të mira!

Ato flisnin të dyja, thuajse në një gojë, dhe e vështronin në një mënyrë të çuditshme. Linda qëndronte si në gjemba në mes tyre. Si e panë mirë e mirë nga koka deri te këmbët, ato u ngritën me përtesë e nisën të silleshin rrëth saj. Linda u skuq gjer tek veshët. Ju duk se ato e vështronin si një mall që do të blenin pasi të siguroheshin se e viente plotësisht çmimin që do t'i jepnin. U suallën sa u suallën rrëth saj, duke i prekur me duat herë trupin, herë fustanin e flokët, pastaj u ulën njëra pranë tjetrës në kolltuge dhe mbështetën të kënaqura kokën mbi jastekët e butë. Pandi buzëqeshte duke u përpjekur të merrte poza sa më elegante, si ja donte soji, dhe hidhte me të rrallë ndonjë fjalë.

— Ua, po ku ke qënë kaq kohë, biçë e nënës!

— Si nuk ke ardhur më parë, xhanëm. Këtu tek ne të gjithë duan të vinë, po kush i qas.

— Uh, u lodhëm, aman...

— Si është me shëndet Lenka, se mua më ka zënë një e therur shpatull me shpatull, që s'më le të marr frymë. Uh!

Lindita vështronë e hutuar, madje e trembur dhe përgjigjej me të rrallë, duke tundur kokën ose duke agritur supet. Sado që tregoheshin të dashura e të dhimsura, ato gra ju dukën aq të ftohta e pa jetë, sa çdo gjë tjetër në atë dhomë. Ajo u ul si mbi gjemba në një karrike që i afroi Pandi. Sakaq, prapa krahëve u dëgjuia një zë i nxitur gruaje:

— Ua, sa e... shplarë!

Lindita u kthye me të shpejtë.

— Kush është e shplarë? — pyeti Pandi.

Ajo që foli ngriti supet dhe vështroi përreth.

— Kjo, de... drita elektrike. Uh, nuk e duroj dot!

Pandi mori frysme i lehtesuar.

— Më fal, Linda. Nuk jam në vete sonte. Këto janë mikeshat tonas... Desha të them, mikeshat e mamasë, motrat Panteviqi. Besoj i njihni.

Ato i zgjatën dorën njëra pas tjetrës duke u agritur me përtesë e duke rrudhur buzët.

— Kam dëgjuar për to — mërmëriti Lindita. Parfumet e tyre të forta i shpuan hundët.

— Edhe ne gjithashtu. Posi, edhe ne kemi dëgjuar për ju — folën ato duke ja marrë fjalën njëra-tjetrës nga goja e duke vështruar diku gjetkë.

— Përsëri me syza dielli ju, Geri? — pyeti Pandi njëren prej tyre.

— Doemos! — ja ktheu ajo dhe në dhomë shpërtheu ajë e qeshur e fortë e befasishme. Vetëm Linda u rrënqeth e trembur, ndërsa të tjerat as që e prishën qetësinë. Kur ra përsëri heshtja, po ai zë i ngjirur shtoi:

— Doemos, i dashur. E pse të gënjej? Kështu të duket sikur televizori është me ngjyra, si në botën e qytetëruar.

Linda u habit nga mënyra se si i shqiptoi ato fjalë. Atë çast gjyshja e Pandit ju lut që t'ja mbështillte këmbët me një copë kadife se kishte të ftohtë. Ajo nguroi në fillim, por u zu ngushtë dhe ja plotësoi me përtesë dëshirën, pa e kuptuar as vetë përse e bëri këtë.

Pas kësaj plakat sikur ranë në qetësi. Njëra nga ato lëvizë me përtesë dorën në ajër, duke dashur të thoshte se nuk donte të dëgjonte më asnje fjalë. Dikush fiku dritën. Dhoma u zhyt në gjysmë errësirë. Pandi u zgjat dhe i mërmëriti diçka në vesh, po ajo s'mori vesh asnjë fjalë. As që e kishte mendjen tek ai. Në ekran dolën disa kërcimtare thuajse lakuriq, pastaj një kompleks kën-

gëtarësh që nuk dalloheshin as nga flokët, as nga veshja dhe zëri, në ishin burra apo gra. Linditës se si i dukeshin këto dhe s'di pse e hodhi shikimin anash, po u ndesh me vështrimin e motrave Panteviçi. Ato njiheshin në qytet për rininë e shthurur. Tani që po u afrohesin të 40-tave, nuk linin më rifet pa bërë për t'u dukur me të reja. Lyheshin me të kuq, nxiheshin me kalem dhe i ngrinin fustanet një pëllëmbë mbi gju, duke nxjerrë në shesh këmbët e tyre plot muskuj e damarë. Më e vogla, Geri, ose Geraldina, siç e kishte emrin e plotë, dukej më e re. Por dalengadalë dhe ajo po merrte huqet e motrave të shthurura e tëmplakura para kohe.

«Po të mos sajoheshin ashtu, mbasë do dukeshin më të mira» — mendoi Linda dhe e ndjeu se të trija e vëçshtronin me lakmi. Ajo u turbullua nga këto vështrime dhe i brodhi sytë nëpër dhomë, duke parë orenditë e shtëpisë. Ja televizori, bufeja me kompletet prej kristali. Më tej pjanua, Kush i binte asaj? A dinte t'i binte Pandi? Po ç'i duhej kjo asaj! Sa e lehtë që ish treguar! Përse kishte pranuar të shkonte atje?

Ajo u përpoq të mendonte diçka tjetër. Duke shikuar në televizor, ju kujtuan hartimet që kish lexuar pak më parë. Nëpërmjet reshtave të tyre, kujtesa e saj rendi buzë detit, drejt anijes dhe parasysh i doli Sokoli. Trupi i tij i hedhur e zuri të gjithë ekranin. Linditës ju duk se ai ngrysi vetullat dhe e shikoi në një mënyrë të çuditshme. Për herë të parë, ndofta, ajo ndjeu aq shumë nevojën që ta kishte pranë, si disa ditë më parë në eskursion.

* * *

Linda e kish kërkuar për një kohë të gjatë nëpër turmë. Më në fund, tek rinte e tifishtuar, ndjeu hapa. Ai

ju afroa dhe e përshëndeti. Ajo ja ktheu me gjysmë zëri dhe u skuq e tëra. Sokoli buzëqeshi. «Po, po. Ajo... Ndryshe, pse do të skuqe?» Ata u panë drejt.

«Shumë vapë sot, ë?»

«Po vapë!»

Dhe përsëri ulën sytë. Heshtën. Nuk ngopeshin me frymë.

«Kini etje?»

«Ehë!»

Sokoli u gjallërua befas.

«E dini, te kodra është një burim i akullt. Kanë vajtur shumë veta. Shkojmë dhe ne?»

Ajo u capit pa kthyer përgjigje. Nuk e kuptoi sa vazhduan të ecnin. Ajo nuk qe larguar kështu asnjëherë tjetër. Vështronte e hutuar nga të gjitha anët. Çdo gjë dukej e bukur. Ngadalësoi hapin. Ngriti sytë. Edhe ai e vështronte.

«E mrekullueshme!» — mendoi Sokoli.

«Njeri i çuditshëm» — foli Linda me vete, pa ditur se ç'deshte të shprehte me këto fjalë. Befas diçka trëshqiti anash nëpër gjethë. Ajo u mbështet e trembur në supin e tij. Ai i kapi duart dhe ja shtrëngoi.

«U trembe! — i mërmëriti në vesh — Është zog. Ja, shiko ku e ka folenë...»

«Paska të vegjël brenda! Sa e çuditshme!»

Ajo ndjeu aq afër frymëmarrjen, vështrimin e tij depërtonjës dhe s'e kuptoi përsë u tremb.

«Gjynah, po tremben. T'i lemë të qetë.»

«Rrimë edhe pak — u lut Sokoli — Shiko sa mirë e kanë ndërtuar folenë. Dhe në ç'vend të qetë, të bukur!»

Ai i kapi duart dhe u përpoq ta afronte.

«Ç'bën kështu?!

«Linda. Mos m'u zemro. Unë... unë e kam ëndërruar tërë jetën një çast të tillë. Pa shih! Jemi bashkë. Ve-

tëm. Në mes të luginës. Nën degët e ahur. Mbi barin e njomë. Pranë fëlesë. Më duket sikur jam në ëndërt. Një ëndërr e mrekullueshme, fantastike.»

Ajo e ndjeu dobësinë e saj dhe ju shkëput me vrull nga duart. Vrapoi. Ai e ndoqi pas. Arritën me një frymë te burimi. Ujët dilte nga gjiri i shkëmbit dhe gurgullonte në mes të shelgjishteve.

Ata vështruan një copë herë, pastaj Sokoli u përkul.

«Sa bukur qenka këtu?» — foli duke shikuar fytyrëm e tij që lëkundej mbi sipërfaqen e lëmuar të ujit, i bindur se ato fjalë nuk do të kishin kuptim, po të mos ishte bashkë me të edhe Lindita. Ai shohti etjen dhe u ngrit i kënaqur. Lindita e vështronte e hutuar.

«Po ju nuk do të pini?»

Ajo e kishte ngulur vështrimin mbi buronjë.

«Kthehuni nga ajo anë — u lut me gjysmë zëri. — Mos më shikon!»

Ai u bind. Ajo mbështeti duart mbi dy gurë të lëmuar dhe u ul ngadalë, si të donte të përqafonte veten e saj që e vështronte e zbehtë dhe e hutuar që nga fundi i burimit. U përhoq të dallonte se ç'shprehte ai vështrim: qortim apo aprovim, frikë a gjëzim. Por nuk mundi të përcaktonte asgjë qartë. Dhe as që donte ta vriste mendjen. I hodhi disa grushta ujë fytyrës, pastaj nisi të pinte. Sakaq Sokoli qe kthyer nga ajo. Kur pa vijat e lakuara të trupit të saj, këmbët e mbushura, të bardha dhe flokët e verdhë e të butë që kishin rënë mbi ujë, ju duk si një shtojzovalle që po dilte nga burimi. Ju afrua me maja të gishtërinjve dhe qëndroi pranë saj. Ajo u tremb. «Un, thashë kush erdhi.» Disa çaste u zhytën në sytë e njëri-tjetrit.

— Ua! — buçiti një zë i shqetësuar pas krahëve të saj. Lindita brofi e hutuar. Ju duk se ja zbuluan meadimet.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti Pandi.

Kjo është e tmerrshme. Litell Toni qenka me grip. Nuk do tē këndoje sonte.

— I shkreti...

— E tmerrshme.

— E padurueshme. Apo jo, zonja Frosa.

Lindita vështronte herë njëren, herë tjetrën, dhe nuk arrinte tē kuptonte përsë bëhej fjalë, cila ishte e tmerrshme.

— Camarroket e mia! — i qortoi me mënyrën e saj nëna e Pandit. Për një kohë ato vazhduan tē shprehnin keqardhjen përfatim e keq tē këngëtarit që e kishte emrin Litell Ton. Por Linda as që dëgjonte ç'thoshin. Ajo hante inat me veten që nuk kish ditur tē refuzonte e tē mos futej në mes tyre. Gjithshka i dukej e ftohtë, e shplarë, e huaj. Bile edhe vetë dhoma, gjithë shtëpia. Duke vështruar përreth, ajo u rrëqeth. Pandi e vuri re në çast këtë.

— Ke ftohtë? — e pyeti. — Po tē sjell sobën elektrike.

Pas pak i afroi pranë këmbëve diçka katrore e tē shndritshme, që nisi tē lëshonte avuj tē ngrohtë. Po ajo përsëri ndjente ftohtë.

— Ju lutem tē më falni — tha befas. — M'u bë vonë!

— Dhe u ngrit pa u dhënë kohë tē tjerëve tē thoshnin ndonjë fjalë.

Prapa krahëve la një botë, me tē cilën ishte e bindur se nuk e lidhte asgjë.

4.

Arriti me një frymë në shtëpi, duke kthyer kokën herë pas here se i dukej sikur e ndiqte njeri. Prindërit i gjeti në dhomën e saj. I jati ecte poshtë e lart dhe se përsë grindej me tē shqopen. Sa e panë atë, e prenë

fjalën në mes. Ai tha se kishte punë dhe shkoi nga dhoma tjetër. Për disa çaste u bë heshtje. E ëma u përpoq të zbulonte diçka nga shprehja e fytyrës së saj.

— E, si t'u duk? — pyeti kureshtare.

— Kush?

— Ajo, de.

— Po kush pra?

— E po, ja, shtëpia e Pandit.

— Nga e more vesh që isha atje? — pyeti e habitur.

— Po babai di gjë?

— S'do mend që di.

— Ehë, ju i paski sajuar të gjitha. Nuk ma priste mendja kurrë, kurrë...

— Kjo s'ka shumë rëndësi. Ti tregoi mamasë tanë: të pëlqen apo jo? Le që unë kot të pyes. Pse të mos të pëlqejë. Janë si veshka në mes të dhjamat. Me shtëpinë vilë, me të gjitha të mirat dhe paratë lumë që u vinë nga jashtë, për ty e përfëmijët tuaj. Cila vajzë nuk do ta lakmonte një fat të tillë?

— Kurse mua asgjë s'ma zuri synë. Asgjë. Më bëso: as me ajër nuk ngopesha. Mezi ç'prita sa u largova. Mëmës ju duk se bënte shaka.

— Ti, do të më ngacmosh mua, a si e ke hallin!

— E pse të të ngacmoj? Them atë që ndjei.

— Mos bën shaka! — ja ktheu ajo duke u përpjekur të shpinte buzën në gaz. — Me siguri që bëre shaka

— përsëriti pas pak.

— Aspak!

— Jo, jo. Nuk është e mundur. Po ti atje do jesh si zonjë, bije e nënës.

Linda qeshi më të madhe.

— Ti s'je në vete, moj vajzë. Po i bie me shqelim të mirës. Hajde, jepja fjalën nënës tanë.

Ajo ju hodh në qafë dhe mbështeti kokën në gjoksin e saj.

— Ah, moj nëna ime! Si tē ta shpjegoj unë që nuk janë përmua ata. Atje do tē jem — si tē them — do tē jem si një... shërbëtore e pasur. Kurse unë nuk e kam menduar kurrë jetën ashtu.

— Po si e ke menduar?

— Krejt ndryshe. Si tē ta shpjegoj? Po ti, kur u martove, shesh me lule e gjete? Jo? E sheh? E ndërtuat çdo gjë bashkë me babanë. Dhe kjo nuk ja pengoi që tē ishit tē lumtur. Apo jo? Mos ma kthe fjalën. Ti vëtë ma ke thënë këtë. Dhe jo vetëm njëherë.

Në atë kohë u hap dera dhe hyri i jati. Ai e vështroi disa çaste se mos i gënjehej mendja:

— Thashë se mos vijë me trutë e ndryshkur tē mëmës tënde — i tha së bijës.

— Baba, na paske dëgjuar! Dhe...

— Doemos, moj bijë, doemos. Ku di dhe unë se ç'i pjell kësaj nënës tënde. Ata janë shumë tē kamur përtë qenë tē mirë.

Lindita, për herë tē parë gjatë atyre orëve, e ndjen vreten tē lehtësuar. Ajo e vështroi me dashuri tē jatin që kafshonte buzët përtë mbajtur tē qeshurit kur vështronte fytyrën e trishtuar tē së shoqes, e cila seç përpinqej t'i thoshte me shënja. Linda ju afroa dhe e puthi në faqe.

— Ti je i mrekullueshëm, baba.

— Ai shikoi nga e shoqja dhe vuri buzën në gaz:

— Po mamaja?

Linda ju afroa. E puthi.

— Natyrish, edhe ajo.

ZBULUESIT

Fushimi veror qe ngritur nē zemër tē maleve, mbi disa lëndina që ndcheshin si qilima tē blertë, tē trashë e tē butë nē mes pyjeve prej ahu. Mbi to ngrihej gjoksi shkëmbor i malit, plot thepa e guva. Akoma më lart, mbi kurrizin e shkëmbit, kacavireshin ahet si një shark i rëndë e i gjelbërt, që e mbronte nga gricat e suterinat. Dukej sikur aty natyra e kishte krijuar çdo gjë përtu siguruar zbuluesve kushte sa më tē mira për stërvitje. Ata organizonin çdo ditë ngjitje tē guximshme alpinistike nē humnera shkëmbore, kapercime me !itar nga njëra pemë nē tjetrën, bënин marshime tē gjata me ritëni tē lartë dhe stërvitje tē tjera speciale.

Atë mëngjes kompania qe rrëthuar nē një nga këto lëndina. Pas veprimeve tē para nē ajrin e pastér e tē freskët, tē xhveshur gjer nē brez, zbuluesit qëndronin gati për tē filluar mësimin e ri. Zakonisht ata i prisnin më shumë dëshirë këto stërvitje. Gjatë ditëve tē fushimit ata kishin mësuar kaq gjëra tē reja, sa shpesh nuk mundeshin as t'i dallonin nga njëra tjetra. Në fillim, kur shikonin instruktorët e tyre t'u ngjiteshin si ketër pemëve tē larta, tē rrëshqisnin me lëhtësi buzë greminave, apo ta vinin poshtë «kundërshtarin» me një lëvizje tē vetme tē rrufeshme, ushtarët kislin mbetur gojëhapur e as që besonin se pas një kohe do t'i kryenin edhe vet tē njëjtat veprime. Por ditët kaluan dhe ata

nuk habiteshin më aq shumë me veprimet e instruktoreve, se sa më ato të shokëve të tyre më të dalluar. Dalëngadalë të gjithë filluan të kacavireshin me një shkathtësi të pabesueshme shkëmbinjve dhe të bënин kapje nga më të papriturat e më të shpejtat. Nisën kështu një garë të ethëshme me njëri-tjetrin dhe me shkëmbinjtë, pemët, përrënëtë, majat. Dhe duke u kalitur, as që e vinin re se si bëheshin më të qeshur e më gazmore, njerëz me humor të mirë e ëndërra të guximshme.

Përjashtim bënte vetëm njeri nga ata, Lek Matraku, i cili e kalonte të shumtën e kohës i vëtmuar. Çështë e vërteta, në fillim as ai nuk ishte i tillë. Pasi kaluan ditët e para, gjatë të cilave vëzhgonte me kureshtje çdo gjë dhe qëndronte si i tulatur nga rregullat e reja të jetës ushtarake. Leka u njoh me shokët dhe u bë një me ta. Ishte nga ata ushtarë që miqësohen shpejt, që kanë në sjelljet dhe qëndrimin e tyre d'çka të veçantë që i bën të dashur e të afruar me të gjithë. Komandanti i kompanisë e zgjodhi menjëherë si korier të tij. Kjo gjë u duk fare e natyrshme. Shokët e donin. U pëlhente sidomos natyra e tij e sinqertë, pak e n'rijtur, por gjithmonë e ciltër. Në orët e lira donin të bënë shaka me të e, nganjëherë, të matnin edhe forcat duke u kapur për beli. Leka qe aq i fortë sa askush nga ushtarët e kompanisë nuk ja delte. «Lum si ti! — i thoshnin shokët. — Ke lindur për zbulues, more vëlla. Do ta kesh lehtë me stërvitjen. Kurse ne të shkretët...» Dhe me të vërtetë Leka filloi të dallohej ndër shokët, dhe t'u hynte me lehtësi marifeteve të zbuluesit.

Mirëpo nuk kaloi shumë dhe të gjithë vunë re një ndryshim të papritur në qëndrimin e tij. Ai u vrenjt, u bë i mbyllur e nervoz dhe filloi t'u bënte bisht bisedave e takimeve me të tjerët. Tani nuk ja

kishte më ënda të provonte forcat në mundje, e, edhe kur shtrëngohet ta bënte një gjë të tillë, e kish vësh-tirë t'i qëndronte gjer në fund ndonjë shoku, të cilin më parë e vinte posht me lehtësi. Edhe në stërvitje nuk e kishte as zellin, as shkathtësinë e parë. Disa herë dreituesi i mësimit i kishte hequr vërejtjen përmungesë vëmendje. Një gjë e tillë jo vetëm ra në sy të shokëve, por edhe i futi në mendime. «Ç'po ngjet kë-shtu me ty, o Lekë? Mos ke ndonjë hall nga shtëpia? Ti na thuaj bre burrë, se ne shokë jemi e bashkë do t'i ndajmë të mira të këqia.» Po Leka sec mërmëriste mbeturazi me veten e tij dhe nuk jepte asnje shpjegim.

Shokët ngrinin supet dhe as që e vunë re se të gjitha këto ndryshime ngjanë pasi në kompaninë e zbulimit erdhi Agron Çardaku, ai ushtari me qafën e shkurtër e të gjërë dhe trupin e hedhur si një lis. Ag-roni u transferua nga një nënrepart zbulimi. Në jetën civile ai kishte punuar traktorist dhe ky profesion si-kur kishte lënë gjurmë në gjithë qënien e tij. Kishte një të ecur të ngadalshme e të rëndë dhe, kur i futej një punë, nuk largohej pa ja nxjerrë rrënjet.

Ai erdhi një pasdite dhjetori. Zbuluesit qenë grumulluar te një shesh i vogël dhe bisedonin e qeshnë të shkujdesuar me shoku-shokun. Këto biseda, zakonisht përfundonin me «kampionatin lokal të mundjes.» Kështu ngjau dhe atë ditë. Për një kohë, ata matën forcat me njëri-tjetrin dhe më i forti prej tyre, Ermiri, doli në «tapetin» e mundjes përballë Lekës. Nurua që luante rolin e arbitrit, i fryu bilbilit dhë ndeshja filloi. Leka u ul në gjunjë dhe e la trupin krejt të lirë që Ermiri ta kapte si të donte. Dhe në fillim, me një veprim të shpejtë, ai e rrëzoit e gati ja takoi shpatullat në tokë. Disa nga ushtarët u entusiazmuat para kohe dhe përplasën fort duart. Por Leka, me një trottullim të

trufeshëm, jo vetëm e evitoi pozicionin e vështirë, por edhe e detyroi kundërshtarin të dorëzohej. Atë çast Nuru se nga nxori një shtamë të vogël, ku kishte shkruar me shkumës «kampionit absolut të mundjes» dhe, pas një përshëndetje bombastike, ja dorëzoi me solemnitet fitimtarit. Të gjithë qeshën me lot. Si u gajasën mirë e mirë, u kujtuat për shokun e ri që qëndronte i drojtur me çantën e shpinës në krahë.

— Po ti?

— Jam transferuar në kompaninë e zbulimit.

— Ashtu? Domethënë tek ne. Gëzohem shumë. Të njihemi. Nuredin Gunga, shakaxhiu i kompanisë — dhe ai i zgjati dorën.

— Kini qenë zbulues?

— Po.

— Eh, ç'strup i lidhur! Po në mundje si je? Tjetri nuk u përgjegj.

— Aman, ore vëlla, fol. Vetëm ti me këtë trup mbasë e sjell në din Kasus Klein tonë, se na i mori shpirtin të gjithëve me radhë e nuk lë njeri të ngrejë kokë.

— Unë e ndoqa ndeshjen. Si të them? I fortë është, për besë. Nuk ma mban — foli i porsaardhuri.

— Po provoje, o burrë, se nuk do të humbasësh titullin e kampionit të botës.

— Njëherë tjetër. Tani Klei është i lodhur.

Leka vuri buzën në gaz:

— A, për mua mos u bëj merak.

— Atëhere e provojmë, po deshe.

Agroni hoqi çantën e shpinës, xhaketën, e doli përpara. Ushtarët formuan sakaq një rreth të gjërë, kurse Nuredini dha sinjalin e fillimit. Mundësit u mbërthyen nga beli dhe për disa minuta me radhë u përpinqën

të zbulonin forcat e njëri-tjetrit. Leka e kuptoi se këtë herë nuk do ta kishte të lehtë. U përpoq me të gjitha forcat ta mposhtëtë sa më shpërit. Por duke vpruar kështu, ai u lodh, kurse tjetri diti t'i ruante energjitetë. Më në fund, duke i lënë të gjithë gojëhapur, e de-tyroi Lekën të dorëzohej. U ngrit dhe, duke ju afroat çantës, foli si të ishte zënë me faj:

— Ishte i lodhur pa...

Leka mezi e mbushte gjoksin me frymë.

— Si e ke emrin? — e pyeti, pa ditur ç'të thoshte tjetër.

— Agron Çardaku.

Ai hovi nga vendi, si ta kishte pickuar njeri.

— Agron Çar-da-ku?

— Po. Po ti si quhesh?

Tjetri bëri sikur nuk dëgjoi.

— Lek Matraku, nga Dukagjinë. Nënkampion i kompanisë — ndërhyri Nurua.

Ushtarët qeshën, kurse Agroni kafshoi buzën: «Lek Matraku. Thua të jetë ai?» Shokët as që e vunë re futimin e tij. Në të vërtetë ata dalluan njëlloj turbullimi tek të dy, po e morën këtë si diçka krejt të zakonshme në mes dy rivalëve që porsa kishin provuar forcat dhe nisën përsëri të qeshnin e të bisedonin të shkujdesur.

2.

Që nga ai çast Lek Matraku nuk ishte më i qetë. Një ditë gjeti rastin dhe e pyeti. Atëhere s'i mbeti pikë dyshimi: Agron Çardaku, traktorist, nga Durrësi. Vte dora. Po ç'dreqin ja sollën në të njëjtën kompani? Ai ishte mirë. Thuajse e harroi atë që kish ngjarë në

Dukagjin dhe u dha i téri pas stërvitjes, e cila e tertiqte dhe i dukej interesante. Kurse tani asgjë nuk i bënte përshtypje. Në dreq të gjitha. Asgjë nuk i interesonte. Vetëm...

I dhenë pas brengës së tij, nisi të largohej nga shokët e të mbyllej në vetvehte. Sadoqë ruhej se mos binëtë në sy, ata e vunë rë këtë dhe e morën si një lëndim në sedër. As që arrinin ta merrnin me mend se shkaket qenë shumë më të thella, se të gjitha këto ngjissin nga që në mes të tyre qëndronte një e tretë, Mara, gëzimi i fëmijërisë dhe e fejuara e Lekës të cilën Agroni e kish bërë për vete. Shokët nuk e dinin këtë. Kujtonin se të gjitha vinin vetëm nga që Agroni e kishte vënë poshtë në mundje. Dhe disa u përpinqën ta bindin se në këtë mes nuk kishte asgjë për t'u shqetësuar dhe kot së koti i mbante mëri Agronit. Si e pamë që nuk ndërrroi rrugë, e kritikuan ashpër në mbledhjen e kompanisë. Në atë mbledhje të gjithë shprehën habinë për ndryshimet që kishtë bërë Leka, të cilat ishin shenja të një egoizmit të sëmurë. Vetëm Agroni u suall ndryshe. Ai tha disa fjalë që shokëve ju dukën të pa-qarta dhe u përpinq t'ja hidhët fajin tjetërkuj. Në fund shtoi se edhe ata, duke u shkëputur nga shoku, pa e kuptuar kishin hapur një hendek dhe kishin lënë shteg për keqkuptime.

Leka dëgjonte dhe ziente përbërëda. Do ta kishte pranuar çdo gjë, vetëm nuk mund të duronte që t'i qante hallin Agroni. C'njeri i cuditshëm ishte ail Pak kohë kishte në kompani dhe që afruar aq shumë me të gjithë. Shokët e çmonin dhe e respektionin shumë. Vëçanërisht në stërvitje nuk mund të matej asnjë me të. As, ai, Leka. Jo, nuk matej. Për një kohë, ai u përpinq me të gjitha forcat t'ja kalonte ose së paku të barazohet me të. Por nuk mundi. Vetëm dy tre herë në

ngjitje alpinistike kishte arritur i pari në majën e shkëmbit dhe instruktori e kish lavdëruar faqe shokëve. Por Lekës i dukej se edhe në këto taste Agroni kish mbetur me qëllim prapa. Zbuluesit thoshin se ai kishte një zemër të bardhë. Mbasi dhe e tepëronin. Po, po, e tepëronin. Leka qe i bindur për këtë. Vetëm pas asaj dite në fushimin dimëror ai ra në mendime të thella.

Ja si ngjau:

Zbuluesit po zhvillonin një stërvitje të vështirë në teren shumë të thyer për të asgjësuar shtabin e armikut imagjinat. Nuk e kishin parë veten më ngushtë se atë ditë. Dëbora e kishte mbuluar vendin me një shtressë të trashë, të akulltë, dhe vazhdonte gjithnjë të binte me kokriza të imta, të tejdukshme, që ta zinin frymën. Gjer në një farë vendi rrëshqitën me ski. Pastaj i morën ato në krah dhe filluan ngjitet. Kur po arrinin në majë, drejtuesi i stërvitjes dha urdhër të ndaleshin. Qëndruan rrëzë një shkëmbi. Dhjetra metro poshtë mezi dallohej një si vorbull e gjërë, e turbullt, që vërtitej e vërtitej.

— Atje është shtabi «armik» — tha prerë komandanti.

— Kush do të zbresë?

Ushtarët u zgjatën të shikonin. Shkëmbi zbriste thikë në humnerë. Vetëm duke e parë të merrej mëndja. E si mund të zbrisje në atë ngricë! Mos ishte kjo thjashët një kaçpiçio e komandantit, apo provë e kalitjes së zbuluesve, e aftësive të tyre? E pra, një provë të tillë ata nuk kishin kaluar kurrë.

— Unë, u përgjegj Agroni.

Leka kafshoi buzën.

— Edhe unë! — shtoi dhe e ndjeu se u lehtësua nga një brengë. Komandanti i udhëzoi me durim. U përpooq t'ua shpjegonte me hollësi gjithshka. Pastaj u dha litarë, çelësa gjoksi, çekiç alpinizmi, gozhdë. Filloi zbritja «Dylfe». Agroni u lidh me kujdes u kap pas litarit.

u dha këmbëve. dhe me një shkëputje të shkathëta rrëshqiti disa metra poshtë. Atje u sigurua, u mbush me frymë dhe përsëri i dha trupit. Pas disa sekondash arriti në fund të shkëmbit dhe thirri me të gjithë forcën: Eheejet! Zërin e tij e rrëmbeu suferina dhe e përplasi diku tutje. Thirri përsëri: Eheejet! Por prap nuk mori përgjigje. Atë ças nëpër mjegullën e dëborës dalloi diçka të zezë. Shikoi më mirë. Ishte Leka. Ai afroh j me shpejtësi. Në fillim kish menduar të ulej me shkëputje të shkurtëra, po kur pa se sa shpejt kish zbritur tjerrë, nuk e kuptoi ç'ngjau me të. E lëshoi trupin në humnerë dhe, kur u kujtua se kishte rrëshqitur më shumë nga ç'duhej, u përpoq të qëndronte. Por nuk mundi. Një forcë e çmendur e tërhiqte dhe e tërhiqte poshtë. Ai ndjeu t'i përvëlonte lëkura e duarve. E kuptoi se e kish humbur ekuilibrin dhe u përpoq të frenonte, por qe e pamundur. Po i afrohej me vrull fundit të shkëmbit. Në ato çaste, që zgjatën vetëm pak sekonda, ai nuk arriti të mendonte asgjë. Mbylli sytë. E kuptoi se ishte i humbur. Por befas ndjeu se dikush ja tërhoqi me forcë litarin dhe e largoi nga shkëmbi. Shpejtësia e zbritjes u ngadalësua si për mrekulli gjersa ndeshi në shtresën e butë të borës. Kur hapi sytë, pa se mbi të qe përkulur Agroni. Ai dukej i shqetësuar dhe seç e pyeste. Leka shfrytu egër. U ngrit. E vështroi me inat:

— Përse ndërhyre? Unë do të... zbrisja vet! — foli me mëdyshje, sepse ishte i bindur që, pa ndihmën e shokut, nuk do të zbriste në asnje mënyrë shëndosh e mirë. Por kjo kaloi dhe tanë mendonte për ngjitet. A do të mund ta bënte këtë pa ndihmën e Agronit? Mblodhi forcat dhe u përpoq të ngjitej. Ju duk shumë e vështirë. Gishtat i digjinin. U përpoq përsëri. Por prap nuk mundi dhe, i pafuqishëm, e lëshoi trupin në duart e Agronit.

Kjo ngjarje nuk ju largua nga mëndja për shumë kohë dhe kur zbuluesit dolën për fushim veror ju përtërit me një forcë të re. Ishte po ai vend që kishin shkelur gjat dimërit, por, veç mbresave të forta, asgjë tjetër nuk do t'i bënte të besonin se po kalonin në të njëjtat shtigje. Tani, në vend të shtresës së trashë prej dëbore, malet kishin hedhur mbi supe petkun e blertë. Bredhat lëkundnin degët në ajër dhe shushurinin një histori të vjetër e të njohur për zbuluesit. Rreth e qark çdo gjë kishte ndryshuar. Ditët me cingërimë dukej sikur nuk kishin të bënин fare me atë vend dhe me ata ushtarë. Vetëm Leka kishte mbetur ai që qe. Për një kohë u përpoq të jepoj pas stërvitjeve dhe t'i harronte ato që ndodhën e që i kishin sjellë aq shumë shqetësimë. Dhe kur e kur i dukej se nuk do ta kishte të pamundur ta bënte këtë. Por, me të ndeshur Agronin, çdo gjë përbysëj dhe ai e kuptonte se qe e kotë ta gjenjente veten. Natyrish, shokët nuk e dinin akoma ç'kishte ndodhur dhe mbasë nuk do ta mësonin gjer në fund brengën e Lekës, por kjo pak punë prishtë. Fshatarët e tij, madje e tërë krahina e kishte marrë vesh fyerjen që i ishte bërë e kjo e mjaftonte që të mos e ndjente veten të qetë e të lumtur. Dhe sikur kjo të ishte pak, duhej të duronte çdo ditë vështrimet shigjetë të Agronit, të stërvitjes në një vend me të, të hante në një tavolinë e të flinte në të njëtin kapanon. Lekës i vinte inat që nuk kish ditur ta bindte komandantin për ta transferuar në ndonjë repart tjetër, qoftë edhe në skajin më të largët e më të izoluar. Po ta kish bërë këtë, do ta kish hedhur çdo gjë prapa krahëve e do të ishte edhe ai i qetë si të gjithë. Por ja që çdo ditë çdo orë Agronin e kishte parasysh. Po ta merrje punën

hollehhollë, ai ishte njeri i mirë. Heraherës Lekës i dukej se në sjelljen e Agronit, në veprimet e tij, sadoqë tregohej shumë i kujdesëshëm, nxirrte krye. Ndjen a e epërsisë, e përzier me një farë keqardhjeje, dhe kjo e mundonte më shumë se çdo gjë tjetër. Po prap ai e ndiente se nuk kish forca as ta urrente, as t'i mbante mëtri. Megjithatë, mjaftonte një shkas i vogël, një shaka e shokëve; apo një letër nga shtëpia që ai ta humbiste qëtësinë dhe çdo gjë t'i dukej e vizatuar me ngjyra të zymta, të errëta.

Edhe atë mëngjerez Agroni kishte marrë një letër të tillë. Në minutat e pushimit ai u largua nga shokët dhe nisi ta lexonte. Leka kish zënë një qoshe, thithje pa pushim cigaren dhe duke u hequr sikur e kishte mëndjen gjetkë, e ndiqte atë me bishtin e syrit. Agroni çapitej ngadalë, lexonte me zë dhe qeshte pa të keq. Lekës ju njomën grushtat nga djersët.

Atë çast u dha sinjali. Do të fillonte ora tjetër e stërvitjes. Ushtarët u rreshtuan. Instruktori doli para tyre. Ai tregoi temën e re. Diçka që kish të bënte me asgjësimin e rojes që Leka nuk e kuptoi mirë. Ai qe bërë duman. Ndërsa instruktori fliste, atij i ra ndërmend se ajo letër do t'i kishte ardhur Lekës e do ta kishte gëzuar aq shumë sa... E ndjëu se në fyt ju mblodh përsëri ai lëmsh që ja zuri frymën. Zbërtheu jakën e xhaketës dhe shfryu si një ka. Drejtuesi i stërvitjes u habit me këtë veprim të tij.

— Ç'kini kështu, ushtar Leka, mos jini i sëmurë? — e pyeti. Ai seç u përgjegj me ngadalë. Në atë çast u afroa me hap të shpejtë Agroni.

— Po ju ku ishit! Nuk e dëgjuat sinjalin?

Agroni kërkoi të falur. Qe skuqur i téri. Dukej aq i lumtur, sa Leka u turbullua edhe më shumë. Zuri vend pas tij. Tani Leka nuk ja shikonte fytyrën, ndjen-

te vetëm ftyrëmarrjen e tij të shpeshtë dhe e kuptonte që ishte i lumtur, shumë i lumtur. Ndërkaq instruktori i sambos shpjegoi çfarë duhej të kishin parasysh pér asgjësimin e rojes kundërshtare. Duke nxjerrë një ushtar para rreshtit, ai tregoi disa herë si bëhet kalimi i duarve nën gjunjë, tërheqja, rrëzimi dhe mbytja. Pastaj i ndau zbuluesit dy e nga dy dhe urdhëroi të fillojn veprimet.

Ata u ndodhën ballë pér ballë, fare pranë njëri tjetrit. Agroni vështron te diku përpala, në një pikë të padukshme, dhe nuk e vuri re fare se cilin kishte karshi, kurse Leka qëndronte si mbi gjemba. I pëshpëriti diçka shokut që kish në krah, duke i bërë me shënje të shkëmbenin vendet, po tjëtri i mblodhi supet nga që nuk kuptoi gjë. Në këto e sipër, instruktori dha urdhër të fillonin veprimet. Rreshti i Lekës, që do të imiton te rojen e armikut, nuk lëvizi nga vendi, ndërsa Agroni me shokë u fshehën prapa kaçubeve dhe, me kërcime të befasishme, filluan veprimet. Agroni ishte i shkathët si një dre dhe Leka as që e ndieu si ju afroa, si e tërhoqi nga këmbët dhe e rrëzoit përdhe. Inistikivisht ai u përpaoq të kundërvepronte, të mbrohej, por nuk qe në gjëndje të bënte asgjë. Brenda pak sekondave qe rrëzuar. Agroni qëndronte mbi të. Kish kohë që nuk qenë ndodhur aq pranë njëri-tjetrit. Natyrisht kishte qëlluar edhe herë të tjera të kryenin detyra të përbashkëta, por sigjithnjë ai kish ditur të bënte bisht me marifet, ndërsa sot nuk arriti të bënte asgjë. Dhe ja tek qëndronte nën trupin e tij. Agroni ja futi parakrahun nën fyt.

Leka mbylli sytë dhe vendosi t'i mbante ashtu gërsa të mbaronte ushtrimi. Por nuk mundi. Vështrimet e tyre u kryqëzuan. Agroni ju duk çuditërisht i qetë, i papërqëndruar. Kishte dy sy gështenjë, të futur në

gropëza, mbi të cilat ngrihej balli i lartë me një lëkurë të shndritshme nga buqezat e djersës dhe hunda me samar, që sikur i nxirrte më në pah tiparet e tij të theksuara. Kishte një tytyrë krejt të zakonshme. Madje, jo tërheqëse. Së paku kështu ju duk Lekës. Po prap sikur kishte diçka të veçantë, të cilën ai nuk qe në gjëndje ta kapte. Ju duk sikur ato tipare fshihin n jë lumturi të thellë që shprehej në tërë qënien e tij. Leka u drodh kur mendoi se atë gëzim ja kishte sjellë letra që mori pak më parë. Sa do të donte të mësonte se ç'shkruhej në atë letër. Si i drejtohej vallë ajo? «Agron» «I dashur Agron?» Apo...? Ç'i thoshte? Dhe prap i vajti në mend, se, po të kishin rrjedhur ngjarjet ndryshe, po të mos kishtë shkuar në fshatin e tyre ai djalë me ata sy gështenjë, të humbur në gropëza, Mara nuk do të qe njojur me të dhe letrën do ta kishte marrë ai. Si do t'i drejtohej vallë atij? Ç'do t'i shkruante? A do të qe e lumtur me të? E pse jo. Por ja që doli ai... Doli fare papritur, si të mbinte nga dheu, bashkë me shtatë a tetë të rinj dhe të reja që shkuan për të punuar vullnetarisht në kooperativat malore. Fshati ato ditë ishte si në ethe. Kudo fitje për zakonet prapanike, besimet fetare, fejesat e djepit. Disa herë mbledhjet nisnin në drekë e mbaronin pas mëzit të natës. Në një mbledhje të tillë ata u panë për herë të parë. Pastaj ai bujti disa ditë në shtëpinë e saj. Në bisedat e gjata, pranë vatrës, u panë përsëri. Vështrimet e tyre u turbulluan nga ai zjarr plot dridhma që u ndez dalëngadalë në zemrat e tyre. Të tjerat rodhën aq prpritur, sa...

Në një mbledhje të rinisë Mara u ngrit e tha se e prishtë fejesën e lidhur që në djep. Familjet e tyre tridhni nga një gjak dhe Lekën e quante vëlla e shkuar vëllait. Atij sikur i ra çatija mbi kokë. Po të kishte

ngjarë kjo dy-tre vjet më parë, ato fjalë edhe atij do t'i qenë dukë me vend, kurse më vonë... Më vonë as vetë nuk e kuptonte ç'ngjau me të. Sa më tepër kohë shkonte, aq më shumë ndjente se ajo nuk ishte për të thjeشت një shoqe, si të gjitha të tjerat, po diçka më tepër, shumë më tepër. Kur ndodheshin pranë, Leka i hidhte disa vështrime të ndezur, kurse Mara skuqej gjer te veshët dhe ulte kokën e ikte gati me vrap. Kështu ngjau edhe herën e fundit, para se të vinte traktoristi. Ndërsa më pas nuk ja hidhte as sytë, gjersa ngjanë ato që ju dukën si një ëndërr e keqe. Në fshat flisnin dhe gurët e rrugës se Mara dashuronte Agronin, se ata së shpejti do të linin fshatin e do të shkonin në qytet, në shtëpinë e tij.

— Po ju atje ç'bëni? — pyeti befas instruktori? Nuk kapet aq lehtë kundërshtari, por shtërngohet fort...

Leka u përmënd. E vështri drejt Agronin. Ai shpuri buzën në gaz. Ajo buzëqeshje e turbulloj më shumë. Përse e kish shtrënguar aq lehtë? Mos vallë nga që i vinte keq, e mëshironte? Ai do të donte ta shtrëngonte fort, fort, sa ta ndjente dhëmbjen g'er në kockë. Po të kiske mundësi, Leka kështu do të bënte. Ose do të langojë prej tij, që të mos ja shikonte sytë. Ata sy të përhumbur që përpinqeshin më kot ta fshihnin gjëzimia, lumturinë.

— Nëpër vënde! — buçiti zëri i instrukturit. — Tani do të ndërroni rolet.

Pasuan disa komanda të tjera. Agroni i zbatoi ato mekanikisht, pa e patur mëndjen. Disa herë bile u ngatërrua. Instruktori i hoqi vërejtjen, po ai prap u ngatërrua. Çudi me të! Përse të hutohej kaq shumë. U përpinq të tre gohej më i kujdeshëm, po nuk mundi. Mendjen e kishte gjithnjë te letra. Ishte letra e parë që merrte prej saj, pas një pritje të gjatë. Ai do të donte ta

lexonte edhe njëherë nga fillimi. Pastaj të ulej dhe t'i shkruante. T'ja zbraste të gjitha ato që kish mbledhur në mend e në zemër. Ndaj ishte i hutuar e nuk përqëndrohej dot plotësisht në veprime. Shokët duhej ta kuptonin këtë dhe të mos ja vinin re. Ta linin vetëm. Ta lexonte sërisht. Pastaj t'i shkruante. T'i tregonte se mëndjen e kishte gjithnjë te ajo. Le pastaj sikur të mund ta takonte dhe t'ja thoshte të tëra me gojë. T'i thoshte se ç'gëzim i solli letra e saj, fjalët e saj. A do të qe i zoti t'ja tregonte këtë ashtu s'i e ndjente?

Vështrimet e tyre u kryqëzuan sërisht. Leka u hutua edhe më keq. Ç'donte të thoshte me atë vështrim? Të shprehte gëzimin që ndjente, apo mëshirën dhe keqardhjen për të? Mbështetje ai e kuptonte gjendjen e Lekës dhe i vinte keq. Ndaj e shikonte ashtu. Ndaj përpiquej t'ja fshihte ndenjat e tij. Të hiqeji i shkujdesur, mos-përfillës, si të mos e kishte në xhp letrën e saj e të priste me padurim sa ta lexonte nga e para!

Drejtuesi i stërvitjes uli me trëmbim dorën: «Para!» Leka ju afrua. Kërceu mbi të si një tigër. Me njëren dorë ja tërhoqi kokën pas, kurse tjetren ja shkoi nën fyt. Fytyrat e tyre u ndodhën përsëri fare pranë. Leka e shkoi ngultas. Ju duk se sytë e tij ngjanin çuditërisht shumë me të saj. Edhe ajo kështu i kishte, të futur në gropëza, veçse më të mëdhenj, më të qeshur. Vetëm kur shikonin atë, Lekën, e humbisnin shkëlqimin e zakonshëm dhe të trembur futeshin më thellë në gropëza. Po kur vështronin Agronin a lëviznin ashtu, si të zënë në faj? A kishin qëndruar vallë fytyrat e tyre kaq pranë njëra-tjetrës? A kishin...

Leka ndjeu befas zëtin e instruktorit:

— Më të shkathët, shokë. Ç'është k'o plogështi? Kapeni fort kundërshtarin. Dora e majtë...

Po nuk e ndoqi dot gjer në fund mendimin e eprorit. Ai kishte humbur i téri në mendime. Sytë e tij i kuftuan përsëri sytë e Marës. Ju duk sikur ja ndjeu qartë dhe zérin:» Leka është vllau jem. Unë jam rit me të. Unë nuk mund... Do ta zgjedh vetë atë që due...»

— Në qoftë se kujtoni se kini përpara shokun tuaj, nuk do të vepronî mirë. Duhet konsideruar ai si një...

«Mara ka turpërue fshatin. Ka shkelmue familjen e vet, fatin e vet. Ngrihet gjoja kundër zakonit, por... Pse s'e thotë haptaz: nuk e due Lekën, dua atë të qytit, Agronin» «Mbramë natën i kanë pa bashkë... Si e duron Leka kët turp...?»

— Ç'është kjo plogështi? Më mirë, shokë. Të veprojmë në stërvitje si në luftë.

«Po Agroni? Kur isha në rrezik, u bë copë për të më shpëtuar. Ai nuk më ka ndonjë faj... E si nuk paska, përderisa...»

A thue ai ish ligështuar? Nuk kish forca ta kapte fort? Ta mbërthente ashtu siç duhej? Dhe në një çast e shtrëngon e shtrëngoi. Diçka kërciti. E shtrëngoi akoma. Agroni u zverdh. Sytë e tij e humbën shkëlqimin, u venitën. «Çou!» Ushtarët brofën pëtjesh. Vetëm një ri nga ata, Agroni, u përpëlit si gjeli kur i presin kokën dhe ra përbysi. «E mbyti!» «Ç'bëre kështu, Lek?» «Shpejt frymëmarrjen artificiale!» Shokët u lëshuan mbi të. I lëvizën duart, e fërkuan... Më në fund ai hapi sytë. U ngrit me vështirësi ndenjas. E shikoi. I buzë-

qeshi: «Leka s'pati faj. Veproi shumē mirē, si nē luftē.
Unē...»

— Cou!

Leka u përmënd. Qe mbytur nē djersë. Sa mirē që ky
ishte një vegim, që nuk veproi ashtu me tē vërtetë.
Vetëm përfytyrimi i asaj që mund tē ngjiste e bëri t'i
vinte ndot nga vetia.

— Ç'ke këshfu, Lek? Pse u zverdhe?

— Asgjë, Agron. Se si më erdhë.

— Do tē kalojë.

Po, do t'i kalojë. Me siguri do t'i kalojë. Ai e kishte
Agronin shok, vëlla. E ndërsa shikoheshin sy më sy, ai
e ndjeu se për tē mund tē bënte shumë...

HORIZONTE TË KALTËRA

Bashkëfshatarëve të mi, që goditën me pushkë
dhe dëmtuan rëndë një aeroplan armik.

Qafa e Tendës ngrihet si një mburojë në gjoks të fshatit, të cilën e mbron nga erërat e vrullshme të jugut. Në majë të saj lisat ngrihen përpjetë, kurse gjer poshtë zbrisin vargan tokat e punuara si ca jorganë laramanë. Anash tyre ngrihen tek-tuk ahe të vëtmuar e të harruar, shenja të pyllit të dikurshëm, të cilin fshatarët e kishin qëmtuar në vjete për të zbutur zemrimin e dimrit e për t'i rrëmbyer qafës disa pëllëmbë tokë buke.

Markuq kish hedhur pushkën krahëve dhe, çap e çup, rrëshqiste nën degët e dëndura të lisave. Vështrimi i tij ndehej mbi kodrat e vogla, që dukej sikur rrökulli-seshin nga mali dhe zbrisnin në theqafje, giersa toka zbutej e shtrihej e lirshme gjer tej buzë lumit. Në tërë këtë hapësirë, rrallë e tek të zinte syri ndonjë fshatar që punonte tokën a kulloste bagëtinë. Jo shumë larg çokiste një sopatë druvarti. Kohë më kohë druvarti njomte duart me pështymë dhe godiste me tërë forcën ahun, duke ofshajtur thellë, si të nxirrte me mundim nga gjoksi i gjérë e leshtor diçka që u jepte me shumë vrull shpatullave të tij plot muskuj. Në një çast pema u lëkund

e tēra, kërciti dhe u rrëzua me vrull drejt tokës, duke shtypur e palosur nën vete ajrin që fishkëllinte. Druvari u ul mbi trung, nxori nga xhepi qesen prej lëkure dhije, drodhi një cigare, e ndezi me eshkë dhe nisi ta thithte i kënaqur, duke fshirë me kurrizin e dorës ballin e djersitur.

Markua u çapit mendueshëm, duke fishkëllyer lehtë. Kur ju afrua togut të gurëve, të ngritur si mur pak më tej, seç i tringëlliti nën këmbë. Ai u përkul dhe mori një gëzhojë. E ktheu nga ana e prasme dhe lexoi gërmat dhe shenjat në rethin e saj. «Fishek malisheri» mendoi dhe vrau mendjen të gjente se cila pushkë mund ta kishte shkrehur. Ekte dhe përmendte me zë emrat e bashkëfshatarëve që kishin malisher. Sakaq maja e këmbës i preku një gëzhojë tjetër. «Fishek paticke» mendoi dhe prap u përpoq të gjente se kush mund ta kishte shkrehur. Sa më lart ngjitej, aq më shumë gëzhoja i kapte syri dhe përmendi me radhë thuajse të gjithë emrat e bashkëfshatarëve, sepse të gjithë kishin pushkë. Ja atje, tek ledhi e kish pozicionin Fotua. Në të majtë kishte Mitron, kurse në të diathtë Lamen. Pak më lart, te shkëmbi kish zënë vend Telua, dhe me radhë të tjerët. Në një çast mbylli sytë dhe ju duk sikur të gjithë qenë shtrirë aty dhe do të mjaftonte një zë, një urdhër, që shulet e pushkëve të kërcisin e ta fusnin fishekun në gojë. Ai mbajti frymën. Ju bë se dëgjoi shpérthimin e pushkëve dhe ndjeu erën e barutit. Qafa e Tendës shungëlloi si një javë më parë, kur fshatarët bashkë me çetën partizane i thyen dy herë radhazi fashistët, të cilët u përpoqën ta shtronin krahinën me zjarr e me hekur e të shtrinin atje pushtetin e tyre, të përzënë me pushkë nga fshatarët. Por të dy përpjekjet e tyre kishin dështuar dhe ata qenë larguar nga sytë këmbët. Thuhej se komanda e tyre tanë po preqatiste një sulm të ri, për të

vénë tië vend nderin e ushtrisë së saj të marrë nëpër këmbë. Po ditët kalonin njëra pas tjetrës dhe dukej sikur fashistët, të kënaqur me qetësinë e qytetit, trembeshin mos përsëritez histori. Megjithatë fshatarët e rrëzës e dinin se hasmit nuk i zihet besë, ndaj kishin ngritur njësitët e vetmbrojtjes dhe kishin nxjerrë rojet vërtu siguriar nga çdo e papritur.

Dhe ja, radha e shërbimit i erdhë Markos. Me pushkën krahëvë e vështrimin e tretur përpara, ai çapitej ngadalë e përpiquej të mos i shpëtonte as lëvizia më e vogël. Si arriti te ledhi, u shtri në pozicion, tamam atje ku kish zënë vend para një jave dhe mori shenjë. Ju duk sikur e shihte edhe tani atë ushtarë e gjatë që ecte gjysmë i kërrusur dhe qëllonte pa pushim në drejtim të pozitioneve. Markua nuk e kishte shumë larg. Ngri ti kokën për ta parë më mirë. Vështrimet e tyre u kryqëzuani. Atë çast fashisti hapi zjarr. Ai e ndjeu shumë afër krismën! dhe plumbin që i rrëshqiti rrëzë veshit. Ra rrafsh me tokën e mori shenjë. Ushtari i gjatë, gjysmë i kërrusur, me vështrimin e egër dhe të trembur, përpiquej ta zbulonte përsëri në mes të shkëmbinjve. Shikonte: dhe kërcente si egërsirë e trembur nga një ledh në tjetrin. Akoma një hap. Edhe një. Markua tërhoqi këmbëzën. Bam! Fashistit i ngriu dora në ajër, qëndoi një hop drejt, pastaj nxori një ulurimë rrënqethëse dhe u përmby. Markua e humbi torruan dhe u ngrit për të parë si u rrëzua. Sakaq flokët ja përzhitit diçka e zjarrtë. E kuptoi se ish treguar i pakujdeshëm dhe kjo i kushtoi për pak jetën.

Qafa, e Tendës e priti me gjoks metalin e nxehthë dhe derdhë zjarr të dendur mbi fashistët, duke i rralluar pa mëshirë reshtat e tyre. Jehona e betejës, si n'ë bëbullimë shurdhuese, dukej sikur endej akoma mbi majë. Markua dëgjonte një gjëmim të thellë, të pandërprerë.

Ky gjënim u bë befas më i fortë. Ai ngriti kokën dhe, për të parën herë atë ditë, vështroi qiellin. Ishte një qiell i përhirtë, i butë si sfungjer. Nga lindja vraponia copa resh të bardha, si shkumë qumështi. Sakaq bubullima u shtua dhe mbi të rrëshqiti një hije e madhe, e zezë, që mbështolli majën.

«Aeroplan» thirri dhe u lëshua me vrap teposhtë, si të donte të arrinte hijen e tij. Por ajo ju zhduk në çast nga sytë. Po i afrohej fshatit. Disa fëmijë vrapuan rrugëve dhe dolën në shesh. Markua dëgjoi një kërkëllimë të zgjatur, që u shoqërua nga shpërthime të forta. «Bombardoi...» Ndërkaj rrugët dhe sheshi u mbuluan nga tymi e pluhuri. Atij sikur i mbeti zemra në vend kur mendoi se ndërmjet të vegjëlve mund të ishin dhë fëmijët e tij. Mori pushkën dhe u lëshua drejt fshatit. Kapercente me një të hedhur kanale, ferra, boriga. Njëra nga ato e pengoi. Ra shakull mbi ferrë. Gjuri i theri. Duart, fytyra, ju gricën. Por atë çast ai s'ndjeu asgjë. U ngrit dhe u turr prap drejt fshatit, si ta ndiqte njeri pas. Ndërsa vraponte ashtu, u kujtua se ishte roje. Shkurtoi hapin, Po sikur, ndërkaj, të suleshin drejt fshatit fashistët? Parasysh i dolën përsëri të vegjëlit që vraponia rrugëve, bombat që shpërthyen tymi, thirrjet. E ç'mund të bënin më shumë se kaq fashistët, po të vinin? Dhe nisi sërisht të vraponte. Po dicka e papritur e mbërtheu në vend. Qielli buçiti. Gjëmoi pastaj aio hiqe që rëndte e rendte ogurzezë drejt fshatit. Mbaiti hapin. Kishte arritur në mes të një are. Aeroplani afrohej, afrohej. Pa ditur ç'të bënte, Markua ngriti grusht n dhe u hakerrua. Turirin e aeroplánit e lëpinë disa gjuhë të ziarrta. Markos ju duk se e përqeshën atë. Por s'pati kohë të mendohej. Në tokë, pranë tii, u noulën plumbat. «Më vrou!» tha dhe instiktivisht ngriti pushkën, e shkrehu. Por ishte vonë. Aeroplani çau pëpara dhe gati sa s'e mori me vete me ajrin që çvendosi. Ai ngriu me

armën nē dorë dhe grushtin lart. Por aeroplani as që e çau kokën për të. U lëshua si egërsirë e uritur drejt fshatit dhe derdhi mbi të zjarr e flakë. Me sytë e kap-sallitur, Markua ndóqi dhe për një kohë hijen që h'rë dukej e herë zhdukej ledheve, përrrenjve, pemishteve. Ju duk ajo hije si këmbë fashisti që zgjatej e zgjatej dhe shkelte mbi rrugët, mbi fhatin, mbi shtëpinë dhe trupin e tij. Ai kafshoi buzët. Kurrë s'e kish menduar se has-mi mund të vinte nga lart, nga qielli, dhe ta gjente me armë nē dorë, po të pafuqishëm. «Ah, qeni!» Forcat ju prenë. Nuk ishte i zoti as të vravonte, as të ecte. Qëndronte ashtu, si i ngritë, buzë ledhit. Vështronte me frikë qiellin, i cili i dukej tani i shplarë, i pështirë. «I mallkuari..!» s'e kuptoi kujt ja tha këtë: qiellit apo-aeroplanit. Po nuk arriti të mendohej më gjatë. Bubullima e gjeti përsëri të papregatitur. Ai gjëmim ju fut gjer në palcë. Hieja u sul si egërsirë drejt majës, e mbësh-tolli atë dhe ja zuri frymën. Teksa po i afrohei, ai e shqoi atje lart pilotin. Ngriti grushtin dhe ju hakërrua. Po kërceu i trembur përpjetë. Nëpër këmbë u ngrit pluhuri. «Heu, desh ma kripni lëkurën!».

Dhe prap i vajti mendia te arma. E ngriti me shpejtësi, u përhoq ta fuste nē shenjë, të qëllonte. Po aeroplani përsëri nuk pyeti për të. U lëshua me bubullimë drejt fshatit dhe shtreu mbi të gjithë inatin.

Markua nuk ja shkëputi sytë. E pa si bëri kthesën rrëzë maleve, duke përshkuar nië rrëth të gjérë, dhe si mori drejtimin përmbi Qafën e Tendës. Ai tani e mposhti hutimin, u kujtua se kishte nē dorë armën dhe nuk i dukej vehtja aq i pafuqishëm. Priti me ankth sa të afrohei dhe hapi zjarr. Pi'oti, siç dukei, e ndjru se po e qëllonin. Këtë radhë nuk ju afrua fare fshatit, po u lëshua pingul nē vendin ku kish parë njeriu. Vendin

e mbuloi po ai gjemim kërcënonjës. Markua u përpoq të merrte sérish shenjë, duke e shoqëruar me lëvizjen e pushkës në hapësirë. Tërhoqi këmbëzën: bam. Edhe një herë: bam. Po e ndjeu se në çastin e fundit, kur e kish shkrepur, aeroplani kish rrëshqitur përparrë dbe plumbat qenë ngulur në gjoksin e kaltër të qiellit. «U dashka marrë shënjim përnara!» — thirri plot gojën, si të kish bërtë një zbulim dhe qëlloi përsëri. Atë çast diku afër, u dëgju n krisma të tjera, thirrje. Markua mbajti vesh. Po, krisma, thirrje. E kupto se nuk ishte vëtëm, se burrat e fshatit që kishin armë, kishin zënë vend në ledhe e shkëmbinj dhe po qëllonin. Po aeroplani qe larguar dhe plumbat mbetën shumë më prapa. «Po ta mbajti, hajde prap!» ju kanos Markua, duke i vënë armës një ballë tjetër me fishekë. Ndërkaj vendi gjemonte nga thirrjet. Në fillim njerëzit, sidomos të vegjëlit, e pandehën si diçka zbavitëse dhe u lëshuan kureshtarë rrugëve. Po kur rreth tyre nisën të shpërthenin bombat, ata u ngjishën të trembur rrëzë mureve, shpellave, ledheve. I tërë fshati viaponte, therriste, qëllonte, duke shfryrë mërinë mbi atë shpend të zi, të hekkurt e bubullonjës, që dukej sikur e vërtiste qiellin dhe tokën me gjëmimin e tij shurdhonjës. Markua e ndjeu këtë dhe mori zemër. «Qëllojnë shokët» mendoi. «Tani hajde, po ta mbajti» u hakërrua duke vështruar an-dej nga vinte ajo vuvurimë e mbytur dhe e zgjatur, si një zukatje e pambaruar bletësh. Piloti, si të kishte dëgjuar këto, ju drejtua përsëri fshatit. Markua dalloj gjuhëzat e flakës që lëpinin turirin e aeroplanit, si ta që-sëndisnin me mospërfillje, pastaj disa ruaza të zeza që u lëshuan me rëkëllime drejt tokës. «Bomba! dhe në një çast ju duk se ato do të binin të gjitha mbi të. Po shpejt u përshkund e nisi të qëllonte. Edhe piloti, siç dukej, e kishte dalluar njeriu që kish zënë vend gjatë

ledhit dhe u lëshua kryeneç e mospërfillës mbi të. Duke e shikuar nëpërmjet shqekzës dhe thepit të pushkës, Markos ju duk se aeroplani u zvogëlu e u zvogë ua dhe në një çast i doli parasysh ai ushtari i gjatë e i shëmtuar, me majën e bajonetës të drejtuar mbi të. Ju kujtua se me të shtënë e dytë apo të tretë e kish trëzuar thes mbi tokë. Tërhoqi këmbëzën disa herë me radhë, gjersa e shkruhu të gjithë ballin e fishekëve dhe vuri krëhërin e ri. Aeroplani nxirrte pa pushim gjuhëza të zjarrrta. Piloti dhe ai, fshatar Marko, dukj sikur vështroheshin sy ndër sy e derdhnin mbi njëri-tjetrin, bashkë me plumbat, edhe urrejtjen e zemrave të tyre. Markua merrte shenjë dhe qëllonë duke shtrënguar dhëmbët. Bashkë me të qëllonin nga të gjitha anët edhe fshatarët e tjerë. Aeroplani përgjigjej me një kërkëllimë të fortë e të zgjatur. Humbiste gjithnjë më shumë lartësinë, sa dukej sikur do të ngulej me vrull në zemër të tokës. Për një çast ai gati sa s'preku majat e pemëve. Markua tërhoqi këmbëzën e pushkës dhe qëlloi. Ju duk se plumbi goditi në shenjë dhe aeroplani do të përplasej në tokë. Po në çastin e fundit ai ndërtroi drejtim, duke marrë me vete buçimën rrëqethëse dhe duke përkultur thellë majat e pemëve. Çdo gjë u drodh e u përbys. Markua mezi u ngrit. Tamam atëhere buçiti një zë:

— U godit, qeni, u godit! Ma mori të keqen!

Ai nuk desh të besonte dhe vështronte gjithë andej nga qe zhdukur aeroplani. Ndërkaj vuri re se njerëzit nisen të vraponin e të thërrisin në një zë:

— U godit!... U godit!...

Aeroplani, duke u anuar herë nga njëra anë e herë nga tjetra si një egërsirë e goditur për vdekje, e humbi sakaj ekuilibrin, la pas një bisht të zgjatur e të zi dhe u ngul me turi në faqe të malit. Markua vështroi

edhe disa çaste andej, si tē priste tē ngrihej pas asaj marrëmendje e tē lëshohej si bishë e tërhuar mbi fshat. Sakaq njerëzit i rrëshqitën fare pranë, duke thirrur me sa u mbante zëri:

— Siç duket, u rrëzual... Po, po... U rrëzual.

Dhe nisi tē vraponte edhe ai, duke mbajtur me dore krahërorin, si tē kishte frikë mos i shpërthente. Vraponte dhe thërriste në kupë tē qellit.

— He -he, u godit ore, u godit!

Dhe i dukej sikur bashkë me tē, me njerëzit, gëzoheshin, vraponin e thërrisin edhe shtëpitë e përzhitura, kodrat, malet!

PRANË PIRAMIDËS

Disa orë më parë ai qe kthyer në postë. Shërbimi buzë kufirit dbe rruga e gjatë, e cila dredhonte monopateve duke ju hedhur si një lak në qafë grykave të malit, ja patën përpërforcat pak e nga pak. Sa u kthye, shokët e tij kishin shkuar të flinin, kurse ai u mbështet pas murit dhe e tendosi vështrimin përpara, mbi malia e thepisur. Kohët e fundit Bardhylit i pëlgente të qëodronte aty i vetëm dhe të miklonte mendimet, të kuvëadonte me to. Vështronte luginën, kodrën, malin, që kishin veshur rrobën e trashë, të gjelbër e të ndezur të pranverës dhe çuditej me veten: sa të afërt e të dashur i dukeshin tani ata shkrepë, ata gërxhel Dy vjet të shkuara, kur kish shkelur për heië të parë aty, ndjucnjë si zbrazëtirë në zemër. Lugina, kodra, mali ju durkën të shplara, pa ngjyra e pa jetë.

E ja tani i ngjante sikur nuk ishte atje, po në një vënd tjetër e para sysht nuk kish më atë tabllonë e zymtë të fillimit, po një panoramë krejtësicht të ndryshme. Ai njihte atje çdo gur, çdo dru, çdo zgavër e rrugicë. Këmba e tij e kish shkelur vendin pëlliembë përpëlliembë. I kish shkelur sa e sa herë shtigjet kufitare, kish qëndruar nën degët e lisave të moçëm, që zgjaten e zgjaten si të duan të rrokin diçka të pakapëshme në hapësirë, kish ngulur buzët mbi ujet akull të burimit, duke dëgjuar ligjërimin e ëmbël të 'bilbilit. S'ishte shaka; ai i kish

falur shërbimit buzë kufirit dy nga vjetët e tij më të bukur, kurse natyra kufitare, si një nënë e dashur, e kish mëkuar pa kursim me guximin, qëndrueshmërinë, vendosmërinë për të kaluar çdo vështirësi e për të arritur fitoren. Dhe tekxa e treste vështrimiu përpara, i kujtohej biseda me prindërit atë ditë që do të nisej ushtar:

«Ki mëndjen, biro, — i pat thënë i jati plak, duke e vështruar me dashuri — Nga familja jonë ti je i parti që shkon në kufi. Ky ëshuë nder për të gjithë ne. . . Atje hasmin e ke në prag.» Bardhyli rallë e kishte ndjerrë veten aq krenar. «Dy duar për një kokë janë, baba! — i qe përgjigjur, si t'i kish fjalët në majë të gjuhës. Atë çast qe hedhur vëllai i madh, i cili porsa qe kthyer nga ushtria: «Në kufi dy duart nuk janë për një kokë. Ti shkon atje të mbrosh gjithë këtë truall, të mbrosh familjen, popullin, atdheun. . . Pra, dy duar për të gjithë ne. . .»

Ai qe habitur nga këto fjalë. Edhe tanë i dukej sikur dëgjonte zërin e tij. «Dy duar për të gjithë ne». Po bashkë me këtë zë dëgjoi edhe një zë rjetër të kumbueshëm e të fortë, që nuk vinte nga thellësia e viteve, po buronte diku aty afér tij:

— Alo. . . Po, ju kuptoj. . . Po marr masa menjëherë. . . Do t'ju njoftoj pa vonesë.

Ai e kuptoi menjëherë. Ishte komandanti i postës. Nga ato pak fjalë Bardhyli e ndieu se komandanti kish marrë situatën e re. Po nuk arriti ta tëhollte më gjatë së qëndronin punët. Dikush ju afrua në heshtje dhe i zuri sytë që prapa.

— Lëshomë, guak! Ti Mete je?

— Po. Të solla një letër.

— Bjere.

— Nuk ta jap. Mé se do të më qerasësh.

- Më një pëllëmbë.
- Do pëndohesh.
- Kush e dërgon?
- Gjeje vetël
- Kush?
- Gjejel

Bardhyli ja rrëmbeu letrën nga dora, grisi zarin me nxitim dhe nisi të lexonte. «I dashur Bardhol të pres çdo ditë, çdo orë. Ta dish sa më ka marrë malli. Kur të vish këtu, nuk do të lë më të largohesh. . . Baba, thotë se do ta bëjë dasmën në dhjetor. Mua më duket çudi. Nuk e di se si më vjen ashtu kur i dëgjoj.

Po ti? Shokët e uzinës më pyesin çdo ditë. Që tani flasin për një mbrëmje vallzimi që do të organizojnë «për trimin që kthehet nga kufiri». Kështu thonë duke qeshur. Ta dish sa më ngacmojnë. Unë u them: Mirë, mirë, talluni sa të vijë Bardhi, pa kini për të parë pastaj. T'i shohësh si qeshin. Çshokë të mirë që kel. . . Jo vetëm ti, po dhe unë krenohem me ta. . .»

- E lexovë? Tani shiko se ke edhe diçka tjetër?
- Fotografi?! — Bardhyli hapi përsëri zarin. «Vera, sa mirë bëre që e dërgovel»
- Qenka për t'i prerë kokën. Thëllëza mali. Më kishin thënë, por nuk e besoja.
- Ik ore mbushu, guak.

Që nga fotografia, Vera e shikonte buzagaz, sikur donte t'i thoshte: «Mos i folë ashtu! E ke shok.» Bardhyli tundi kokën dhe qeshi. Ju duk sikur e kisintety dhe kuvëndonte me të. Në çaste të tillë, kur ishin bashkë, atij i shkrepte gjithmonë ta bënte me inat Vëren. I pëlcante, sidomos, të vështronte ato rudhat e holla që formoheshin në ballin e saj të bardhë, të lëmuar. Dhe qeshte e qeshte me gjithë zémër, kot së koti. Ajo skuqej e tëra dhe i mbusheshin sytë me lot. Ai e ngac-

monte akoma, gjersa lotët e tejdukshëm rrëshqisnin mbi faqet e saj të ndezura zjarr. Atëhere pendohej që e kish ngacmuar aq shumë dhe i përshpëriste në vesh qindra fjalë. Ajo e harronte sakaq gjithshka dhe shpinte buzën në gaz. «Sa i keq që bëhenh nganjëherë! Çamatrok fare!»

2.

«Camarrok!»

Kështu e quante Vera nganjëherë. E, me këtë ajo sikur përpiqej ta zbuste ca karakterin e tij të vrullshëm. Nga natyra ai qe njeri i rrëmbyer dhe ditët e para u nxori shumë telashe shokëve. «Mos u rrëmbe — e këshillonin shokët. — Armiku atë do: të humbasim gjak-ftohtësinë dhe...» Bardhyli zotohej se do: të tregohej i matur, po prapë, kur ndodhej përballë ushtarëve të huaj, qëllonte që ta humbiste arësyen. Një herë, kur njëri nga ata pruri një vajzë gjysmë të xhveshur fare afër piramidës, Bardhyli nuk u përmbjat. Harroi se njësiti i tij kryente shërbim sekret në një drejtëm ku ishin vënë re lëvizje të dyshimta. U ngrit, rrëmbeu një gar të madh dhe gati ua lëshoi, po të mos ja kish mbajtur dorën shoku. Por ajo që kish për t'u bërë, u bë. Vendi i shërbimit sekret u zbulua. Komandantit ju desh të mendohej shumë për të ngritur laqe të rinj, ku shkelësit u mbërthyen si minjtë.

Pas kësaj ngjarje ai u bind plotësisht se punët nuk ishin ashtu siç qenë dukur në fillim. Shërbimi në kufi nuk kërkonte vetëm guxim, por mençuri, vullnet të hekurt dhe sidomos nerva të forta, vettpermbajtje. Kur e kuptoi mirë këtë, u mundua me të gjitha forcat të ishte i kujdeshëm dhe të bënte ashtu siç e kërkonin tregullat kufitare. Ai u stërvit të qëndronte me orë të

tëra në pozicion pa bërë asnië lëvizje, të vrojtonte për një kohë të gjatë një rrip të ngushtë toke, duke u përpjekur të dallonte edhe lëvizjen e ndryshimin më të vogël. Dhe dalëngadalë erdhë e u shtrua si ai lumi i vrullshëm malor kur zbutet në fushë. Shërbimi i përditshëm natyra e heshtur kufitare, lanë gjurmë të thella në gjithë qënien e tij. Ato e shkallmuani dalëngadalë e pa u kuptuar natyrën e tij të vrullshme, ashtu siç e gërryen shkëmbin një pikë u ëqë bie mbi të një kohë të gjatë. U bë njeri i aetë, i ngadalëshëm e i matur në cdo lëvizje. Aty edhe ecja e tij erdhë e u ndryshua. Hapat nuk i hidhte më me nxitim, si ta ndiqte kush nga pas, por ecje ngadalë-ngadalë. Edhe kur i takoi të shkonte në shtëpi me leje, nganjëherë harronte ku ndodhej. Ecje pa u ngutur, si t'i numëronte hapat dhe vështronë herë majtas e herë djathtas. I dukej sikur ishte me njësitin.

— Mjaft fiete, Bardho. Luaji këmbët, se na u bë vonë për kinema — i thoshnin shokët.
Ai sikur zgjohet nga gjumi dhe çapitej më shpejt.

3.

Ishte mbështetur përsëri tek muri, atje ku kish qënndruar disa çaste më parë. Në dorë mbarte zafirin. Duke përshkundur qepallat, i brodhi sytë midis treshtave të letrës. Eh Vera. Vera! Sa mirë i qindis letrat! Po nëna? Ç'bën vallë nëna? Përse nuk më shkrove edhe për të disa treshta?

Bardhyli vrapi me mendje pranë tyre, u fut në gjirin e ngrohtë të familjes, u harlis me shokët parqeve, lulishteve. Po kudo e ndoqi pas zëri i komandantit. Pa dale, ç'hotë vallë? Ai mbaiti vesh: «Njësiti i parë, me përgjegjës Alekon, do të bllokojë... Njësiti i dytë...»

në orën tē ketë zënë qafën e Mursisë. Ai shikoi orën. Si kishtë kaluar kështu koha? Vrapoi në fjetinë, mori automatikun, fishekët, kundragazin dhe u dha ~~at~~ zyrë.

Shoku komandant, kufitar.

Mirë, Bardhyl. Erdhe në kohë. Sot do tē shkosh tek piramida nëntëdhjetë e gjashtë.

Bardhyli dëgjonte me vëmëndje dhe përpiqej ta ngulitte çdo fjalë në tru. Pastaj doli nga zyra dhe nisi tē ekte drejt kufirit. Një pjesë tē rrugës do ta bënte me shokët. Ai kish zënë vend i fundit në rresht di-a hapa pas tē tjerëve. Ekte ledhit dhe thithje me gjitë e mu-shkëtitë ajrin që kundërmonte erë lu'e-mali.

Gjer tek buronjat eci me shokët, pastaj ata dredhu-an djathtas, kurse ai vazhdoi rrugën këmbësore që zbriste poshtë, tek lëndina me bar tē pashkelur që ndehet si një qilim i butë dhe mbulonte centimetrat e fundit tē tokës sonë. Në cep tē këtij «qilimi» ngrihej e bardhë piramida, në njérën anë tē së cilës ishte vizatuar stemë e republikës, ndërsa në tjetrën një kurorë mbreti. Në asnjë vend emblëmat e tē dy shteteve nuk qëndronin aq pranë e, në tē njëjtën kohë, aq larg njëratjetrës.

Bardhyli çapitej ngadalë, duke vështruar me vëmëndje çdo gjë që e rrethonte. Në atë vend ai e kishte vizatuar në kujtesë çdo gur e dru, çdo fije bari. Sa herë kish rrëshqitur praqë piramidës ditëve dhe netëve kufitare, tē mbartsura me alarme. Sa herë kish qëndruar atje me sytë katër e veshët pizgë, ndërsa automatiku i ngrihej e i ulëj me ritmin e rrahjes së zemrës. Gjithnjë i dukej se qëndronte pranë diçkaje tē afërt e tē dashur, me tē cilën nuk qe çmallur e nuk do tē çmiallej kurrë. Dhe e ndjente se kjo «diçka» nuk ishte vetëm piramida me stemën e rrëthuar nga kallinjtë.

as ai qilim i blertë, as ai tripl toke ku kish vënë këmbët, apo ndërtesa e postës atje lart, por të gjitha këto të marra së bashku, i gjithë ai vend që i kish vënë në gjoks automatikun dhe e kish nxjerrë në roje. Kur ndodhet atje Bardhyli përdiqej të harronte gjithëkë dhe të jetonte i téri në atë botë të madhe e të pasund, ku ja trazonin gjoksin sq shumë mendime! Dhe përcudi, kur rrinte atje, qoftë edhe fillikat, ai nuk e ndjekte ashnjëherë vetminë; po i dukej sikur zbrisnin lehtë lehtë nga kodra dhe uleshin aty, mbi qilimin e bûtë — atje ku nuk guxonte, kush të shkelte — Vera dhe nëna e tij, dy njerëzit që donte më shumë në këtë botë. Ato uleshin ngadalë, të ndrojtura e të përmalura. Ai u buzëqeshte u kthente krahët dhe përpinqej t'i harronte, po sytë e nënës, sytë e Verës, i shfaqeshin kudo, tek çdo ledh e borigë. Mbase për këtë i dukej se nuk kishte dy, por katër, gjashtë sy, të cilëve nuk mund t'u shpëtonë as lëvizja më e vogël.

Rrëshqiti buzë lëndinës dhe ju astra piramidës. Vështrimin e ndali mbi shkabën dykrenare. Ju bë se atje diçka lëvizi, si të ishte e gjallë shqiponja. Vuri buzën në gaz dhe mërmëriti «Mirëmëngjez!» Pastaj mbajti vesh. Ndjeu një zë të thellë, që i kujtoi edhe cicërimën e zogjive, edhe fëshfërimën e pyllit, edhe zërin e tokës: «Mirëmëngjez!» Po shpejt e kuptoi se kjo nuk ishte vëçse një pandehmë dhe se ai kish përvendetur në të vërtetë njerëzit e tij të dashur, Verën, nënën. E përsëri buzëqeshi. U buzëqeshi atyre, lëndinës, shqiponjës, vijës kufitare.

E ndërsa zuri vend pranë piramidës, ju duk se pas krahëve, në lëndinë, u ulën përsëri ato, nëna me Verën. Pa u kthyer, me sytë nga vija e kufirit, ai e rrëshqiti vështrimin mbi treshtat e letrës që kish marrë pak më parë e nisi të zgjidhte me mend fjalët e përgjigjes,

I shkroi njëherë, po nuk u kënaq, i prishi dhe prapi shkroi. As vetë s'e kuptoi sa zgjati kështu. Befas rreشتat e letrës u zhdukën dhe ai e ndali vështrimin mbi disa njerëz të armatosur, ushtarakë e civilë, që ecnin në anën tjetër të kufirit, drejt tij. Në një çast ju duk sikur ecnin mbi kujtimet e tij, mbi letrën, mbi fotografinë dhe çdo gjë ju turbullua. Mos i bënë sytë? Mos i shdhë kjo një pandehimë? Ai uli qepallat dhe prap i ngriti. Tani shikonte vetëm ata dhe piramidën, dëgjonte hapat e tyre të rendë që i afroheshin. Ata i hijnin këmbët zvarë, si të dehut. Ecnin, flisnjn me zë të lartë, pastaj ndaleshin, e tregonia me gisht, qeshnin dhe prap ecnin. Përpara çapitej një oficer i ri, i veshur mirë, me një vështrim të papërqëndruar e sytë e përskuqur gjak. Në një çast ata ja morën këngës. Atë këngë e kish dëgjuar edhe herë të tjera, madje edhe atë mëngjes që u kujtua se atë ditë shteti fqi kishte një festë, se ata, si zakonisht, do të kishin pirë gjer ndaj të gdhirë dhe tani ku ta dish se ç'u kish shkrepur. Ecën edhe disa hapa, pastaj ndalën. Njëri i qëndroi përballë, fare afër. E vështroi ngultas. Kishte dy sy të mëdhenj e të shplarë, si sy kau, që dukeshin sikur qenë mbushur me urrejtje, mëri, ligësi. Bardhyli shtrëngoi fort automatikun. Kurrë nuk kishte ndeshur në një vështrim të tillë.

— Ej ti, paloarvanitis, zhduku andej! — shfryu një nënnoficer me hundën e skuqur e të mafatur, si një copë eshkë e hedhur pakujdes në fytyrën e tij vrarëslike. Bardhyli e shikoi me cep të syrit, po nuk lëvizi as qepallën. Kjo, siç duket ua ndezi edhe më shumë inatin atyre. Ishin gjithseit shtatë veta. Në mes kishin oficerin e ri. Qëndroni katër-pesë metro përhallë tij. Ais'i kish parë kurrë nga një afërsi e tillë ushtarët e huaj. E ndjeu se ju mbush trupi me mornica, po përsëri

nuk luajti as qepallat. Ata u tērbuan nga gjakftohtësia e tij dhe nisën tē shanin pa i lënë radhën njëri-tjetrit, kurse ai që ishte i veshur civil, përpiquej t'i përkthente fjalët e tyre me një shqipe tē çalë e gjysmake.

«Si kuxosh ti ta vështron toka e elladhas me ata si tē fëlliqr? Ik atje!»

«Ti tē flet, komunisti i tlik. Merre këmba në qafa dhe marsh.»

«Këputa qafa, dëgjon? Apo nuku dhemb koka de rri. . .?»

Bardhyli dëgjonte në heshtje. Përpiquej tē mos e jep-te veten, tē shtircj i shkujdesur, si tē mos kish asnjeri pranë. Në tē vërtetë, përderisa ishte në tokën e tij dhe ata në tē tyren, ai as që duhej tē merakosej se ç'bënin e thoshnin. Le tē dërdëllisinin ç'të donin. Mjaftonte që tē mos hidhnin hap këtej. Duke menduar kështu, ai u përhoq tē merrte me mend se çdo tē ngjiste sikur ta kapërcenin atë vijë që ndante kufijtë në mes tē dy shteteve. Ai e përfytyroi atë vijë si një hendek tē the llë, tē cilin ata nuk do tē mund ta kapërcenin. Edhe sikur tē përpinqeshin ta bënin këtë, do tē thyenin kokë në humnerë. Sakaq, oficeri u shkëput nga tē tjetët, hodhi një hap, dy, zgjati dorën dhe u mbështet në anën tjetër tē piramidës. Në një çast ju bë sikur një re e madhe, e zezë, ju afrua diellit dhe çdo gjë u errësua. E kuptoi se i huaji kishte arritur atë c'k, tē cilin nuk mund ta kapërcente. Gishti i tij preku lehtë këmbëzën e shkrepjes së automatikut. Oficeri e vuri re këtë dhe têrroqi në çast dorën nga piramida, si tē kish preku zjarrin, ndërsa tē tjerët vazhdonin tē hakërroheshin:

— Ti nuk ika? Dale pa tē mëson un tē bindet.

Dhe njeriu me hundën si eshkë u lëshua si qeni i lëdhur me zinxhir drejt piramidës. Po zinxhiri qe i shkur têr dhe ai shfrynte, shante, turfullonte si një kafshë, i pasuar nga tē tjerët:

— Dëgjoj, apo jo. Komunisti i qelbur.

— Ik andej maskaraj.

Flisnin tē gjithë nē një gojë. Bardhyli e ndjeu se ata e kishin humbur kontrollin e vetes. Njëri madje shkopsiti këllëfin, nxori që andej një nagandë tē bardhë, tē shndritshëm, e ja drejtoi.

— Të shikoj tanë si këputa qafa. Ha-ha ha.

Bardhyli hodhi vështrimin mbi trashaluqin. Ai kish mbyllur njërin sy dhe tërhiqte neadalë këmbëzën. Edhe gishti i tij takoi këmbëzën e shkrepjes. «Kujdes! Mos u nxitol! Nuk duhet tē qëllosh ti i paril!» Dhe vështroi me cep tē syrit grykën e pistoletës, që dridhej nē dorën e tē huajit. Ajo qe drejtuar mbi gjoksin e tij. Ju duk çuditërisht e gja'ë dhe kanosëse, si një grykë topi që mund tē shpërthente me një gjëmim tē tmerrshëm. Edhe pak, edhe një çast dhe ai. . U mundua tē shikonte di-ku lart, por gryka e pistoletës, si n'i rrëth i madh, i zjarrtë, ju c'f'q edhe nē hapësirë. «Të vrasin këta maskarenj.» Njeriu me pistoletë hodhi edhe një hap. Arritit cakun. Atë cak që nuk duhej ta prekte.

— Ndali! Kjo është tokë e Republikës Popullore tē Shqipërisë!

Ky zë shkrepri si një vetëtimë. Edhe ai u habit. Ju duk sikur doli nga gjoksi i tokës, i shkëmbit. Ata u drodhën. U st-pën. Po nuk lëvizën. Dora me pistoletën shënonte mbi gjoksin e tij. Po për çudi tanë ajo nuk ju duk aq e madhe dhe e tmerrshme, si pak më parë. Madje nuk i la-atë përshtypje. Si tē mos qe drejtuar mbi tē. Edhe zërat e tyre e humbën atë forcën e parë e u bënë më tē dobët. Ai e ndjeu se e kish këluar atë çast, tē cilin njeriu e jeton ndofta vetëm një herë nē jetë, kur çdo gjë tē duket nē përmasa tē zhdrejta dhe kur ti nuk i përket më vetes tënde.

«Bardho. . .»

Ky zë i butë, i njojur, i dashur i erdhi tamam atëhere kur duhej, kur ai e priste. Ju duk se doli nga ländina, pas krahëve të tij. Bardhyli e ndjeu se nuk ishte vetëm. Se po të kthehej do të shihte atie nënën, Verën. Dhe jo vetëm ato. Po nuk lojti as qepallat. Dhe përsëri sikur dëgjoi nië zë të njojur: «Dy duar pér të gjithë ne.» Dhe një tjetër: «Të pres çdo ditë, çdo orë... Ta dish sa na ka marë malli...»

Pastaj çdo gjë u topit. Ai puliti sytë. U përpoq të dëgjonte prapë zërat. Po nuk mundi. U përpoq të shihte ata që ishin afruar pak më parë. Të shihte dorën që zgjatej drejt gjoksit të tij bashkë me pistoletën e shndritëshme, kërcënonjëse. Po edhe ajo qe zhdukur.

Ku shkuan? Kush i trembi? Sytë e tij të zjarrtë, apo zërati që dolën nga lëndina?

— Dëgjoj, apo jo. Komunisti i qelbur.

— Ik andej maskaraj.

Flisnin tē gjithë nē një gojë. Bardhyli e ndjeu se ata e kishin humbur kontrollin e vetes. Njëri madje shkop-siti këllëfin, nxori që andej një nagandë tē bardhë, tē shndritshëm, e ja drejtoi.

— Tati shikoj tani si këputa qafa. Ha-ha ha . . .

Bardhyli hodhi vështrimin mbi trashaluqin. Ai kish mbyllur njërin sy dhe tërhiqte neadalë këmbëzën. Edhe gishti i tij takoi këmbëzën e shkrepjes. «Kujdes! Mos u nxitol! Nuk duhet tē qëllosh ti i paril!» Dhe vështroi me cep tē syrit grykën e pistoletës, që dridhej nē dorën e tē huajit. Ajo qe drejtar mbi gjoksin e tij. Ju duk quditënshit e gjatë dhe kanosëse, si një grykë topi që mund tē shpërtihente me një gjëmim tē tmerrshëm. Edhe pak, edhe një çast dhe ai. . . U mundua tē shikonte di-ku lart, por gryka e pistoletës, si n'ë rrëth i madh, i zjarritë, ju cfrq edhe nē hapësirë. «Të vrashin këta mas-karenj.» Njeriu me pistoletë hodhi edhe një hap. Arriti cakun. Atë cak që nuk duhej ta prekte.

— Ndal! Kjo është tokë e Republikës Popullore tē Shqipërisë!

Ky zë shkrepri si një vetëtimë. Edhe ai u habit. Ju duk sikur doli nga gjoksi i tokës, i shkëmbit. Ata u drodhën. U stepën. Po nuk lëvizën. Dora me pistole-tën shënonë mbi gjoksin e tij. Po për çudi tani ajo nuk ju duk aq e madhe dhe e tmerrshme, si pak më parë. Madje nuk i laatë përshtypje. Si tē mos qe drejtar mbi tē. Edhe zërat e tyre e humbën atë forcën e parë e u bënë më tē dobët. Ai e ndjeu se e kish ka-luar atë çast, tē cilin njeriu e jeton ndofta vetëm një herë nē jetë, kur çdo gjë tē duket nē përmasa tē zhdrojta dhe kur ti nuk i përket më vetes tënde.

«Bardho. . .!»

Ky zë i butë, i njojur, i dashur i erdhi tamam atëhere kur duhej, kur ai e priste. Ju duk se doli nga lëndina, pas krahëve të tij. Bardhyli e ndjeu se nuk ishte vetëm. Se po të kthehej do të shihte atie nënën, Verën. Dhe jo vetëm ato. Po nuk lojti as qepallat. Dhe përsëri sikur dëgjoi një zë të njojur: «Dy duar pér të gjithë ne.» Dhe një tjetër: «Të pres çdo ditë, çdo orë... Ta dish sa na ka marë malli...»

Pastaj çdo gjë u topit. Ai puliti sytë. U përpoq të dëgjonte prapë zërat. Po nuk mundi. U përpoq të shihte ata që ishin aftuar pak më parë. Të shihte dorën që zgjatej drejt gjoksit të tij bashkë me pistoletën e shndritëshme, kërcënënjëse. Po edhe ajo qe zhdukur.

Ku shkuan? Kush i trembi? Sytë e tij të zjarrtë, apo zërat që dolën nga lëndina?

Shi i ibroj shli i është em basin jndra o është
shiq lep janis zvici gjithashtu i lirillit ose zërat
shndritëshme që i përfundojnë kohën e njohjeve personale si fsh.
nëpunim i përfunduar kohës së përfundimit të fsh.
shndritëshme që i përfundojnë kohën e njohjeve personale
shiq i qëndra illogjik. Këtu e bëja që jo i vlefshëm apo
i përdor qëllin që i përfundojnë kohën e njohjeve personale. Këtu
është i vlefshëm që i përfundojnë kohën e njohjeve personale.

NE DHE GRAMOZI

... Ja, kështu. Dhe tani do të dish si dola partizan. E mirë. Po të tregoj, sado që atëhere unë as që i përfytyroja dot shtigjet e asaj rruge që nisa. Madje — që të jem i sinqertë as emrin «partizan» nuk e kisha dëgjuar. Do të tridhte edhe miaft ujë burimeve, gjersa ne t'i thoshnim vetes «partizanë».

Nuk e mbaj mend me saktësi në ishte fundi i dyzetës, apo fillimi i dyzetenjësë. Disa muaj më parë isha thirrur ushtar dhe vazhdoja të kryeja shërbimin në të ashtuquajturën «ushtri kombëtare» që organizuan fashistët italianë dhe përpinqeshin ta mbanin më këmbë me gjilpëra. Por qe punë e kotë. Populli, ashtu si deti, nuk mban asgjë të huaj në gjirin e tij dhe shpejt a vonë e flak tej.

Që në di-ët e para të shërbimit unë u ndodha në një rreth shokësh, të cilët do të luanin një rol aq të madh në jetën time, sa unë nuk e merrija dot me mend. Nga biseda të thjeshta, të parëndësishme, të rastit, në nisëm të flisnim për të huajin që na ishte ulur kular në vatër. Për çdo gjë gurin e parë e hidhte një shokу ynë. E quanin Gramoz. Unë për herë të parë dëgioja që nië njeri të kishte emrin e një malit. Në fillim kjo m'u duk pak e çuditshme, por sa më shumë që e njihja, aq më tepër më dukej se atij i përshtatej

shumë mirë ky emër. Dukej sikur mali plak i jugut, veç emrit, i kishte dhënë edhe diçka tjetër që e bënte bijerëndë, të patundur e mospërfillës karshi shtërngratave. Edhe tani sikur e kam parasysh. Ai ishte nga ata njerëz që nuk harrohen për tërë jetën. Na linte gjithnjë gojëhapur me mendimet e guximshme dhe fantazinë e ndezur që na çonte diku larg, në një botë të re, të panjohur. Mbi të gjitha, i përqente të na fliste me zjarr për stuhinë që do të shpërtonte dhe për qielin e përflikur që do të shpaloset një ditë mbi vendin tonë.

Gramozi diti t'i shtonte radhët 'ona me shokë të guximshëm që nuk ua bënte syri tërt. Dalëngadalë aktivi ynë u bë aq i fuqishëm, sa i tronditi keq fahistët. Çdo ditë ngjiste diçka e papritur. Kulmi arriti me «aktionin e parullave» siç e bëmë zakon ta quanim më vonë. Këtë aksion e propozoi dhe e udhëhoqi shokunë, Gramozi.

Ja si ngjau:

Fashistëve u kish ndeshur sharra në gozhdë në frontin italo-grek. Ata hanin çdo ditë grushte të rendë, kishin filluar të tërhiqeshin dhe dreqi e dinte ku do ta mbanin vrarin. Mussolini nuk la gur pa lojtur për të na hedhur edhe ne në këtë kasaphanë. Me një gur ai donte të vriste dy zogj: të sigur nte krahët dhe të dërgonte në front forca të reja e të freskëta.

I erdhë pra radha edhe batalionit tonë ta thoshte fialën e tij. Fashistët menduan t'i jepnin një notë sa më solemne nisjes sonë dhe të organizonin një miting të të bujshëm. Në kazerma u hap fjalë se të nesërmen do të vinte për të na përshëndetur një oficer i lartë fashist me gradën e kolonelit.

Komandantët tanë vendosën ta prisnin atë me nderime të mëdha, siç ja donte sëra e grada. Ishin të gjithë si në ethe. Erdhën në repart pa zbardhur mirë dita, që

t'u jepnin rrugë pregetitjeve. Mirpo kur agoi, reksen nga habija. Nëpër faqet e kapanoneve, rrëth sheshit k'u do të bëhej mitingu, qe shkruar me gërma të mëdha: «Poshtë fashizmi!» «Rroftë Atdheu ynë, Shqipëria!» «Asnjë ushtar në frontin italo-grek!» «Dora e tmerrshme e shkruesit të parullave, me një gjakftohtësi të çuditshme që të kallte datën, qe zgjatur gjer te bunkeri prej betonarmeje i postbllokut. Pikërisht prapë krahëve të rojes aio kishte vizatuar një shkabë dykrenëshe e mbi të kish shkruar: «Rroftë lirial! Shkaba dukej sikur nga çasti në çast do të shkëputej nga bunkeri e do të merrte me vete gërmat e parullës dhe do t'i ngjiste ato lart, mbi kryet e njerëzve, që t'i lexonin të gjithë.

Ded Bajraktari, komandanti i batalionit, u bë si i çmëndur e s'dinte si ta shfrynte inatin. Ai ishte një oficer i gjatë e i dobët, në merrte zjarr për h'çgjë dhe s'mbante mend ç'fliste. Sillej nëpër fushë si kali në lëmë dhe thërriste duke nxjerrë shkumë nga goja:

— Ani, maskarenj! Të poshtë! Ani, do t'u shkoj të gjithëve në litar. Do t'u shkërdhej nënët, motrat, grata e nuk do të le kusur. Do t'u...

— Zoti kapiten, po shkon ora — guxoi t'i thoshte zëvëndësi i tij — Çdo të bëjmë?

— Ani, do të bajmë, pos! Të mblidhen shpejt të gjithe, pa ja u diftoj unë, ani, si shahet fashizmi.

Dhe na mblohdhën në fushën ku do të bëhej mitingu e zunë të na kërcënoin se, po të mos tregonim sajtotët, do të merrnin masat më të rrepta. Por nuk nxorën asojë në kut. Ushtarët vështronin njëri-tjetrin të habitur dhe ngrinin, supet. Shumë nga ata, edhe pse s'kishin dorë në këtë punë, nuk e fshehnin dot kënaqësinë dhe admirimin për ata që i kishin shkruar parullat dhe i pëshpërisnin njëri-tjetrit: «Di gjë kush i shkroi?» «Jol! He m'u lumtë dora! Sa mirë u shkoi në mend. Po sh-

ko, në qoftë se di gjë, mos hap gojë, se të piu e zeza!» Dica mezi e mbanin të qeshurin dhe s'tynin shokushokun me bërryla. Kurse Gramozi qëndronte i qetë e hijerëndë, si një mal, Dukej sikur ai nuk e bënte fare qejfin qeder për ato që kishin ndodhur ose mund të ndodhnin rrreth tij. Kurse komandanti i batalionit vetëm thërriste dhe godiste pa pushim me kamxhik çizmet e ilustruara, si ta kishin ato të gjithë fajin:

— Ani, të poshtë! Do t'u vrás të gjithëve. Të gjithëve...

Zëvëndësi ju afrua përsëri dhe, duke u dredhur, i tha:

— Zoti komandant! Po shkon koha.

Ai u kthyte dhe e shfryu mbi te të gjithë inatin:

— Ani, ti hesht. . . ! H sh. . . ! M r v s' ? H sht!

Dhe ke për të pa, ani, se ç'do t'u punoj...

— Mirë zoti komandant, por mos harro se për dy orë do të vijë koloneli dhe vaj hallit po të na gjejë kësh-tu. S'ka ku vete një turp i tillë.

— Posi, turp asht për këta maskarenj. Ani, turp dhe për ju. Për, të gjithë.

— Duhet bërë diçka.

— Posi, ani, duhet ba. Duhen gjet fajtorët.

Officerët u mbledhën kokë më kokë. Sez flisnin dhe vështronin vazhdimishit nga ne. Kurse kapiteni shante dhe godiste gjithnjë çizmen me kamxhik Ndërkao se kush tha se rebelat mund të zbu'ohen vetëm nga shkrimi. Ky propozim u duk me vend dhe u dha menjëherë urdhëri që të mbusheshin disa kova me bojë të zë-zë dhe të shkrwanim të cithë me radhë. ^ që e morën me mend fundin e kësaj loje «shpikjeje». Pas disa minutash në mur u radhitën aq shumë gërmë e parulla; sa fashistët u çmëndën nga inati dhe e humbën më keq toruan. Kapiteni dridhej si në ethe. Të tjerët e ndiqnin pas, të mbledhur si breshka nën samar.

Një orë më vonë do të vinte koloneli. Tani asnje-
ciu nuk i shkonte ndërmend për shkruesin e parulla-
ve. Duhej gjetur një ilaç për të prishur gjithë ato gér-
ma e fjalë që shtriheshin e shtriheshin mbi faqet e
ndërtesave.

- Ani, të lyhen muret me gëlqerel - dha urdhër ka-
piteni.

Po koha vravonte me revan. Si e panë ngushtë, mbi
parulla nisën të hiqnin vija të gjata, ku të bardha e ku
sur fashoje, që nuk e mbulonin dot plagë e gjakosur.
Mbi shërbetin akoma të pa tharë mirë të gëlqeres, si ba-
ri kur mbin nga dheu, buisnin njëra pas tjetrës gërt-
mat e parullave... Në këtë e sipër ja behu koloneli,
një mesoburrë, që e ngriti me përtesë dorën për të nde-
ruar dhe e dëgjoi raportimin pa zbritur mirë nga ma-
sikur nuk doli nga vetura, por nga një maqinë heku-
pin e tij llamburiste nga një shkëlqim verbonjës. Në
njërin cep të buzës i kishte ngritë një buzëqëshje e shti-
tur, të cilën ishte gati t'ua dhuronte me bujari të gjithëve.
Në fillim shpërndau nëpër fushë një vështrim
të ftohtë e indiferent. Pastaj rrudhi vetullat, por buzë-
qeshja nuk ju zhduk nga cepi i buzës. Dukej sheshit
që nuk e kënaqi pritja, madje u habit nga ajo ndjenja
ogurimi e pasigurie që vuri re në fytyrat e atyre që
trethonin. E kuptoi se kishte ngjarë diçka e pakë-
dshme, po nuk arrinte ta marrte me mend se ç'farë.

- Che cosa succede...? C'po ngjet kështru? — përsë-
tiste, pas çdo hapi; që hidhite, dhe vështron e me habi
ordinancën, si të priste nga ai një mendim se ç'duhej
të bënte: të vazhdonte sipas programit, apo... Më në
fund ju drejtua si me dy mendje tribunës prej dërra-

sash tē veshur me beze tē kaltēr, dhe u hodhi një sy
treshtave tē ushtarëve që qëndronin si tē ngurosur pa-
ra tij. Në ftyrat e tyre nuk dalloj as shenjën më tē
vogël tē emocionit e tē entusiazmit. Disa vështrime
ju dukën madje tē ftohtë e përbuzësh. Ai u kollit dhe
fshiu d'ersët me shami.

— Cosa avviene così? Ç'është kështu? — mërmëriti në-
për buzë duke shikuar ordinancin, si tē druante mos
e dëgjonin tē tjerët. Kapi eni tundte kokën e mblidhët
supet i hutuar dhe seç fliste me zë tē ulët, ndërsa or-
dinanca hapi çantën dhe i zgjati disa tabakë letër. Ai
i mori dhe nisi tē lexonte.

— Ushtarë! Pasardhës tē lavdishëm tē Pirros së Epit-
rit. Stërnipër tē Skënderbeut! Benitto Mussolini ka thë-
në: «Albania è nel mio cuore» — Si i tha këto fjaçë, u
kollit disa herë dhe ngriti vështrimin pér tē parë se
ç'pershtypje kishin lënë te ushtarët. Pér çudi, ai vuri
re përsëri po atë ftohtësi, si në fillim kur zbriti nga
maqina. Pér herë tē parë gjatë atyre minutave ai men-
doi se nuk ishte aq e thjeshtë dhe zbavitëse detyra që
i kishin ngarkuar cprorët. Pér më tepër ai nisi tē men-
donte se ishte fare pa kuptim tē mbështesje shpresat
te ata njerëz tē pagdhendur, me vështrime tē akullta,
që qëndronin para tij dhe nuk e çanin fare kokën për
ato fraza, tē cilat i kishte renditur me aqë kujdes gjatë
mbrëmjes së kaluar. Megjithatë, ai vazhdoi tē lexonte
pa u ngutur, duke u përpjekur ta vinte sa më mirë
në dukje rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga ushtritë
rebele e tē pafuqishme greke, që vetëm hë pér hë, du-
ke përfituar nga dimri dhe koha e keqe, kishin patur
disa suksese fare tē parëndësishme e tē përkohshme.

Si ushtarak i vjetër që ishte, atij i kishte takuar di-
sa herë tē mbante fjalime tē zjarrita para nisjes së ush-
tarëve në front. Kështu kishte bërë sa herë që sovrani

kishte ndjerë nevojën e bajonetave, për të vendosur qetësinë në perandori e për të zgjeruar kufijtë e saj në Afrikë e në Evropë. Dhe gjithnjë i qe dukur se fjalët e tij kishin prekur zemrat e ushtarëve. Gjer pik më parë ai ishte i bindur se kështu do të njësiste edhe atje, ndaj ju duk fare e pazakontë ajo ndjenjë ftohtësie, pasigurie e frikë që sundonte te ushtarët. Në një çast mendoi se mos kjo vinte nga që ai nuk kish ditur të zgjidhje fjalët më të përshtatshme, apo nga që nuk e kish lexuar siç e donte rasti përvendetjen e tij. Duke dashur të ndreqte këtë gabim e ngriti ca zërin dhe, për t'i emocionuar sa të ishte e mundur më shumë dëgjuesit, theksoi se në ato caste që ai fliste, jo shumë larg prej andej, në kufijtë e perandorisë vazhdonte të derdhej lumë gjaku i bijve të lavdishëm për të mbrojtur nderin e kësaj toke, të marrë me përbuzje nëpër këmbë.

— Në këto ditë të shënuara, Viktor Emanueli III, mbret e perandor...

— Viva il rel — thirri njëri nga oficerët që qëndronin në tribunë dhe përplasi fort shuplakët.

— Viva, viva! — përsëritën ka-ër-pesë të tjera. Koloneli u përpoq të shpinte buzën në gaz, kurse ushtarët qëndruan po aq të heshtur e indiferentë dhe lanë të dëgjohej qartë një kërcitje e lehtë dërrasash në tribunë.

— Viktor Emanueli i III — vazhdoi koloneli pas një ndërprerje të shkurtër — në emër të zojtit e të kombit, ju bën thirrje që të rradhiteni përkrah vëllezërve tuaj, ushtarëve italianë, në...

Po nuk e shpuri fjalën gjer në fund. Dërrasat nxorën

përsëri një gërvime të zgjatur dhe koloneli i vështroi me dyshim ata që e rrrethonin:

— në kufijtë e shenjtë të perandorisë sonë të...

Dërrasat kërcitën përsëri, si të donin t'u jepnin një paralajmërim tjetër atyre që qëndronin mbi të. Kapiten Deda parandjeu diçka të pakëndshme dhe shtrëngoi fort dhëmbët. Koloneli i hodhi një vështrim të rrëptë. Dy-tre veta, bashkë me ndihmësin e kapitenit, e panë të udhës të zbrisnin nga tribuna. Koloneii vazhdoi të fliste, herë duke e ulur, herë duke e ngritur zëcin, i bindur se edhe në ato rrethana të vështira po i bënte një shërbim të çmuar sovranit. Reshtat e ushtarëve filluan të lëkunden dhe ai e kuptoi se shumë pak veta e kishin mendjen tek ato që thoshte. Vetëm kur mbaroi së lexuari dhei duke mos dashur të shikonte sërisht sytyrat e ushtarëve, e hodhi vështrimin mbi muret rrëth e rrötull. Kapiten Deda e vuri re këtë dhe ju afroa me të shpejtë e nisi t'i fliste me një italishtë të ç'aë.

— Skuzate, sinjor kolonele. Na falni, Ani, janë disa ushtarë rebela që u përpinqën të na sillnin të papritura, por...

Koloneli i hodhi një vështrim kuptimplotë, si të donne të thoshte: «Mos kërkoni të falur para kohe, kapiten. Do ma paguani shtrenjt këtë!» — dhe hipi në veturë e i bëri shenjë shoferit të nisej. Marshet kërcitën. Mbi rrugën u ngrit një perde tymi që mbeti pezull mbi fushë. Kapiteni vështroi edhe disa çaste andej nga zhduk vetura, pastaj nisi të thërriste e të fshikullonte si i çmendur kamzhikun në ajër, duke i urdhëruar var-tësit që t'i arrestonin në çast të gjithë njerëzit e dyshimtë.

- Ani, ju jini tē gjithë tē poshtër. Tradhëtarë. Ani, tē ngrihen mitralozët këtu. Shpejt. Ani, do t'ju vras. Tē gjithëve do t'ju vras. Kini gjysëm ore afat. Po s'mi prutë këtu ata maskarenjtë, ani, me dorën time do t'ju vras. Maskarenj. Ani shpërndahuni...

Dhe vazhdoi të çirrej e të kërcënonte nëpër fushë. Po kur ushtarët u mblohdhën, pasi u dha disa herë sijali, ai gadi sa s'u çmend nga inati. Nga çdo kompani mungonin trë-katër ushtarë. Në mes tyre edhe unë me Gramozin. Që nga ajo ditë, ne rrëmbyem armët dhe dolëm malit. Po do të kalonte akoma shumë kohë, gjërsa ne të vinim në ballë yllin me pesë ccpa.

RAKETA NË DET

Sa nxori trupin nga dera e mori të shkonte në racë, ju duk sikur e preku me dorë tufanin. Era, e përzier me pika të mëdha shiu, i përplasi në fytyrë të zemërimin e saj. U mbërthyte fort pas hekurave të sigurimit dhe ju kujtua se pikërisht atje, disa vjet më parë, rojen e kishte rrëmbyer era dhe e kish flakur tutje, në saqe të malit. Kur ja treguan këtë, ai nuk qe në gjëndje të thoshte në kishte ngjarë vërtet ashtu, apo paraardhësit e tij e kishin sajuar një legjendë të tillë, për të treguar sa i ashpër qe dimri në vend. Sidoqoftë, për një gjë qe i sigurtë: po të mos ishte mbajtur fort, tani nuk do të ndodhej atje, po diku poshtë.

«Ç'dimër!» — mërmëriti dhe e hodhi vështrimin në humnerën cë zbriste thuaje thikë nën themelet e ndërtesës. Ai kishte ardhur në pikën sinjalo-vrojtuese dhjetë muaj më parë, në një ditë prilli që shkëlqente nën trezët e diellit. Duke ju nejitur cafës së malit, kamioni ngulçonte e dridhej, po atij i dukej sikur ky udhëtim kish zgjatur vetëm disa minuta. Për një kohë i ngjau se udhëtonte në një tunel të gjelbër. Lart, në sfondin e kaltët të qellit, vizatoheshin kupolat e gjelbëra të pi-shave, si t'i kishte piktuar dora e një mjeshtri të madh. Nën to dridhej rruga automobilistike, si një shall i murmë i hedhur në qafën e malit. Po ta kishte natën rrugën gjer atje, do të thoshte me bindje të plotë se

ndodhej në alpet e veriut, por kur kapérceu majën e parasysh i doli deti i pastër si loti, mbeti gojëhapur. Në një çast ju duk se po shihte një film të bukur nje ngjyra, ku kuadri qe ndërruar papritur dhe natyra epike e bjeshkëve të veriut ja kishte lënë vendin lirizmit të jugut.

Kur arriti në pikë, po binte mbëmja. Hëna nxori si me turp kryet pas shpatullave të malit dhe u buzëqesdi detarve. «Sa bukurl!» foli ngadalë. Shoku që kishte në krah ja ktheu në çast: «Po të pëlqen kaq shumë, bëj një lutje që të ta zgjatin shërbimin, ose qëndro nënoficer i karrierës.» Po ai as që i dëgjoi ato fjalë. Vështronte i hutuar herë detin që dremiste si një gjigand i përgjumur, herë kurorat e pishave dhe hënën e artë. «Çudil — mendoi — Po të më thoshte njeri, nuk do të besoja se ka një bukuri të tillë».

Kurse tani që kishte da është përfshirë e vrojtimit, i dukej sikur tusani i kishte shtyrë aq larg ato ditë të ngrohta e të qeta, sa nuk do të ktheshin më kurrë. Nga lart qelli e godiste me kamzhikë të zjarrtë vetëtimash atë majëmalit që kishte guxuar është tette kryet në gjoksin e tij të ngarkuar me re të zeza, të rënda plumb. Era shfrynte si e tërbuar. Detarit i dukej se po të vazhdonte ashtu, do ta shkulte nga themelet edhe vetë ndërtesen e pikës sinjalo-vrojtuese e do ta vërtitte në humnerë. Ai ngriti jakën e kapotës dhe, duke u mbajtur fort, u përpoq të vështronte poshtë, atje ku duhej të ishte deti. Përmes flokëve të murme të mjegullës që i shpupuritë era, ai dalloi disa si nofulla të bardha, të mëdha, me të cilat deti dukej sikur ngulmonte të bluan te bregun.

«Dimër or byrazer, jo shakal! dhe u përpoq përsëri të dallonte se ç'fshihte prapa saj perdja e murme e mjegullës. Befas sytë ja verboi një flakërimë e zjarrtë

që u shoqërua me një gjëmim shurdhonjës. Pika e vrojtimit u tund. Xhamet kërkëllinë. «Lele, sa afër goditi! Thashë se më qorr i, e mallkuara!»

Atë çast dikush e zuri nga supi. Ktheu kokën. Telua, radisti i pikës, diç i thoshte, po era ja merrte fjalët nga buzët dhe ai nuk arrinte të kuptonte asg.ë.

— Si është puna? — pyeti — Po as tjetri nuk e dëgjon-te. Ju afrua më pranë.

— Ka ngjarë gjë? — pyeti Telua.

— Nuk trembem, jo — ja ktheu vrojtuesi. Radisti qëshi.

— Ka ngjarë gjë, të pyeta?

— Aha...

Vrojtuesi mblođhi supet. Të dy shikonin përreth. Ash-tu, pranë e pranë, e ndjenin veten më të fortë. Kohë më kohë lart, mbi kryet e tyre ndizeshin e shuheshin fitilët e zjarrtë të vetë imave, si të përpinqeshin t'u jep-nin flakë reve të qullura.

— Shko poshtë ti, ç'taksirat tē rrish këtu — i tha vrojtuesi radistit. Telua bëri sikur nuk e kishte mençnati. Ai e dinte se sa mirë ishte në raste të tillë të kishe pranë një shok. Detarëve u dukej se ashtu, të futur në gjoksin e njëri-tjetrit, e mposhtnin më lehtë zemërimin e suferinës dhe e zbusnin frymëmarrjen e saj të akulltë.

— Shikon gjë ti? — pyeti pas pak vrojtuesi, i cili e kishte ngulur vështrimin diku, në humnerën e murme.

— Jo.

— Mua më duket se dikush po hedh raketa.

Ata heshtën. Pritën një kohë.

— Ja, e shikon?

— Jo, të bëjnë sytë. Do të jetë vetëtimë.

— Nuk e besoj.

Të dy u përkulën mbi parmakët e hekurtë. Sakaq

atje poshtë u ngrit një si gjarpër i zjarrtë. Pastaj dy-tri tē tjerë. Shikuan më me kujdes. Kur u davarit ca mje-gulla, dalluan diçka tē zezë që aty dukej, aty humbiste, duke u përpjekur t'u shmangej nosullave tē bardha tē detit, tē cilat e ndiqnin pas si tē donin ta bluanin dhe ta gëlltitnin.

— Anije...!

— Po mbytet! — thirri radisti duke zbritur nga dy e nga tri shkallët e hekurta. Si tē kish dhënë njeri alarmin, detarët u mblodhën në çast.

— Ç'ka ngjarë?

— Një anije transporti është në rrezik. Kërkon ndihmë.

Një hop u bë heshtie. Fjalët e radistit sikur kishin mbetur pezull aty, midis tyre, dhe ata përpinqeshin tē troknin sa më mirë kuptimin e tyre. Si njerëz që kishin lundruar në kohë tē mirë e tē keqe, apo që kishin jetuar buzë detit, ata e kuptuan qartë se çdo tē thoshte tē ishe në rrezik e tē kërkoje ndilimë në një kohë tē tillë. E kuptuan se më e rëndësishme nga çdo gjë tjetër ishte tē veprohej më shpejt, pa humbur as minutën.

— Nëpër vende, shokë! — buçiti zëri i komandantit.
— Ti Telo përpiku tē hysh pa vonesë në lidhje. Kérko «Limanin» dhe tregoi si qëndron puna. Për një orë, shumë-shumë për një e gjysmë, gjuajtësi duhet tē jetë këtu. Ndërkëq ne...

Ai nuk arriti ta mbaronte fjalën. Drita e zjarrtë e vetëtimës u shoqërua nga një gjëmim trojtës. Ndërtesa u drodh, si tē ndjente edhe ajo frikën. Detarët u ngjeshën pranë njëri-tjetrit.

— Është me spec tē punosh sot me radio! — foli dikush nga detarët. — E di si i thith antena ngarkesat?

— Hesht mor til! — e qortuan dy-tre tē tjerë.

— Epo, duhet edhe një çikë spec — ndërhyri një i katërt.

— Pa të s'ka lezet gjella.

— Leni fjalët. Nëpër vendë! — ua vuri kapakun të gjithave zëri i komandantit. Detarët nderuan dhe morën sekush drejtimin e tij. Ai qëndroi edhe disa çaste atje për ta menduar më mirë se çfar duhej të bënte, pastaj u drejtua për në dhomën e radios. Telua kish vë në në vesh kufjet dhe përpinqej të hynte në lidhje. Kalluan disa minuta, po ai nuk orientohej dot në morinë e zhurmave që i si'lte tufani në veshë. Lëvizte dorezën sa majtas-d'athtas, shtrëngonte në vesh kufjet, mundohej të ndante me mendje çdo gjë që nuk i duhej e të dallonte zërin e shokut, po nuk ja delte dot në krye. Komandanti e kuatoi se kio punë do të zgjaste.

— Ti mos ju ndaj, Telo, gjersa të hysh në lidhje. Unë po ngjitem lart — dhe, duke dalë, ngriti jakën e kapotës. — Na bari shumë punë kjo kohë. Duhet shpëtë vrojtuesi në pikën rezervë,

Telua mbeti përsëri vetëm. Zuri të numëronte nga e para, të therriste abonentin. Po ai heshtte si një gur. Të paktën kështu i dukej Telos, se në kufje zhurmat nuk kish të mbaruar. Megjithatë, vendosi të mos hiqte dorë gjersa të hynte në lidhje, sikur kjo punë të vazhdonte tërë ditën e t'i kërkonte shumë energji. Po dalëngadalë e humbi durimin. Minutat kalonin n'eratjetrën dhe secila nga ato mund të ishte fatale për ekuipazhin që vazhdonte të ndeshej me detin, me dallgët. Ndërsa fliste, atij ju bë se ndërtesa e pikës sinjal-lo-vrojtuese nisi të lëkundej, si të lundronte edhe ajo mbi dallgë. Dallgët fryheshin e fryheshin, ngriheshin lart dhe përplaseshin e shkumonin mbi muret e saj, duke e shkundur nga themellet. Në një çast coptoreshin, po sakaq mblidheshin përsëri, fryheshin, ngriheshin

Iart dhe... Atij ju zu fryma. Ndjeu tē ftohtë. Pastaj nisi tē numéronte me nxitim:

— Një... dy... tri... pesë... shta...

Po fjala ju coptwa nē goë. Këtë herë dallga nuk ishte e murme e përcëshkumë, po e përflakur. Llava e zjarrtë e vetëtimës e përplasi në mes tē dhomës. Ndërtesa u lëkund si një lis i sharruar nga rrënjet. Telua nuk arriti as ta merrte me mend se ç'ngjau. Nuk mundi tē dallonte hapat e shqetësuara tē shokëve. Dera u hap me forcë dhe disa veta u ngjeshën njëri pas jetrit. Telua ish nxirë në fytyrë dhe dridhej si në ethe. Njëri nga detarët e mblohdhi më shpejt se tē tjerët, e mbërtheu me tē dy duart, i hoqi kufjet dhe e shtriu plotësisht.

— Pa shiko, jeton?

— I duhet dhenë ndihma e shpejtë.

Ky i fundit ishte zëri i komandantit. Detarët u kthyen me shpresë nga ai. «Si t'ja bëjmë? Ti je argasur në këto punë, shoku komendant». — i dukej sikur i thoshnin fytvrat e tyre tē shqetësuara. Ai u përkul, i shkopsiti pullat e kapotës, tē xhaketës dhe vuri veshin mbi gjoks.

— Jeton?

Ai bëri me dorë dhe mbaiti vesh. Për disa çaste në dhomë nuk lëvizi as miza. Ju duk se ndjeu rrahje tē dobëta, tē thella, po prap nuk qe në gjendje tē thoshte në ishte vërtet ashtu apo...

— Punon, shoku komendant?

Ai ngriti kokën dhe i pa. E kuptoi se nuk mund tē thoshte ndryshe dhe foli ngadalë: «Punon!» Por edhe vëtë nuk është i sigurtë për atë që tha.

— Të qëndrojë këtu vetëm infermieri, Nokua. Të tjerët jashtë. Dy-tri shokë tē kontrollojnë radion, ta rregullojnë dhe tē hyjnë në lidhje me «Limanin»

Këto fjalë komandanti i shqiptoi aq prerë, sa deta-
rët dolën pà e zgjatur dhe në dhomë qëndroi vetëm ai
që e kishte emrin Noko. Komandanti u ngrit dhe ju
drejtua dritäres. Kanatat kërcitën. Në dhomë u dynd
ajri i pastër. Një detar i pakët nga trupi, më ballin
e kërcyer e fytyrën si të gdhëndur në dru shqope, po
e vështronët i hutuar të dëmtuarin.

— Ti bëji masazh në zëmër, unë po përpinqem t'i
bëj frymëmarjen.

Pas kësaj në dhomë nuk u dëgjua mëasnje fjalë.
Detari vendosi dy mollëzat e duarve mbi dërrasën e
kraharorit e nisi t'ja shtypte me të gjithë forcën në in-
tervale të caktuara kohe, ndërsa komandanti i hapi ra-
distit gojën, i fryhti thellë dhe nisi t'i bënte fyrmëmark-
jen artificiale. Ata qenë dhënë me të gjitha forcat pas
kësaj pune, sikur të mos ekzistonte asgjë tjeter, veç
atyre lëvizjeve. Duke u marë me të sëmurin për disa
çaste e harruan gjithëshka, edhe anijen që luftonte me
dallgët.

— Më duket se shpëtoi.

Komandanti vuri re si po ndërronte e pak nga pak
ngjyra e fytyrës së të sëmurit dhe ndjeu t'i trihet fort
zemra nga gëzimi. U përkul mbi të dhe mbështeti ve-
shin mbi kraharot.

— Pa shikoje dhe ti Noko, njëherë.

Infermieri s'e bëri të g'atë. Ai ishte i ri në profesion
dhe nuk kishte përvojë në këtë punë, po një gjë ju
duk se e kuptioni mirë: cë i sëmuri e mposhti vdekjen.
Si të donte të vërtetonte këtë, radisti u përpooq të hapte
sytë e të thoshte diçka. Ata u përkulen, kërkuan ta
përsëriste, të rroknin kuptimin e atyre fjalëve. Po bu-
zët e tii u mbyllën dhe ai vazhdoi të heshtte, si të
kish rënë në një gjumë të thellë. Kur ata u përpooq
ta ngrinin për ta vendosur mbi një shtresë më të butë,

ai përsëri u përmend dhe u përpoq ta shprehte më qartë mendimin që e mundonte.

— Ra-dio-sta-cio-ni...

Komandanti i lëmoi me dashuri ballin:

— Mos kij hallin e radios. Ti të jesh mirë, pa atë e ndreqim.

Por radisti siç dukej donte të thoshte diçka tjetër. Ai lëvizi me mundim kokën majtas e djashtas dhe rana e heshtje, si për të mbledhur forcat. Pas një kohe e tërroqi nga mënga infermierin. Nokja u përkul mbi të, që ta dëgjonte më mirë.

— Ra...dio...sta...

— Mos u bëj merak për të! Në rregull është radioja; në rregull.

Po radisti prapë tundi kokën, duke mërmëritur disa trokje të tjera e duke u përpjekur të tregonte diçka tek qoshja. Nokja rendi atje.

— Ehë, e kuptova. Radiostacioni rezervë. Këtë do të thuash?

Radisti pohoi me kokë dhe për një kohë të gjatë nuk qe në gjendje të thoshte më asnjë fjalë.

— Po, e ka fjalën tek radiostacioni rezervë...

Në çast komandantit ju kujtua anija e transportit që vazhdonte të luftonte atie poshtë me detin e egërsuar. Ç'kishin bërë vallë shokët? A kishin mundur të rregullonin difektin në radio? Në vënd të përgjigjes, komandanti dëgjoi atë zë të pafuqishëm që përsërisht papushim fjalën «Ra-dio-sta--cio-ni». Vështroi fytyrën e Teilos që mezi ngopej me frymë rrathët mavi nën sytë e tij, trobat e përzhitura nga flaka dhe u përpoq të kuptonte se si arrinte ai të mendonte për anijen atje poshtë, kur vetë ishte akoma në trezik dhe nuk mundëj të lidhte mirë as fjalët. Me këto mendime ju avit dritarës dhe u zgjat ta shikonte. Po nuk dalloj asgjë qartë.

Ju duk se pa vetëm diçka të errët, të zezë, që herë shihej e herë i humbiste nga sytë. E kuptoi se ashtu siç luftuan ata për t'i shpëtuar jetën shokut, ashtu luftonin detarët atje poshtë dhëmbë, për dhëmbë menofullat e dallgëve që përpinqeshin t'i gjellitnин. Ju duk biles e ndjcu se si kërciste anija nga pupa në kic, duke u përpjekur me të gjitha forcat t'i bënte ballë zemërimit të detit. Edhe sa kohë do të mund të qëndronte ashtu?

Jashtë tufani shfrynte, retë shtrydhnin pa pushim shiun dhe çaheshin e ndizeshin flakë nga gjuhët e zjarra të vetëtimave. Dukej sikur nga çasti në çast mund të përsëritej ajo që kish ngjarë më parë.

— Duhet vënë në përdorim radiostacioni rezervë.

Ai nuk i kish thënë mirë këto fjalë, kur dera u hap dhe në dhomë u futën njëri pas tjetrit dy-tre detarë. Ata morën drejtqëndrim dhe pyetën thuajse me një gjë:

— Na lejoni ta pregatisim?

Ai u habit nga dolën ata, si e kishin marrë me mend se ç'duhej të bënin? Mos vallë kishin përgjuar që prapa derës? I vështroi me radhë. U përpoq të sillte diçka ndërmend nga puna, ngajeta, nga stërvitja e tyre. Po nuk mundi të kujtonte asgjë të rëndësishme dhe për këtë hengri inat me veten. Qe i bindur se ata ishin detarë të zakonshëm, që nuk dallohen aspak ndërt shokët. Po prap ju duk se nuk ishte plotësish ashtu. Me siguri nuk ishte, përderi sa në një çast të tillë nuk e përfillin fare rrezikun. Ata e shihnin qartë se ç'kish pësuar shoku i tyre që ish përpjekur të punonte me radio, në një kohë kur kishte aq shumë shkarkime. Dhe prap s'e përfillnin rrezikun. Mos vallë ai nuk i kishte njojur mirë ushtarët e tij, forcat e tyre? E pse s'i

ishte njohur! A nuk kishte thënë si se me ushtarë tē tillë mund tē merrte përsipër edhe detyrën më tē vështirë? Se përkrah tyre mund tē shkontë edhe drejt bunkerit tē armikut, pa ju dridhur qepallat?

— Më lejoni mua, shoku komandant.

Ai nyk dha përgjigje, apo ndofta edhe dha, sepse njëri nga detarët u shkëput nga shokët dhe ju afroa radiostacionit rezervë. Ishte Hasani, kuzhinjeri i pikës, i cili ditë më parë qe kritikuat në niblad' jn e organizatçs së rinisë. Komandantit nuk i kujtohej përsë e kishin kritikuat aq rreptë shokët. I erdhi mirë që e mori pikërisht ai përsipër detyrën tē hynte në lidhje me qendrën, dhe jo ndonjë tjetër. Atë çast shkrepëtiu përsëri dhe xhamat kërkëlinë e u drodhën gati për t'u thyer. Komandanti e vuri re se si u step Hasani. Mos vallë u tremb dhe...

Jo. Ky ishte një çast ngurimi. Detari ju afroa radiostacionit rezervë. Komandanti dhe shokët ndiqnian me vëmëndje, çdo lëvizje tē tij. E panë se si u ul në stol, si lidhi ushqimin, vuri kufjet, dhe zgjati dorën tē frotullonte çelësin për tē lëshuar korentin e për ta vënë radion në punë. Por dora i mbeti pezull. Një vërtitimë e flaktë dhe një gjëmim shurdhonjës, Diçka u kapët thye me rapëllimë.

— Sa afër shkrepit!

Në dhomë plakosi një heshtje e rëndë. Hasani zgjati prap dorën. Kapi dorezën. Ju duk se nuk kishte përparrë radion, po një kuti me eksploziv, tē cilën sa ta prekte, do tē shpërhente. Por kjo zgjati vetëm pak sekonda. Ai e vërtiti dorezën duke i shypur ato mendime tinxare si tē shtypte kokën e një nëpërkë. Diçka kërciti. U dëgjuar zhurma karakteristike e vënies së radios në punë. Sakaq ai nisi tē fliste me rrëmbim: — «Limani», unë «Fortesa» — «Limani» unë «Fortesa»... Si më dëgjoni... Unë...

E përsëriti disa herë thirrjen, duke kërkuar me këmbëngulje përgjigjen. U duk se kufjet do të çahesnia nga zhurmat e fortë tē shkarkimeve atmosferike. Por ai vazhdoi tē kërkonte, gjersa më në fund dëgjoi një zë tē dobët, tē ngjirur, tē thellë. E përsëriti thirrjen dhe, pa humbur kohë transmetoi radiogramin. Si u sigurua se qendra e kish marrë, ju afrua shokut tē sëmurë, si tē donte t'i raportonte se detyra qe çuar në vend. Xhamat i lëpiu sërisht kamxhiku i flaktë i vetëtimës, por tani askush s'e kishte mendjen tek ajo.

Nuk kaloi shumë dhe mugëtirën e detit e shpoi një drithë prozhektori. Detarët e pikës sinjalovrojtuese vrapuan më një frysme përjashta. Që andej dukej qartë se si i thërrmonte me gjoks anieja luftarake nofullat e shkumuara tē dallgëve. Përbri saj rrëshqiste anieja e transportit si një njeri që e kish humbur ekuilibrin dhe e kish lëshuar tē gjithë peshën e trupit mbi shpatullat e shokut që i kish ardhur në ndihmë.

AT E BIR

— Tregim—

Xha Polua nuk mbante mend tē qe lodhur tjetër herë sa atë ditë. Dhe po ta pyesje hollë-hollë, ai nuk do ta kishte tē lehtë tē përgjigjej nē se kjo lodhje vinte nga puna, apo nga mendimet që nuk e kishin lënë tē qetë, sa edhe një minutë tē vetme pas letrës që kishte marë një ditë më parë nga fshati. Çështë e vërteta, ai qe ngritur shumë shpejt nē mëngjes dhe e kishte filluar punën pa zbardhur mirë drita. Kishin kaluar më shumë se dy muaj që kur, së bashku me dy muratorë tē tjerë, kishte marë përsipër tē ndërtonte shtëpinë trekatëshe tē një tregëtari lëkurash. Kur lidhën kontratën, ata patën mëduar se do ta përfundonin ndërtimin pér pesë-gjashtë muaj, por ja kaloi gjysma e kohës e akoma nuk kishin mbaruar katin e parë. Dhe kjo s'vinte nga që i kishin bërë llogaritë gabim. As sepse nuk punonin. Jo. Ata ishin tē tre ustallarë tē regjur e tē fortë, që s'dinia ç'ishte pushimi. Punonin derçë. Por shpesh punën që bënин i zoti nuk e pëlgente e nxirrte njëmijë kleçka. Tregëtari i lekurave, një burrë tretë tē dyzetave, me nofullat pak tē kërcyera e mustaqet spic, i veshur me ajë xhaketë sportive me kuadrate, qillota e çizme tē ngrira akull, kishte qëlluar njëri grindavec e tekanoj,

sa nuk ja gjeje shokun. Shpesh herë ai vinte si era dhe, si i hidhte një sy murit që kishin ndërtuar, nxihej në fytyrë, përplaste këmbët nëpër skela e therriste si i çmëndur, i pakënaqur nga puna e ustallarëve. Shante sa shante, duke u dridhur si në e he, pastaj kërkonte të përsëritezë puna, duke i lënë të tre muratorët të habitur sa s'kish ku të vente më. Ata qenë hallexhinj dhe të shumtat e herës nuk largoheshin pa e ndërtuar edhe njëherë pjesën e murit që i zoti i shtëpisë nuk e kish pëlqyer.

Kështu kishte ngjarë edhe atë ditë. Pas punës së lodhëshme xha Polua mezi qëndronte në këmbë. Para syve të tij hidhnin valle tullat, skelat, llaçi, tezgat. Kjo ishte një valle e vrullshme gati e çmendur, të cilën ai nuk qe në gjendje ta ndalonte. Dukej sikur bashkë me tullat, me llaçin, me skelat, vërtiteshin edhe shtyllat elektrike, llampat, ndërtesar; rrugicat, cypa qelli me yje të zbehtë, gjithshka që e rre honte. Para syve të tij ato ngatëroheshin me njëra-tjetër, vraponin, vërtiteshin gjithnjë më shpejt...

Duke i shkëputur me mundim hapat nga toka, mezi arriti në shtëpi. Kjo shtëpi përbëhej nga një barakë e vjetër, e ndërtuar në qo she të rrugës me dërrasa të kalbura, ku hynte era nga të gjitha anët. Ai kishte mbërrthyer mbi dërrasa copa gazetash për t'i prerë rrugën erës. I lodhur siç ishte, ai mbulonte kokën më një velenxë të vjetër, dalëboje, e humbiste në një gjumë të thellë. Thua jse ngjitur me të, mbi një shtresë rokanidhesh, flinte i biri, Rakua. Shpesh herë, kur kthehej natën vonë nga puna, ai e gjente të birin në gjumë. Në kësi rastesh, xha Polos i pëlqente të qëndronte për një kohë anash shtrojes prej rokanidhesh dhe ta shikonte e ta shikonte për minuta të tëra të birin tek flinte i qetë e i kënaqur. Ai kishte dhe fëmijë të tjerë plot

yatrën, dhe tē gjithë i donte si shpirtin dhe tani që i kishte larg, e zhuriste malli pér ta, por prap i dukçj se Rakon e donte shquar nga tē tjeret. Kjo nuk vinte vetém nga që ai ishte fëmija e parë e direku kryesor i shtëpisë (po tē mos llogaritim dy vajzat e martuara), as sepse shihte tē trashëguara tek i biri shumë nga cilësitë e tij, sidomos forcën e karakterit dhe dashurinë pér punën, por sepse u bënë dy-tre vjet që, bashkë me tē, kishte marrë rrugën e qytetit pér tē nxjerrë kafshatën e gojës pér vete dhe gjashtë fëmijët e tyre, akoma tē vegjël. Kur e shihte tek flinte i lodjur, me atë fytyrë tē njomë e tē parrajur nga hallet e jetës, xha Polos i sëmbonte në zemër e i dukej se edhe Rakua vete, që sa po i kishte mbushur tē gjashtëmbëdhjetat, kishte akoma shumë nevojë pér përkujdesjet e prindit.

Vetém pér një gjë e brente meraku, si ndryshku hekurin: që i biri, Rakua, sidomos kohët e fundit, nuk i sillte asgjë. Po ai e dinte mirë se leku nuk nxirrej kolaj në ato kohra, ndaj e shikonte ashtu me zemër tē përdëllyer e i dukej se kurrë nuk e ngopte as barkun me bukë, as syrin me gjumë. Dhe ecte në majë tē këmbëve, merrte kutinë me brumë që e mbante gjithnjë pranë pér tē ngjitur copat e gazetave tē grisura në dérrasa, që tē mos hynte era e tē mos bëhej zhurmë. Po atë natë, nuk qe i zoti pér asgjë. Hapi derën me rrëmbim dhe u përplas në shtrojën prej ta'lashi. Rakua u ngrit ndënjur. E vështroi nië çast tē iatin dhe u çudit kur vuri te fytyrën e tij tē hequr e tē parruar që shprehte dëshpëtim tē thellë. E kuptoi menjehërë se punët nuk i kishin shkuar mirë dhe i erdhi keq kur mendoi se sa shumë do ta mërziste letra që kishte ardhur nga fshati. Në fillim mendoi se mbase do qe më mirë ta linte tē flinte, e tē nesërmen në mëngjez t'ja jepte letrën. Por ishte i bindur se, po tē vepronte ashtu, i jati nuk do t'ja fal-

te. Ndaj i zgjati lëtrën në fështje. Babaj e mori me përcese.

— Nga fshati? — pyeti.

Rakua përkuli kökën.

Dhe u shtri. Kishte uri. Shumëuri. Barku i që bëre hon. S'qe i zoti as të qëndronte më këmbë as të përtypoj. Donte të flinte. Vetëm të flinte. Por, në sup ndjeu një prekje të lehtë.

— Babal

— Ë?

— Ti je lodhur, por...

Ai u fgrit me trëmbim:

— Ka ngjarë gjë?

— Asgjë. Por duhet ta lexosh sonte... Unë këshitu them, pa ti si të duash.

Xha Polua hapi zarfia dhë nxori që andej një lëtër të zhubravitur, ku ishin shkruar me nxitim nga një dorë e shqetësuar vetëm pak rradhë. Ai u hodhi një sy më një frymë dhë u kthye të lexonë përsë dyti e përsë treti. Por tani vetëm sytë i rrëshqisnin mbi ato gërmëtë të shtrëmbëra, kurse fjalët i ishin ngulitur fort në tru. Ai e rroku që në leximin e parë kuptimin e plotë të tyre dhe u drodh i téri sa, po të që në këmbë, nuk do të mund ta mbante dót ekuilibrin, njëlloj si pak më parë, kur ishte duke ecur dhe ju moën mendtë. Por tani që shtrirë dhe e kish ngulur vështrimin mbi çatianë prej lëtre katramaje. Rakua u trenb nga ai vështrim dhic u përpoq të thoshte diçka, ta qetësonë, po as vëzë s'qe i zoti t'i lidhte fjalët që i dolën nga goja e të trokëtë kuptimin e tyre.

I jati e hoqi vështrimin e turbullt nga çatia dhë e hodhi mbi të.

— Ti ç'dërdëllis ashtu...? E lexove apo jo lëtrën... Gjersa e lexove, qepe.

Dhe u ngrit e u suall nëpërt barrakën e vogël e të ngushtë, duke u penguar herë në shtojat, herë tek tavolina e vogël me dërrasa të pazdruktuara, që e kishte bërë vetë. I dukej sikur rrëth e rrrotull nuk kishte as tavolinën, as karrigën e vetme dhe shtrojat prej rokanidhesh, por vocrakët dhe të shoqen që e zinin nga këmbët dhe nuk e linin të ecte. Ai përpiquej të mos i shkelte, po nuk mundej, pengohej vazhdimisht dhe gati sa s'rrëzohej. Më shumë nga çdo gjë e turbullonte vështrimi i hutuar e i pashpresë i së shoqes, që dukej sikur delte që nga rreshtat e shkruara me nxitim në atë trip letre. «Na bën derman – i thosh ai vështrim. – Hasan agai nuk e priti afatin e fundit që t'i kthenim borxhin, po na nxori nga shtëpia dhe futi brenda qëtë. Jemi në katër rrugët. Pa bukë. Fa strehë. Të humbur...»

Duke u penguar tek tavolina, ai i përfëriti me zë këmto fjalë. Ishte një zë i dobët, që shprchte dëshpërim të thellë. Rakos i erdhë keq për të jatin dhe u përpoq prap të thoshte disa fjalë për ta qetësuar. Por, sado që u mendua, ju duk vetja i pazotit të gjente fjalë të tillë dhe seç përsëriti disa fraza pakuptim.

I jati qëndroi dhe i nguli atë vështrim të çuditshëm:
– Ti hesht! More vesh? Hesht!

Dhe i ktheu krahët. Hodhi një çap të rendë, dy, tri. Rakua e vështronë tek dridheshin e luhateshin shpatullat e tij të varura, si degët e një lisi të moçëm. Ato shpatulla gjithnjë i qenë dukur të forta të paepura, kurse atë çast ju dukën çuditërisht të dobëta e të pafushime.

I jati u kthyë dhe qëndroi para tij.

– E more rrrogën? Haide, fol. Shkoi një muaj që nuk ke prurë asnjë çerek leku. Ç'i bën paratë?

Ai zë gjëmoi si bubullimë. Barraka u drodh.

– Kam pasur... punë... Nuk kam punuar...

Xha Polua ngriti supet.

- Ti je ç'mendur. S'di ç'flet. Edhe ke patur punæ, edhe s'ke punuar! Thuaje troç. Ç'maskarallëqe bën? Me kë përzihesh? Si e vret kohën? Fol!

Ishte po ai zë bubullime që nuk e mbanin dot muret prej dhogash, as çatia prej katramaje. Rakua u hutua. Si të përgjigjej? E kuptoi se në atë rast fjala nuk kishte forcë ta shsajësonte. Të paktën atë natë i jati nuk do ta kuptonte kurrë, çfardo që të thoshte. Dhe e ndau mendjen të heshtte. Por kur ngriti sytë dhe patë jatin që qëndronte pa'ëvizur më këmbë, u bind se nuk do ta linte të qetë pa marrë një përgjigje.

- Ç'i bën paratë? - pyeti për të tretën herë.

- Nuk marr para.

- Atëhere nga zabërhanis? Ç'bën?

- Po ja, si të them...

- Mbylle gojën. Këtë të bësh! — dhe lëshoi bcfas me të gjithë forcën mbi fytyrën e të birit pëllëmbën e tij të rëndë e plot ka lo. Rakos i lëshuan sytë xixa. Ju duk sikur i ra baraka mbi krye..

- Baba! ..

Por ai tanë as e shikonte, as e dëgjonte. I dukej sikur ajo pëllëmbë kish rënë jo mbi të birin, por mbi fytyrën e tij. Dhe gjer atë ditë nuk mbante mend as të kishte qëlluar, as ta kishte goditur njeri.

U shtri mbi velenxë, pa u xhveshur, mbylli sytë e u përpooq të harronte çdo gjë. Por nuk mundi. Në mëngjerez, kur po agonte dita e re, nuk qe në gjendje të thoshte në kishte fjetur, apo e kishte gdhirë natën pa gjumë.

Kur mori rrugë, puhiza e lehtë e mëngjezit ja freskoi disi ballin me rrudha të thella, fytyrën e lodhur, buzët e plasaritura. Ju duk se e trihnin etke. Duke u

çapitur ngadalë nuk qe në gjendie të thoshtë në kish vërtet temperaturë, apo i vinte kjo nga nata pagjumë. Kur arriti tek ndërtesa, rë ballë i kishin mbu'uar d'ersët. Qëndroi disa çaste ashtu në këmbë, pastaj përveshë llërët. Edhe pse nuk kish pushuar, kishte një dëshirë të tullë për të punuar, si rrallë herë tjetër. Po të mundej, ai do të donte të punonte e të punonte pa pushim, gjerësa të ngrinte ndërtesën. Dhe nisi të vinte me shpejtësi njérën tullë pas t'ëtës. Por muri ngrivej ngadalë, shumë ngadalë. Madje i dukej sikur në vend që të bënte përpjetë, ulej, gjithnjë ulej. Më në fund erdhën shokët. Ata e përshënderët, por ai vazhdoi të shtronte llaç e të vendoste tulla, pa nxjerrë zë nga goja. Në vështrimin e parë dukej i qetë, por ziente përbrenda. Dhe vazhdonte gjithnjë të fliste me veten, të thërriste, të grindej. Rrallë herë i kich ngjarë kështu. Edhe pak më parë, kur s'kishin ardhur akoma shokët, i dukej se nuk qe vetëm. Sikur aty, rrëth tij, bile brënda tij, vërtiteshin, flisnin grindëshin, disa veta: ai, i biri, e shoqja, kalamajtë, dhe pastaj tregëtari i lëkurave me Hasan aganë që i ngatëronin e i bënин përshest të gjitha. Në një çast ju duk e çuditshme kur mendoi se ai tërë jetën ishte rropatur duke ndërtuar shtëpi për të tjerët, kurse fëmijët e tij kishtin mbetur në mes të katër udhëve, pa streh, pa çati. Dhe e përplasi me inat misri në mbi tulla. Metali u përthyte dhe lëshoi disa tinguj therrës. I erdhi keq për të. E ç'faj kish ajo? S'kish asnjë faj... Po kush e kishte atçhere? Nga viniia të gjitha këto?...

...U përkul. Mori misri në e shkoi mbi të pellëmbësë e ashpër, si t'i kërkonte falje. Dhe nisi të punonte. Venodisi radhën e parë të tullave, të dytën. U përhoq ta hidhëtë çdo gjë pas krahëve. Të jepë i téri pas punës. Dhe ashtu bëri për një kohë. Por pak nga pak që nga

pirgu i tullave e togu me llaç, nga skelet, madje edhe
nga vetja e tij, e sulmuhan qrap njerëzit, fjalët, zërat.
Tfu! Ç'është kështu?

Mbushi mistrinë e u përkul të merrte një tullë tjeter. Por për çudi ajo ju duk e butë, e rrumbullaktë, e zbulohet si fityra e djalit motak. Tfu! E la atë e desh të merrte një tjeter. Por edhe ajo sikur kërciti. Mbase ashtu ju duk, kurse në të vërtetë ai ndjëu zhubravitjen e letrës që kishte në xhep. Sikur i preku me dorë ato fjalë që i flisin për Hasan aganë... borxhin... katër rrugët. Dhe u përqeth i téri. Tfu! Katër rrugët! Po, po. Fëmijët kishin mbetur jashtë. Dridheshin nga urija, nga të stohtit. Dhe prisnin me frikë e ankth, prisnin nga ai... Nga ai dhe nga Rakua. Por Rakua ishte vetë fëmijë. Fëmijë? Tfu! Në moshë të tij, ai, xha Polua, kishte mbajtur shtëpinë. Kurse i biri...! Rakua! Ç'bënte vallë Rakua? Ku i ngryste d'tët? Përse nuk punon-te?

Dhe ju kujtuan fialët që i kish zënë veshi ato ditë për të birin. E çfarë s'kish dëgjuar! Njerëzit thoshnina se e kishin parë rrugëve. Kush në në veturë. Kush me ca shokë të dyshimtë. Me një bishtpërdredhur. Me një xhandar. Të veshur me ca rrobe fringo të reja. Dhe me mustaqe. Çudi! Me mustaqe! Nuk qe e munduri! Mbase e ngatërronin me ndonjë tjeter. Rakua vetëm një palë rrobe të vjetra e të grisura kishte, dalëboje, që s'kish ku t'i kapte qeni. Kurse mustaqe kurrel E ç'mustaqe do kish ai, gjashtëmbëdhjetëvjeçari! Me siguri që e ngatërronin. Pastaj ç'qe ajo bishtpërdredhur? Ajo veturë? Ai xhandar? Sidomos xhandari... Dhe mëndja i vajti tek fjalët e letrës: «na nxori me xendarë nga shtëpia!» (ai xhandar i qe kujtar mbrëmë kur kish ngritur pëllëmbën, ndaj e kish qëlluar aq fort, sa i dhëmbi dora) Ç'punë do të kishte ai me xendarët! Jo, jo. Të gjitha qenë fjalë.

— Ç'kë këshfu, o xha Polo? Pse t'u lidh gjuha?

Ju lidh gjuha? Çudi. Ai s'kish pushuar asnje çast. Sido mos sot. Me tē tērē fliste. Me tē tērē grindej. Ndaj dhe nuk merritë vesh se ç'ngjiste. Ndaj e ndjente veten tē lodhur, tē kapitur. Se, kur nuk e nxjerr pērijshta e nuk e ndan me tē tjeret si tē mirën, si tē keqen, tē vret mē shumē.

— Nuk e shoh mirē atē tēt bir, o xha Polo. Mē duket karafil fare.

Ai kërceu pērpjetē, sikur ta kishte piskuar njeri. Po qjetri vetem sa foli dhe vazhdonte punēn pa ngritur kokēn. Pa u bērē merak pēr ato qē kish thēnē. Vendoste ajerēn tullē pas tjetrēs mbi mur dhe hidhte kur e kur ndonjē romuz:

— Ti si tē duash, o xha Polo. Po mua mē duket karafil ai yt bir. Firifiu mē duket.

Ai nuk duroi mē. Pērplasi mistrinē pēr tokē. Hoqi pērparësen dhe zbriti nēpēr ca shkallē tē drunja. Dikū u pengua. U gërvishjt. Desh u rrëzua. Por u mbajt. Skela u tund gjer lart. Dikush shau.

— Tful! — shfryu dhe çau pērpjetē rrugicës me një çap tē gjatë, tē rëndë, tē shqetësuar. Si doli nē rrugën e gjérë, u mendua një hop, pastaj mori nga e djathha. As vetë nuk e dinte se ku do tē shkonte e çdo tē bënte. Pas pak u gjend para derës së barrakës qē i shërbente si dhomë atij dhe tē birit. E shtyu me rrëmbim. Dera u pērplas duke nxjerrë ca tinguj tē çjerrë. Nuk qēnkal! tha dhe lëshoi grushtin mbi tavolinën me dërrasa tē pazdrukuara. Ajo u pērshkund e u rrëzua. Ai as qē mori mundimin ta ngrinte. U shtri mbi dyshekun prej tallashi. Megiithëse nuk kaluan as dy-tre minuta, ju duk se ndenji shumë. Brofi nē këmbë. Atë çast, mbi shtröiën e tē birit pa nië cep gazete ku i-hin shkruar disa fjalë me laps kopjativ: «Baba, mos u bëj merak. Son-

te nuk vi. Rakua.» Ai e mblodhi letrën shuk dhe e coptoi me gishtat e trashë e të plasaritur, si t'ja kiske te ajo tërë fajin. Në një çast çdo gjë ju mjergullua. Barraka e vogël u vërtit, u anua herë majtas e herë djathas dhe para syve ju suallën dhjetra xixa të bardha, të cilat s'e nga dilnin në zbrazëtirë dhe largoheshin e largoheshin anash. Ai e ndjeu se do të rrëzohej dhe u mbështet diku. Barraka e vogël u drodh e u lëkund, si t'i qenë marrë dhe asaj mendtë.

Këto zgjatën vetëm disa çaste. Ai e kuptoi se marramendja i erdhi më shumë nga nervozizmi, se sa nga lodhja e pagjumësia. E ndjeu se nuk do të mund të qëndronte gjatë në një vend. Ajo barrakë e ulët dhe e ngushtë ja zinte frymën. Vendosi të delte. Dhe nisi të ecte ngadalë. Njerëzit, shtyllat elektrike, ndërtuesat rrëshqisnin majtas e djathas. Atij ju duk sikur rreth tij gjithshka ngulçonte e tërhiqezi zvarë e lodhur nga ajo tendje e pandalur dhe e pakuptim që nuk pushonte as ditë, as natë. Çdo gjë lëvizte e rrotullohej në një rreth të mbyllur, njëloj si ai, pa ditur nga vinte e ku do shkonte.

Qëndroi pranë një çesme dhe i hodhi disa grushta ujë fytyrës, pastaj futi kokën nën rubinetë. Ujët i rro dhi me vërshim mbi kokë, zverkun dhe gjoksin e tij leshtor, sa ju zu fryma e nuk ngopej me ajér. Megjithatë, nuk u largua, gjersa e ndjeu t'ja mpinte trurin e t'ja mbështillte të gjithë trupin një rrymë e freskët dhe shplodhëse. Atëhere u ngrit, fshiu fytyrën me shami dhe zuri të ecte. Hodhi vështrimin anash. Disa fëmijë luanin me topa leckash. Një grua e mbuluar me perçë, si të kiske hedhur mbi trup e fytyrë një copë nate të zezë sterë, përplaste nallanet nëpër kalldrëm. Më tej ecnë me çap të rendë e të ngadalshëm dy xhandarë, me armët në krah, duke shpërndarë nëpër rrugë disa vësh-

trime tē akulltē e tē dyshimtē, qē dukej sikur qēndronin pezull prapa krahëve tē tyre. Një ushtar italian, me duart nē xhepa dhe një pendë këndezi mbi kapele, vërsħellente një melodij kabaresh dhe e hidhte vështrimin mbi dritaret e zëna me grilla, qē dukej sikur i bënин munxat.

— Tsu! — shfryu xha Polua dhe zgjati hapin. Nuk ishte nē gjendje tē thoshte pēr tē sajtēn herë po kalonte nēpēr ato rrugë tē rrēthuara nga tē dy qanet me ndertesa dy dhe tre katëshe. Pērballé tij shfryu e zhurmoi një veturë militento, pastaj një kamion dhe një pajton luksoz, i tērhequr nga dy kuaj tē bardhë, qē e mbushën rrugën me trokun e patkonjve dhe tinguit e zi eve tē vogla e tē verdha rrēth qafës së kuajve. Ai gē ishte ulur brenda, me shpinën e mbështetur mbi kolktuk, vështron te indiferent kalimtaret. Nē një çast shikimi i tij u kryqëzua me atë tē xha Polos. Ustai kapsalliti sytë, pa mundur tē kuptonte se cili ishte ai qē buzëqeshi si i zënë nē faj, duke u pērpjekur t'i shmangej vështrimit tē tij. Pa dale një herë. Mos eshtë...

Dhe zgjati hapin, pa ja larguar sytë pajtonit qē pērshkoi një giysmë rrëthi nē sheshin e gjë ë nē qēndërt tē qytetit dhe u drejtua pēr nga rruga veriore. Sadoqë zgjaste hapat, xha Polos i dukej sikur qēndronte nē vend. Hodhi edhe disa çapa, pastaj vrapi e i doli karrocës pērpara. Gati e shkelën kuajt. Karrocieri, një djalë i shëndetshëm, me një kasketë tē kthyer anash, nga delnin një tufë flokësh tē verdhë e kaçurelë, u ngrit i trembur dhe tērroqi frerin me tē gjithë forcën, duke mallkuar burrin qē shpëtoi pēr qime. Po xha Polua as qē u bë merak pēr atë qē ngjau. Ai hapi derën e pajtonit dhe kérceu brenda, duke e lënë gojë hapur karrocierin dhe kalimtarët qē mbajtën hapin e po vështronin kureshtarë ç'po ngjiste. Rakua u hodh mbi ar-

kën gjatoshe që kish para këmbëve. At e bir qëndruan përballë, me vështrimet e ngulura shigjetë mbi njëritjetrin. Për një çast asnjëri s'foli. Karrocieri futi kokën që nga vendi i tij dhe seç i mërmëriti xha Polos me shpejtësi e shqetësim në vesh. Por ai kish kapsallitur sytë. Më shumë se çdo gjë, e trondiste gjaktohtësia e të birit. Ja si qënka puna! Njerëzit paskan të drejtë. Ai vërtet shetiste me karroca luksoze.

— Baba, mos na pengo, se na ndjekin...

Ai e mbëtheu nga jaka e xhaketës. Stofi i ri dhe i butë i rrëshqiti në dorë. Xha Polua kurrë nuk kishte mbajtur një kostum kaq të ri dhe kaq të shtrenjtë. Ju duk sikur nuk kishte përpara të birin, po tregëtarin e lëkurave, me kostumin sportiv.

— Të ndjekin, ë? — dhe u rrëngeth i téri. — Mas-kara!

Dhe u përkule u përpoq me të gjithë forcën të ngren-te kapakun e arkës, mbi të cilën kishte hipur i biri. Rakua seç fliste me karrocierin, por ai tani nuk dëgjonte asgjë. Më në fund ja arriti qëllimit. Kapaku kërciti dhe u ngrit përgjysmë. Ai futi dorën. Preku diçka të fortë, të ftohtë.

— Armë!

Dhe u step. Çdo gjë u lëkund e gjëmoi. U pë:mbajt me rropamë.

— Po. Armë, për luftën...

«Ja si qenka puna!»

Xha Polua e ngriti me shpejtësi vështrimin nga arka dhe e hodhi mbi fytyrën e skuqur të të birit. Për çudinë e tij, ajo fytyrë nuk ju duk si herët e tjera: e njaminë, e zbehtë, e hutuar, por krejt ndryshe. I dukej sikur kish përpara një djalë tjetër të rritur serioz, ngulmonjës. Xha Polua e vështronte i hutuar. Gjoksi i ngrihet e i

ulej me rrëmbim. Nuk e kuptonte se ç'po njiste me tē. Dhe prap ndjente se kish ngjarë diçka e rëndësishme, e pabesueshme. Ngriti sytë. Përreth lëvrinin ujerëz. Niéri ngá ata përsëriti me drithërimë fjalën «armë» dhe shtyu me bryla tē tjerët e u largua. Ai mbajti vesh. Ju duk se atë fjalë e përsëritën dhe dy-tre tē tjerë. Pastaj njerëzit, truga, ndërtesa, gjithshka sikur thëtriste e përsëriste me tē fortë: «armë... armë pér luftë...! armë...!»

Dhe prap gjithshka u drodh. Gjëmoi. U përmbyss.

Karrocieri i përshpëriti tek veshi:

— Baba, po afrohen xhandarët!

Këto fjalë e përmëndën, si t'i kishte hedhur njeri mbi fytyrë një kovë me ujë tē ftohtë. Mbylli me shpejtësi kapakun. U ngrit. Hodhi vështrimin mbi kalimtarët. Që prapa po shpejtonin me zhurmë dy xhandarët, me armët në duar. Mbi metalin e shkëlqyer diçka shndriti. Tehu i bardhë i bajonetave ju duk se u drejtua mbi djalin e tij. Ai mblodhi grushtat varrë. Veç tyre s'kish ç'tu vinte tjetër përballë bajonetave. Po atë çast ju duk se asgjë s'mund tē ishte më e fuqishme se grushtat e tij.

— Nisuni...!

Sakaq karrocieri thërriti me tē gjithë forcën dhe vërtiti mbi kryet e kuajve kamzhikun që çau njëtin me ulurimë. Karroca kërceu me vrull përpëra. Mbi tē u ngrit fishkëllima e një bilbili. Hapat e rëndë tē këpuçëve, me gozhdë nxorën xixa. Pastaj një zë i çjerrë:

— Ndal... Do tē qëlloj...! Ndal...!

Dhe llozat kërcitën: Tytat u ngritën. Gati e prekës karrocën.

— Ndal...! Do të...

Por nuk arritën ta mbaronin fjalën. Xha Polua u hodh trufe në mes të xhandarëve. U përlesh me ta. Diçka e fortë e goditi në gjoks. Në një çast çdo gjë u errësua, u lëkund. Ai e humbi ekuilibrin. Por nuk u rrëzua. Dy krahë të fortë e mbajtën. Pastaj drejt tij u zgjatën krahë të tjerë, të fuqishëm, që e afroan pranë dhe e futën në mes të turmës.

Të gjitha këto ngjanë aq shpejt dhe aq pa pritur, sa ai nuk arriti as ta mblidhë veten. Dëgjoi vetëm troukun e thellë të kuajve që largoheshin.

VENDROJA NUMUR TRE

Më nē sund erdhi ora tē leja sherbimin. Eh, si e kisha pritur atē çast! Sa tē gjata mē dukejin minutat! Sā fort mē trihte zemra! Mē dukej se do ta shpérthente kraharon. Rcallē herē kisha ndjerē një pështje lim tē tillē. Aty mē dukej vetja e lumtur, aty... Po fundja, përse tē mē dukej ashtu! Asgjë e jashtëzakonshme s'kishte ngjarë. E megijithatë...

Pra, sa lashë sherbimin, u lëshova me vrap te pylli. Ishte një pyll i dëndur, rrëzë një shkëmbi plot shkrepëpa, një pyll me pisha tē drejta, tē larta, me një gjelbërim tē ndezur, që ruante nē gjirin e tij niç heshtie tē thellë, tē madhërishme. Në vështrimin e parë, aty gjithë shka ishte e thieshtë, e zakon hme, por po tē qëndroje pak e tē shikoje më me kujdes, nē ato pisha që vendë vende ishin mpleksur e kacavjetur nëpër shkëmb, do tē zbulojë një bukuri tē rrallë që nuk e kishe parë nē asnjë vend tjetër.

Atje, nën hijen e tyre, ishte ulur nëna ime. Unë ja dorëzova pushlikën Ermirës dhe u lëshova me vrap drejt saj. Ecja ashtu si atëhere kur isha e vogël, si tē më ndiqte njeri pas për tē më zënë. Kur arrita atje, nuk ngopesha me frymë. Sa e pashë nënën, ju derdha në gjoks dhe i thashë e ngashëryer:

- Më fal nënë, unë...

Kisha aq shumë për t'i thënë, për t'i treguar... E

përsëri heshtja. Isha futur e tëra në atë gjoks të ngroh-
të, ndjenja erën e trupit të saj, me të cilin isha mësuar
që e vogël, dhe më dukej aq e ëmbël, aq e dashur..

- Më fal, nënë!

Ajo ma ngriti kokën, ma mbështolli me duart e saj
të mëdha, të ashpra, dhe më vështroi përmes perdes
së lëngët, të tejdukshme. Një lot i madh, i shndritshëm,
vezullues, i rrëshqiti nëpër faqe. Nuk kisha parë kurre
një lot të tillë.

- Më kishte marrë malli, moj bijë, dhe nuk durova
dot. Nuk e tëholla më gjatë. Thashë se jo e vogël e
kushedi vallë ke ftohtë. Valë nuk e mbush barkun
me bukë, thashë. Dhe mbusha bohçen me ushqim, mora
këtë trikon e leshtë e erdha. As vetë s'e di se si të
gjeta. Brodha shumë. Ndaj, kur të pashë, nuk durova
dot. Po t'i s'kishe faj. Shoqet më treguan se ashtu është
rregulli në ushtri. Unë...

Dhe prap nisi të tregonte se si e kishte ndarë men-
djen për të ardhur, si qe preqatitur, si nuk e kishte
zënë fate gjumi atë natë. Pastaj nisa t'i tregoj úncë. I
thashë... Po dale njëherë. Më mirë t'i tregoj me radhë,
ashtu siç kanë ngjarë. E di që këto janë kaq të thje-
shta, kaq të zakonshme, sa për të tjerët nuk kanë asnjë
rëndësi. Po prap dua të flas, dua t'ja tregoj dikujt.

Dje u mbushën plot tre javë që kemi ardhur këtu
për stërvitje ushtarakë. Sa zbritëm nga maqina ne, vajr-
zat e klasës sonë, mbetëm të mahnitura. Për herë të
parë largoheshim nga familjet dhe ishim si në ëndërt.
Çdo gjë për ne ishte e re dhe e bukur, po prap na
dukej sikur diku i kishim parë këto lëndina me një gjel-
bërim të butë si kadifë, në mes të pyjeve me pishë.
Na dukëj së atë bafiun me tufën e dhenvë e kishim
parë diku, tidofta në një tabillo osë në një kuadër filmi

me ngjyra. Na vinte tē thërrisnim, tē këndonim, tē batesnim.

U zumë dorë për dore dhe u lëshuam me vrap lëndinave. Atë çast buçiti një zë i fortë, urdhëronjës:

— Toga e parë, në dy rreshta mblidhuni!

Ai zë na kujtoi se ne nuk kishim ardhur këtu për tē shëtitur e për tē parë bukuritë e natyrës, po për t'u stërvitur. U mbodhëm në çast. Komandanti, një meso burrë me fytyrë tē rrahuar nga era e bjeshkëve, i lindur e i rritur në këto anë, na foli për detyrën që na priste, në cilat çadra do tē flinim, ku do tē hanim, ku do tē stërviteshim dhe na ngarkoi menjëherë me punë. Sakaq u shpërndamë nëpër çadra dhe u morëm për një kohë me rregullimin e tyre. Na dukej e çuditshme kur mendonim që do tē jetonim e do tē flinim në një vend aq tē ngushtë ku nuk mund tē drejoje as trupin. Po shpejt u mësuam me jetën e re. Gjithë ditën lodheshim në stërvitje, kurse në mbrëmje kthesheshim, ndiznim diku afër një zjarr tē madh dhe tregonin... E çfarë s'tregonim! Zakonisht fliste komandanti, por shpesh vinin edhe pleq tē moshuar tē atyre anëve. Ata tregonin nga e kaluara e tyre, ne dëgjonim dhe na dukej e pabesueshme që njëzet e ca vjet më parë, në këto vende, tē bukura ishin zotër tē plotfuqishëm bajraktarët e më pas strukeshin bandat e kriminelëve, tē diversantëve. Një mbrëmje unë isha dhënë e tëra pas tregimit dhe vështroja e lumtur rrëth qadrave, anës pyllit e më dukej sikur, nga çasti në çast, di tē dilnin andej ata njerëzit e parruar, tē frikshëm e t'nzarë. Pa dyshim, një nga ngjarjet më interesante tē ditëve të para ishte shërbimi i rojes natën, në vendrojen numur tre. Kjo ishte pika më e largët e fushimit, një vend i yequar rrëth njëqind metra larg, në mes kaçubeve, ku që vendosut depoja e armatimit. Natën e parë shërbimi

i takoi Gjergjit, një shokut tonë të klasës. Atë s'e mbante vendi nga gjëzimi. I dukej seç kishte bërë. Kurse ne para se të flinim, u mblohdhëm grumbuli, dojën në mes të çadrave dhe vështronim andej nga duhej të ishte vendroja numur tre. Një e rënqethur e lehtë na e përshkoi trupin. Papritur aty afër dëgjuam një zë të fortë: «Ndal, kush kalon?» Njëra nga ne, Rina, klithi e trembur. Ndosta edhe unë do të kisha bërë si ajo, po të mos dëgjoja përgjigjen: «Jam oficeri i rojes.» E daluan në çast, ishte zëri i komandantit. Dhe ne u qetësuam.

Të nesërmen, në qendrën tonë të stërvitjes flitej vetëm për shërbimin e parë natën në bjeshkë. Dalëngadalë sikur u mësuam me të. Por pas një kohe u gjan diçka e papritur. Njëra nga shoqet tona, Dalina, vajzë nga Dukagjini, u ngrit në mbledhjen e organizatës së rini-së dhe shprehu zemërimin për një «padrejtësi» siç thoshte ajo, që i bëhej asaj dhe të gjitha neve:

— E përse shërbimin e rojes ta bëjnë vetëm djemtë? — pyeti — A thua ne jemi më të dobëta se ata? Jo, aspak. Në këto male kanë luftue e kanë burrnue sikur djemtë, edhe vajzat. Ja ku e ka lapidarë Eftilia katërmbëdhjetë vjeçare, nga bregdeti — dhe shtriu dorën përrpara. Ne shikonim andej, dhe ja bënim me shenjë: «Ashtu de, më të lumtë. Hë, fol. Pse, ç'jemi ne që na ndajnë kështu?» — Në emër të të gjitha shoqeve, — vazhdoi Dalina, — unë propozoj dhe kërkoj që shërbimin njëzetkatër orësh këtë javë ta mbajmë ne, vajzat. — Pastaj shtoi me zë të paktë: — Në vendrojen numur tre, po të jetë e mundur, më caktoni mua të parën.

Dhe u ul.

Për disa çaste nuk lëvizi as miza. Pastaj u bë zhurmë.

Flisnin tē gjitha nē një gojë. Rina e goditi aq fort më berryl nē ije Dalinën, sa ajo hovi përpjetë. Tē gjitha qeshën. Edhe komandanti me ne.

— Po mirë, oj burrneshë — tha ai — me që shoqet janë zemëruar, le tē bëhet ashtu.

Dhe aty pér aty pregetti listën e shërbimit. Pastaj e lexoi. Ne dëgjonim. Askuch nuk bëhej merak pér vendrojet e tjera, tē gjitha prisnin kush do tē caktohej tek treshi. Nuk di se si më erdhi, kur, pas emrit tē Dalinës dëgjova emrin tim. Shoqet u kthyen nga unë dhe po më vështronin ngultas. Në në çast nuk isha e žonja tē kuptoja se ç'don'n tē thoshin me atë shikim: «Lum si ti, Vera» apo: «Hajd, mos u huto ashtu, se do tē kalojë dhe kjo.»

Pas mbledhjes, me qenë se do tē merrnim shërbimin, filluan pregetitjet. Komandanti na foli gjatë pér detyrat e veçanta nē çdo vendroie. Pastaj u shpërndamë dhe filluan tē llustronim këpurrët e tē rregu'lönim uniformën, sikur do tē shkonim nē qytet. Unë isha si nē ëndërr. Gjoksi me gufonte hove-hove. Shërbimi nē vendrojen numur tre, natën, më dukej diçka e pazar-konshme, gati-gati heroike. Çuditesha me Dalinën: si ishte ajo aq e qetë, sikur tē mos kishte asgjë tē veçantë. Po mbase ajo kishte tē drejtë. Mbase nē këtë mes nuk kishte vërtet asgjë tē veçantë dhe vetëm mua më dukej ashtu. Megjithatë... Bile, në një çast, mua m'u duk se nuk isha pregetitur plotësisht pér tē marë shërbimin atje. Në mendie më thosh tē shkoja drejt e tek komandanti dhe t'i thoshja hapur: «Shku komandant. Mos ma merr pér keq, por unë...» Dy tri herë u mata tē shkoja tek ai. Por aty pér aty ndërrroja mëndjen. Sakal mu afrua Neta, shoqja ime më e ngushtë. «E di unë, më tha. Ti... Por hiç mos u bëj merak. Unë nuk tē le vetëm. Do vi tē tri me ty sonte... Ti

hesht, mos i thuaj njeriu!.. » dhe më pushtoi në qafë. «Po pse, Neta, përsë ta bëjmë këtë? » «Hë, budallaqë, mua ma fsheh? E di unë, ke frikë » «Frikë..?» Dhe nisa të mendohesha. A ishte vërtet frikë ajo që njëndojat jo. Nuk më besohet. E përsë të trembesha. Kurrën e kurrës. Megjithatë, Neta më hutoi fare me ato që më tha. Më në fund e mblođba:

«Po mirë, Neta, mirë. Le të bëhet ashtu. Jo se kam frikë, por... fundja këtu s'ka gjë të keqë. Edhe kur të të bjerë ty tek treshi, bashkë do të rrimë » Dhe filloam të kuvëndonim të shkujdesura. Kështr koha kaloj pa u vënë re. Tani nuk bëhesha merak për asgjë. Bile më vinte mirë që do të qëndronim më Netën dy orë të tëra në gioksin e njëra-tjetrës dhe do t'i tregonim shoqja-shoqes të gjitha të fshehtat e zemrës, ashtu siç bënim edhe herë të tjera kur mbeteshim vetëm.

Orët u rrokullisën me shpejtësi. Kodrat tonë, si ca shkëmbinj cë ishin rrokullisur nga mali dhe kishin zë në vend në lëndinë, dalëngadalë i përpjua rata. Ishte një natë e zezë pus. Të p ktën kështu më dukej mua kur qëndroja me shoqet në çadrën e shërbimit. Ato finin, kurse unë s'putha gjumë me sy. Herëherës dilja te dera e çadrës dhe nuk gjeja qetësi. Nata heshtte. Shoqet flinin të shkujdesura, por mua më duke sikur bënë ashtu; kurse në të vërtetë i kishin mbyllur sytë rërgjysmë e më përgjonin. «Dale, dale pa ne i kemi marrë vesh të gjitha. » Kështu më dukej se thoshnin, ndërsa dremisnin e qeshnin nën buzë. Kjo më turbulloi fare. Po sikur ta merrte vesh njeri të fshehtën tonë dhe të na përgjonte? Si do t'u dilnim përpara shokëve: dhe shqeve të nesërmën? Ata do të na merrnin për frikëcake, dhe atëhere... Jo, jo. Kjo punë duhej menduar mirë. E përsë të tregohesha unë më e mënçur nga të tjera! Ç'kishte më shumë se unë Dalina? Fundja, armë

Kishte ajo, armë unë. Armë. Po a do tē mund ta shkrepja unë, nē qoftë se... E përse jo?

Dola përsëri jashtë. Neta zgjati krahët. E ndjeu se nuk isha e qetë.

- Po ti ç'ke kështu? — më pyeti.

Unë mbajta hapin. E vështrova drejt.

- E di, Neta. Ti je shumë e mirë. Të falemindecit shumë — Por... shko flij. Unë do tē qëndroj vetëm. — dhe nisa tē flas me nxitim, si tē doja t'i mbushja mendjen vetes: E përse tē mos qëndroj?

Asgjë s'ka për tē ngjarë. Kështu do tē jemi më tē qeta, edhe unë, edhe ti.

Ajo m'u hodh në qafë, si pak më parë kur më propozoi tē viante me mua në shërbim. Siç duket, që penduar për ato që më kish thënë.

- E bën dot këtë, Linka?

— E, pse jo!

— Të lumtë. Ma ndillte zemra se do tē veproje kështu.

Qëndruam dhe ca, pastaj ajo shkoi tē flinte, kurse mua më erdhi ora e shërbimit. Përgjegjësi i ndërrresës na mblodhi në tresht. Si lëmë shoqet rrugës, shkuam te depua. Dalina priste. Ajo na ndali që larg. Kur ju afrova që tē merr a shërbimin, ajo më pëshpëriti në vesh: «Si lum ti, Linka. E di sa bukur është këtu..! Ke për ta parë!» Unë u çudita me zërin e saj. M'u duk se ai zë kishte një kumb'm tē veçantë e shprehte një gëzim tē thellë. Vetëm kur erdhi koha tē leja shërbimin dhe i pëshpërita shoqes thuajse tē njëjtat fjalë në vesh, e kuptova nga buronte ai gëzim.

Më në fund mbeta vetëm. Dalëngadalë zhurma e hapave tē shoqeve u tret dhe vendi u platin në heshtje. Ishtë një heshtje e tillë që tē futej gjer në palcë. Unë

ngriva në vend atje ku isha. Më dukej se po të hidhja qoftë edhe një hap, do të ngjiste diçka që do të më hutonte fare. Nuk e kuptoja nga do të vinte kjo e rapritur: nga depua me eksploziv, nga nata, apo... Ish hera e parë në jetën time që qëndroja e vetme, bailë për ballë me natën, me armë në dorë. Hera e parë që të tjerët flinin dhe unë përgjoja. Mendime nga më të cuditshmet më pushtuan: M'u kujtua se kur isha në shtëpi dhe binte nata, nganjëherë druaja të zbrisja edhe shkallët në errësirë. U përhoqa t'i flakja këto mendime dhe ta përqëndroja mendjen duke shikuar objektet që më rrëthonin. Shpinën e kisha mbështetur në muria e depos. Me sytë e mendjes shikoja rrugën e ngushtë këmbësore që zbriste prej andej, dhe të conte te çadrat. Ato qenë rrështruar në dy radhë. E para vinte çadra e trunrojes, pak z veçuar nga të tjerat, thua jse nën pishën e lartë, që tanë me shembellente dhe ajo me një çadër gjigande. Pastaj me radhë të tjerat. E katërtë që çadra ime. Atje flinte Neta, Nora, Valbona, Neta që gjumashja më e madhe e klasës sonë, por sonte edhe ajo bënte ndofta një gjumë të shqetësuar. Mbështetur se nesër mbrëma do t'i takojë asaj të shërbijë te treshi. Eh, Neta, Neta! Kur ishim në shkollë dhe qëllonte të kthekeshim natën, kishe frikë ta kaloje e vetme atë copë rrugë nga bulevardi gier në konvikt dhe më thërrisje amua në emër që larg. Edhe unë po ashtu. Kurse këtu qëndrojmë vetëm, në mes të pyllit, në bjeshkë.

Vetëm. . .?

Diçka rrëshqiti anash: fshhsht! Unë u ngjesha pas murit dhe mbajta vesh. Nuk mirrja as frymë fare. C'lëvizi ashtu? Përgjova përsëri. Heshtje. Pastaj, prap: fshhsht! Qyqja, kjo është erë, moj. Lëviz era nëpër pemë dhe bën ashtu. Për t'u sigruuar, mbajtja prap vesh. Nga pishat nisi të rrëshqiste një fëshfëritje e mbetur,

pambaruar, si një bisedë e gjatë, e këndshme. Unë u përhoqë ta harroj atë dhe të shikoj malet. Në këtë natë të verbër ato reflektoheshin në horizont në format më të çuditshme. Dukeshin si ca krijesa gjigande që kishin rendur e rendur gatë gjithë ditës dhe tani dremësnin të lëdhur për të përtërirë forcat dhe për ta nisur sërisht të nesërmen udhëtimin. Shkimi im rrëshqiti mbi atë masë të çrrëgullt që vijëzohej në horizont dhe u ndal mbi masat e pishave që shponin qiellin, të cilat nuk di pse më shëmbellyen me disa heshta të mëd'a. U përpoqë të përfytyroja një betejë të vjetër me heshta e shigjeta, siç e kisha parë në një fî'm që s'më kujtohej mirë, me qëllim që ta largoja sa më shumë vëmendjen nga ato që më rrëthonin. Por përfytyrimi nuk më shpurti 'aro. Befas vështrova diçka të zezë, të kërrurur, që m'u duk se lëvizte drejt meje. Po tani? U ngjesha pas murit dhe shikova më me kujdes për nië kohë të gjatë. Hieja nuk lëvizi. Përgjova akoma. E njëjtë gjë. Asnjë lëvizje. Atëhere u kujtova se në atë vënd ishte një kaçube. Eh, sa budallaqe që isha! E përsë të gjitha hijet të më dukeshin si qenie të gjalla, që ecnin, lëviztin, afroheshin?

Po sikur, ndërkëq, dikush t'i afrohej depos dhe ta kërcënonte atë? A thua do të hutohesha dhe nuk do të bëjë asnjë veprim? Po të qe kështu, nuk e vleja asnjë grosh. Kot të gjitha. Kot që mbaja armën në dorë dhe që kisha pranuar të dilja roje. Më mirë të kisha thënë lëkurë nuk jäm e zonja. Thoni ç'të doni, por nuk mundem.

Indërsa e qortoja kështu veten, vështrova nga e majta. Diku, më tutje, pranë njëri-tjetrit, ngrëhesin tre lapidatë. Që të nesërmen e ardhjes ne shkuam atje dhë dëgjuam tregimin e një vendasi për një vajzë nga

bregdeti. Eftili e quanin më duket. Nuk i kishte kluar të katërmبëdhjetat. Qe një vajzë e imët, e pakët nga trupi, po me një zemër të madhe, që kishte shkruar në ato majë male një legjendë të bukur trimërtie. Njerëzit e këtyre anëve e kishin ngritur lapidarët e saj bri lapidarit të Ded Gjo Luli. Me këtë ata ndoferta kishin dashur të thoshnin se edhe një jetë e shkurtër, kuq i kushtohet një qëllimi të madh, është e dënjë të qëndrojë krah për krah me plakun e maleve. Duke u përpjekur të përfytyroja vajzën nga bregdeti, unë as vetë s'e kuptova se si fytyra e saj merrte herë tjetër e Zonja Çurres, herë të shoqeve të saj të luftës. Dhe kalova kështu një natë të paharruar me Zonjën, Foto Berberin, Nimete Progonatin. Mu duk sikur shikoja fytyrat e tyre, sikur dësjoja zërat, hapat, krimat e armëve të tyre. Mbajta vesh. Po, hapa! Shtrëngova armën dhe u shtriva barkas. E mbusha armën dhe e kuptova se, po të qe nevoja, do të mund të matesha me cilindri. Dhe thirra me të gjithë forcën: «Ndall Kush kallon?» As vetë s'e njoha zërin tim. Sakaq mora përgjigje.

Kishte ardhur koha që ta leja vendrojen. Nuk e kuptova sa shpejt rodhën të gjitha këto. Gjoksi më ngriljej e ulej me rrëmbim. Një gëzim dhe krenari të ti'lë nuk e kisha provuar herë tjetër. E dija se të nesërmën do të më trethonin shoqet dhe do të prisnin t'u kallzoja. Unë do t'ua tregoja ashtu siç të më vinte për goje. Neta do të më hidhej në qafë, do të më puthte e nuk do të pushonte së thëni: «Xhani i motrës!

Dhe kështu ngjau vërtet.

Ndaj të gdhirë nisi të frynte një erë që sikur e yuti përpara errësirën dhe e gremisi honeve. Dalëngadalë vendi u mbush me një dritë të ndezur e transparente, që nuk u pa nga doli dhe ju ngul natyrës mu në zemër.

Shoqet më tretuan dhe s'dinin ku të më vinin. Una e tregova me radhë të gjitha ç'më kishin ngjarë. Në mesditë mora shërbimin. Isha e gjuar si asnjëherë tjetër. Më dukej sikur më qe mbushur kraharoni me atë dritë të bardhë e të ndezur. Njeriu nganjëherë bëhet shumë shpejt i lumtur. Mjafton vetëm një ngjarie e vogël, një fjalë, një buzëqeshje. Kurse unë nuk e kuptojë nga më vinte ai gjësim, ajo lumturi. Çdo gjë më dukej e mirë, e bukur, e mrekullueshme. Doja të kapja, çdo lëvizje, çdo tingull. Dhe nuk ngopesha së sotituci natyrën. Herë-herë më ngjante se të gjitha këto i shikoja për herë të parë. Dhe çuditesha si një e vogël me ato pisha që ngriheshin të plota e të drejta pranë e pranë, të gatshme për t'i vënë së toku gjoksin tufanit dhe për të mbrojtur shoqja-shoqen me trupin e tyre. Çuditesha kur shikoja se si bashkoheshin drgët e tyre dhe shkriheshin në një kupolë të vetme e të bukur. Pastaj e largoja vështrimin nga ato dhe e hidhja mbi atë tufë resh të bardha e qumështore, që ishte hedhur si aq shall i butë e transparent mbi supet e shkëmbit. Kur e kur më dukej se, që nga zgavrat e shkrepat, shkembim zgjaste mijëra duar e mundohej ta kapte renë, po ajo i rrëshqiste nëpërt duar dhe kërcente e lodronte mos-përfillës e lozonjare. Duke i vështruar të gjitha këto, më dukej sikur kisha zbuluar një skret. Thosha me vete se hollësi të tillë mund t'i kapë vëtëm vështrimi i rojes. Madje më dukej se roja kishte një vështrim të vetin, të veçantë, se ai mund të zbulonte edhe të fshat më të vogla që kanë të bëjnë me një zhurmë fare të pa rëndësishme, me lëvizjen e një gjethi, me fluturimin e një zogu. Ndaj ishin shkruar dhe do të shkruhen aq shumë vargje për rojen. Unë përpinqesha është sillja në mendje ndonjë varg që t'i përshtatej sadopak naty-

res që më tretonte, por në vesh më kumbonin vetëm targje që kishin të bënин me natën, dëborën, suferirën e kjo më dukej pak e çuditshme. Përse të vihej roja vetëm në tretëna të tilla, kur atij i takon të kryejë detyrën edhe në një ditë kaq të zakonshme dhe në një vend kaq të bukur.

Nuk e di sa do të vazhdoja kështu, në qoftë se nuk do të ma kishte prerë në mes mendim's zhurma e magjinës që u ngrit nga faqja tjetër e kodrës dhe erdhi tek unë si një vuvurimë e zgjatur. Maqina u afroa, duke tertiqur prapa një re të hollë pluhuri, dhe ndali te burimi që gurgullonte jo shumë larg. Që andej zbuttën pesë a gjashtë njerëz. Unë vështro'a indiferente heqë njërin dhe herë tjetrin, kur befas shtanga nga habija. Një nga gratë kishte zbritur dhe qëndronte e hu-tuar në mes të rrugës, me vështrimin nga çadrat tonë.

«Nëna!» — thirra e gjëzuar dhe u lëshova me vrap drejt saj. Ajo më vështroi një hop e lumtur dhe zgjati hapin, më mbërtheu në gjoks e më puthi në ballë, në faqe, në flokë, duke folur pa pushim.

— Trimëresha e nënës! Ushtaria e nënës! Se si të dëftojnë kështu këto troba. Po këtë ç'e ke? Pushkërt!

Këto fjalë më sollën në vete. Po unë budallaçka, ç'bëja ashtu? Lashë vendrojen dhe u sula në prehërin e saj?! Bobo, sa e pa pjetur isha treguar! Si një fëmije. Nëna siç duket e vuri re ndryshimin tim dhe seç zurtë fliste. Po unë nuk dëgjova asgjë. U shkëputa nga duart e saj dhe vrapova e turbulluar në vendroje, si të më ndiqte njeri pas. Kur arrita atje, s'dija ku të futesha nga turpi. Më dukej sikur të gjithë më tregonin me gisht: shikoni, ajo e la vetëm vendrojen dhe u fut në prehërin e nenoles! Sa turp! Si e kisha lëshuar veton ashtu! Sa shpejt që i harrova porositë e komandantit! Para se të merrnim shërbimin, ai na shpjegoi me holë-

ai tē gjitha, na tregoi se roja, gjatë shërbimit, u përgjil-
gjet vetëm pyetjeve të komandantit të trupojes e për-
gjegjësit të ndërrsës dhe nuk largohet në asnjë rast nga
vendroja. Netës nuk ju durua. «Po sikur t'i afrohet
ndonjë nga familja, apo... i fejuari, ç'duhet të bëjë?» pyeti
duke qeshur pa tē keq. «Të thërrasë me të gjithë forcën
dhe ta ndalojë në distancën e caktuar - sqaroi koman-
danti. «Ua — u habit Neta — si kështu, të mos t'i ja-
pesh asnjë shpjegim!»

Dhe ja tani tek më afrohej nëna ime. Unë kisha ngritë
në vend. Ç'duhej të bëja? Më kujtohesin një pë-
një fjalët e komandantit se vendrojes nuk duhet t'i af-
rohet askush përtëj kufirit të caktuar. Por ndofta nëna
bënte përjashtim. Ndofta ajo qëndron mbi rregul'oret;
ashtu siç qëndron Atdheu mbi gjithshka. Dhe prapë...
Rregullat janë rregulla dhe duhen zlatuar me treptësi-
në më të madhe, siç thotë shpesh komandanti. Me që
m'u kujtua komandanti, çdo të mendonte valë ai në
një rast të tillë? Eh, sikur të mund të këshillohesha me
të! Por koha s'priste. Unë duhej të vendosja vetë. Dhe
vëndosa: asnjë lëshim nga rregullorja. Isha e bin-
durr se ajo do ta kishte të vështirë të më kuptonte. Ajo
ecë si të mos kishte ngjarë asgja e veçantë. Unë thirra
e vendosur.: «Ndall!» Po ajo qeshte dhe vazhdonte të
afrohej. Atëhere thirra edhe më fort. «Ndall!» Ku ta
dish ei ju duki zëri im, se ajo mbajti hapin dhe më vë-
shtroi e habitur.

— Linka, je në vete apo jo? Ç'bën kështu? — Dhe
prap nisi të ecë drejt meje. Po unë thirra përsëri:
Ndall! Desha të shtoja edhe diçka, të shpjegohesha se
isha në roje, se e kisha të ndauar të fis a me cilindër
po atë çast se nga doli Dalina me tre-katër shoqe dhë-
hështa. Ato ju afrouan nënës, e vunë në mes, dhe u pë-
pqën ta qetësonin e t'i tregonin si qëndronin punët.

Të tjerat i thashë në fillim.

P E R M B A J T J A :

Faqe

1. — Asnjë pëllëmbë prapa	3
2. — Motra	17
3. — Usta Pirua	33
4. — Rrugës pér në repart	48
5. — Një natë dimëri	59
6. — Lugina e portokalieve	71
7. — Lindita	80
8. — Zbuluesit	95
9. — Horizonte të kaltëra	111
10. — Pranë piramidës	119
11. — Ne dhe Gramozi	130
12. — Raketa në det	139
13. — At e bir	150
14. — Vendroja numur tre	164